



AGJENCIA E SIGURIMIT TË CILËSISË NË ARSIMIN E LARTË

## RAPORTI I VLERËSIMIT TË JASHTËM

Programi i studimit me karakter profesional në “Multimedia  
dhe Dizajn Grafik”  
i  
Institucionit të Arsimit të Lartë Kolegji Universitar “Bedër”

Grupi i Vlerësimit të Jashtëm:

1. Dr. Diana Kalaja

2. Dr. Sonia Jojiç

Shtator/ 2022

Adresa: “Rruga e Durrësit”, Nr. 219 Tiranë

E-mail: [info@ascal.al](mailto:info@ascal.al)

Tel: +355 (04) 222-43423

Web site: [www.ascal.al](http://www.ascal.al)


Faqe 1




## **TABELA PËRMBLEDHËSE E TË DHËNAVE TË PROGRAMIT TË STUDIMIT**

**Për programin e studimit me karakter profesional në “Multimedia dhe Dizajn Grafik”**

Nr.		
1	IAL aplikues:	Kolegji Universitar “Bedër”
2	Njësia bazë që e ofron:	Departamenti i Shkencave të Komunikimit (Fakulteti i Shkencave Humane dhe Drejtësisë)
3	Emërtimi i programit të studimit:	Program profesional në “Multimedia dhe Dizajn Grafik”
4	Urdhëri/VKM i licencimit:	UMASR Nr. 211, datë 03.07.2020
5	Urdhëri/VKM i riorganizimit:	-
6	Forma e regjistrimit të diplomës:	-
7	Urdhëri/VBA i akreditimit të parë:	-
8	Cikli i studimit:	Cikli i parë
9	Kohëzgjatja e programit të studimit:	2 vite
10	Kreditet në total (ECTS):	120 ECTS
11	Forma e studimit:	Me kohë të plotë
12	Gjuha (shqip/tjetër):	Shqip
13	Programi ofrohet në bashkëpunim me institucione të tjera:	Programi nuk ofrohet në bashkëpunim me institucione të tjera
14	Diplomë e përbashkët (shëno emërtimin):	-
15	Diplomë e dyfishtë (shëno emërtimin):	-
16	Niveli në kornizën kombëtare të kualifikimeve:	Niveli 5
17	Stafi akademik PAE/PAK për programin e studimit (2021- 2022):	12 PAE/ 4 PAK
18	Numri i studentëve:	22 studentë
19	Komente / të tjera:	



Adresa: “Rruga e Durrësit”, Nr. 219 Tiranë



E-mail: info@ascal.al



## **TË DHËNA TË PËRGJITHSHME PËR PROGRAMIN E STUDIMIT NË PROCES TË VLERËSIMIT TË JASHTËM**

Kolegji Universitar "Beder" e ka Fakultetin e Shkencave Humane dhe Drejtësisë dhe Departamentin e Shkencave të Komunikimit ndër departamentet kryesore dhe themeluese të tij. Departamenti është i konsoliduar me programe studimi në ciklin e parë dhe të dytë të studimit.


Institucioni ka zhvilluar procesin e vlerësimit institucional në kuadër të akreditimit periodik. Me vendim të Bordit të Akreditimit nr. 57 datë 16.12.2021 institucioni ka marrë akreditim 5-vjeçar deri në 15.12.2026.

Programi profesional i studimit "Multimedia dhe Dizajn Grafik" është hapur me Urdhërin e Ministrisë së Arsimit, Sportit dhe Rinisë nr. 211 datë 03.07.2020. Programi ka kohëzgjatje akademike 2 vite, me 4 semestra, 16 javë secili, duke përfshirë edhe provimet. Programi ka 120 kredite ECTS, me 60 kredite secili vit. Ky program profesional akreditohet për herë të parë.


Në ndërtimin e kurikulës së programit profesional të studimit "Multimedia dhe Dizajn Grafik" departamenti është mbështetur në traditën më të mirë të disa universiteteve të huaja me të cilat ka marrëdhënie bashkëpunimi edhe në kuadër të programeve ndërkombëtare. Gjithashtu KU "Beder" ka një studim të plotë për tregun e punës, fushat dhe drejtimet profesionale ku mund të përfshihen të diplomuarit e këtij programi studimi, të cilin e përditëson periodikisht.

KU "Beder" ka një staf akademik të konsoliduar dhe ofron pedagogë të jashtëm me ekspertizë në fushat specifike të teknologjisë për tu dhënë mundësi studenteve të njohin zhvillimet më të fundit në fushën përkatëse të studimit.

Raporti i Vlerësimit të Jashtëm (RVJ) është hartuar në vijim të detyrimeve për akreditimin e programit profesional të studimit. Në hartimin e këtij Raporti, Grupi i Vlerësimit të Jashtëm (GVJ) është mbështetur në dokumentacionin e Dosjes së Vetëvlerësimit të përgatitur nga Grupi i Vetëvlerësimit si edhe në konstatimet, gjetjet dhe shënimet e mbajtura gjatë takimeve të zhvilluara gjatë vizitave në Institucion, si dhe në dokumentacionin shtesë në kuadër të tyre.



Adresa: "Rruga e Durrësit", Nr. 219 Tiranë



E-mail: [info@ascal.al](mailto:info@ascal.al)

Tel: +355 (04) 222-43423

Web site: [www.ascal.al](http://www.ascal.al)

Faqe 3



## **PËRSHKRIMI I PROCESIT TË VLERËSIMIT TË JASHTËM**

Grupi i Vlerësimit të Jashtëm (GVJ) nisi punën e përbashkët të ekspertëve të jashtëm dhe stafit të ASCAL, duke dakordësuar edhe me IAL datat e vizitës si edhe agjenda e takimeve. Vizita u realizua fizikisht në institucion, për shkak të lehtësimit të situatës nga pandemia COVID – 19, në datën 5 prill 2022.

GVJ u njoh me të gjithë dokumentacionin e dorëzuar nga institucioni në proces akreditimi përmes platformës dhe kredencialet që secili nga vlerësuesit e jashtëm ka në [www.ascal.al](http://www.ascal.al)

Gjatë takimeve me Dekanin e Fakultetit të Shkencave Humane dhe të Drejtësisë, me Përgjegjësën e Departamentit të Shkencave të Komunikimit, Grupin e Vlerësimit të Brendshëm, stafin e programit në proces akreditimi, Dekanin e Studentëve dhe zyrat e përfshira aty, si edhe zyra të tjera administrative, takimit me një grup studentësh, vizitës në ambientet e KU Bedër, sallat e leksioneve, seminareve, laboratorët kompjuterikë, u mblodh informacioni për hartimin e Raportit të Vlerësimit të Jashtëm.

Grupi i Vlerësimit të Jashtëm kërkoi plotësimin me disa materiale të nevojshme për vlerësimin përfundimtar të programit të studimit. Materialet e kërkuara u plotësuan dhe u vendosën në platformën e ASCAL. Gjatë gjithë këtij procesi vlerësimi ka pasur një bashkëpunim shumë korrekt dhe mirëkuptues midis GVJ dhe stafit të KU Bedër.

Raporti i integruar i GVJ është hartuar bazuar në gjetjet dhe konstatimet dhe në zbatim të kritereve/ standardeve shtetërore të cilësisë.

Koordinatori teknik i ASCAL në këtë procedurë është Msc. Aviola Bardhi .

Më datë 12.07.2022, përmes sistemit AMS dhe me shkresë zyrtare Nr. 107/9 Prot., datë 12.07.2022 dërgohet në Institucion Draft- Raporti i Vlerësimit të Jashtëm. IAL përcolli komentet, përmes AMS, më datë 20.07.2022 dhe me shkresë zyrtare Nr 39/4 Prot., datë 18.07.2022

### **GVJ pasi u njoh me komentet e Institucionit mbi draft-raportin, sqaron si vijon:**

## **II. STRUKTURA DHE PËRMBAJTJA E PROGRAMEVE TË STUDIMIT ME KARAKTER PROFESIONAL**

### **Standardi 11.1. Kriteri 4**

#### **Komenti i IAL:**

Grupi i Vlerësimit të Jashtëm me sugjerimin e dhënë shprehet se "*për këtë program profesional në "Multimedia dhe Dizajn Grafik" të hartohen tekste në gjuhën Shqipe, apo video tutoriale për t'ju venë në dispozicion studentëve,*". Kjo çështje është referuar si një pikë e dobët në përfundimet e vlerësimit të programit të studimit me karakter profesional. Po ashtu kjo është një situatë e cila karakterizon disa fusha që lidhen me teknologjinë dhe komunikimin. Sigurisht që lektorët e Departamentit të Shkencave të Komunikimit i ka mbështetur studentët me materialet e nevojshme që leksionet, seminarët apo punët praktike të ndjekin dhe vijojnë një proces normal, duke përgatitur përmbledhje me leksione, si dhe



përkthime të materialeve të ndryshme në kuadër të lëndëve specifike. Megjithatë mbetet ende për t'u bërë në këtë aspekt. Ndërsa, për sa i përket hartimit të tutorialeve, disa lektorë të lëndëve me karakter praktik kanë punuar në këtë drejtim, jo vetëm duke zbatuar Syllabuset por edhe duke i tejkaluar këto detyrime. Një shembull për këtë çështje është lënda Multimedia, tutoriale të cilat i gjeni të bashkëngjitura me CD dhe me ndërlidhje në fusnotë.

#### **Përgjigja e GVJ:**

GVJ pranon arsyetimin e KU Beder. Tekstet e mirëfillta në lëndët me karakter teknologjik, janë përgjithësisht në gjuhë të huaj dhe kjo është ndeshur edhe në universitete të tjera. GVJ vlerëson evidencat shtesë të sjella nga institucioni për lëndët e veçanta ku janë hartuar tutoriale dhe përkthime të tjera. Sygjerohet të vijohet kjo punë.

**GVJ ndryshon vlerësimin për këtë standard.**

## **II. STRUKTURA DHE PËRMBAJTJA E PROGRAMEVE TË STUDIMIT ME KARAKTER PROFESIONAL**

### **Standardi 11.1, Kriteri 6**

#### **Komenti i IAL:**

Lëndët e përmendura në këtë kriter, të tilla si Dizajni Grafik I 3 ECTS; Dizajn Grafik II 3 ECTS; Dizajni Multimedia! 4 ECTS; Dizajni i Reklamave (Kreativiteti, Produksion) 3 ECTS; Editim Audio Video 3 ECTS dhe Animacion 3 ECTS, janë LËNDË KARAKTERIZUESE përgatitje për disipinën shkencore (B). Kësisoj, këto lëndë janë në përputhje me Vendimin nr. 41 (të ndryshuar), datë 24.1.2018, të Këshillit të Ministrave, për elementet e programeve të studimit të ofruara nga Institucionet e Arsimit të Lartë konkretisht për Programet me karakter profesional (niveli 5 i KSHK-së). Siç është paraqitur edhe në Shtojca tabela 9 paraqet grup lëndët dhe përqindjet e tyre. LËNDË KARAKTERIZUESE- përgatitje për disipinën shkencore (B) ku bëjnë pjesë edhe lëndët e sipërpërmendura duke zënë 55% e planit mësimor. Përqindja e zënë në planin mësimor për këtë kategori lënësh është në përputhje me përqindjen e parashikuar në Vendimin e sipërpërmendur (përqindja në VKM është 40-55%). Megjithatë Departamenti duke parë nevojat dhe duke zbatuar hapësirat që lejon ligji bën ndryshime herë pas here në kurrikul duke iu prshatur kështu nevojave të tregut.

#### **Përgjigja e GVJ:**

GVJ pranon arsyetimin e KU Beder. Raportet midis lëndëve janë në përputhje me kriteret e përcaktuara nga udhëzimi i MASH. Sygjerohet të vijohet puna për të pasqyruar nëpërmjet leksioneve dhe moduleve të veçanta nevojave e tregut dhe risitë teknologjike në drejtim të "Multimedia dhe Dizinj grafik" të cilat në ditët e sotme kanë një tendencë të shpejtë ndryshimi.

**GVJ ndryshon vlerësimin për këtë standard.**



### III. MËSIMDHËNIA, MËSIMNXËNIA, VLERËSIMI DHE KOMPETENCAT

#### Standardi III.1, Kriteri 4

##### Komenti i IAL:

Grupi i Vlerësimit të Jashtëm shprehet se "Ndërkohë sipas tabelës 12.1 në RVB janë gjithsej 37 orë nga këto 13 ore nga PAK (35%) dhe 24 ore nga PAE (65%). Nuk plotësohet kriteri mbi 70% mbulohet nga staf efektiv", kjo për vitin e parë akademik të programit profesional "Multimedia dhe Dizajn Grafik. Kjo përqindje rezulton vetëm për vitin e parë (2020- 2021). Përqindja e vitit të parë reflekton edhe vështirësitë e ardhura për shkak të kushteve që diktoi pandemia e Covid-19. Ky programi nisi aplikimin pikërisht në vitin kur leksionet dhe seminarët u zhvilluan në distancë për shkak të masave të marra nga institucionet shtetërore për parandalimin e virusit. Po ashtu në të njëjtin kriter, GVJ shprehet se "për vitin akademik 2021-2022 ngarkesa totale në orë është 89 orë, të ndara në 74 orë nga PAE (pra 84.14%) dhe 15 orë nga PAK (pra 16.85%) pra plotësohet kriteri mbi 70% e orëve nga PAE." Siç vihet re në vitin e dytë akademik (viti akademik 2021-2022) të programit profesional "Multimedia dhe Dizajn Grafik, personeli me kohë të plotë, jo vetëm që e ka plotësuar kriterin, por e ka tejkaluar atë si për ngarkesën e vitit të parë ashtu edhe për vitin e dytë. Nisur nga kjo, kuptohet që programi ndër të tjera edhe nga specifika e fushës e ka pasur sfidë punësimin e personelit me kohë të plotë, gjë e cila një vit më pas është tejkaluar, duke e konsoliduar këtë aspekt. Kolegji Universitar "Bedër" dhe Departamenti bëjnë përpjekje të vazhdueshme për ta konsoliduar edhe më tej stafin e këtij programi.

##### Përgjigja e GVJ:

GVJ pranon arsyetimin e KU Beder.

Fakti që për vitin akademik 2021-2022 ngarkesa totale në orë mësimore është rreth 83% e mbuluar nga PAE dhe rreth 17% e mbuluar nga PAK është mjaft pozitiv në reflektim të zbatimit të kriterëve të vendosura. Ky është viti i dytë mësimor për këë program studimi, dhe në një farë mënyre është viti i cili reflekton treguesit mësimor, pasi viti akademik 2020-2021 ishte viti i mbulura tërësisht nga Pandemia COVID -19, dhe vështirësitë ishin për të gjitha universitetet edhe për programet ekzistuese.

**GVJ ndryshon vlerësimin për këtë standard.**



## Vlerësimi i Programit të Studimit me karakter profesional “Multimedia dhe Dizajn Grafik”

### I. OFRIMI, ORGANIZIMI DHE DREJTIMI I PROGRAMEVE TË STUDIMIT ME KARAKTER PROFESIONAL

<b>Standardi I.1</b>	
<b>Institucioni i arsimit të lartë ofron programe studimi me karakter profesional në përputhje me misionin dhe qëllimin e tij dhe në përputhje me nevojat e kërkesat e tregut të punës.</b>	
<b>Kriteret</b>	<b>Vlerësimi</b>
<p><b>Kriteri 1.</b> Programet e studimeve hartohen dhe ofrohen në përputhje me qëllimet dhe misionin e institucionit, në përshtatje dhe në zbatim të strategjisë për zhvillim të vetë institucionit.</p>	<p>Nga shqyrtimi i dokumentacionit të dorëzuar nga Kolegji Universitar Bedër, si edhe informacioneve të dërguara nga Grupi i Vlerësimit të Brendshëm, duke përfshirë: Statuti i Kolegjit Universitar “Bedër”; Rregullorja themelore e Kolegjit Universitar “Bedër”; Rregullorja mbi Organizimin Administrativ; Rregullorja e “Programit Profesional në Multimedia dhe Dizajn Grafik”; Plani strategjik Institucional i KU Bedër 2018-2023, vlerësohet se programi i studimit me karakter profesional “Multimedia dhe Dizajn Grafik” ofrohet në përputhje me qëllimet dhe misionin e institucionit dhe strategjitë e tij të zhvillimit.</p> <p>Kjo evidentohet qartësisht në synimet e shprehura në planin strategjik “... arsimit cilësor dhe një zhvillim i qëndrueshëm në arsim, duke patur parasysh gjithnjë edhe komponentin e përgjegjshmërisë sociale, ...”</p> <p>Më gjerë, edhe Statuti i KU Bedër përcakton se “...ka për mision përgatitjen e individëve të kualifikuar, nëpërmjet një filozofie arsimimi që ka në thelb vlerat universale...”</p> <p>Rregullorja e programit profesional të studimit përcakton përputhjen dhe mbështetjen në Ligjin nr. 80/2015 “Për Arsimin e Lartë dhe Kërkimin Shkencor në Institucionet e Arsimit të Lartë në Republikën e Shqipërisë”, në statutin dhe rregulloren themelore të Kolegjit Universitar “Bedër”, në licencën e dhënë me Vendimin e Këshillit të Ministrave nr.286, datë 6.4.2011, “Për licencimin e Institucionit Privat të Arsimit të Lartë Shkolla e Lartë “Hëna e Plotë-(Bedër)”.</p> <p><u>Referenca</u></p> <p>Evidenca 2- Statuti i Kolegjit Universitar “Bedër”</p> <p>Evidenca 3- Rregullorja themelore e Kolegjit Universitar “Bedër”</p> <p>Evidenca 4- Rregullorja mbi Organizimin Administrativ</p> <p>Evidenca 5- Rregullorja e “Programit Profesional në Multimedia dhe Dizajn Grafik”</p> <p>Evidenca 34- Plani strategjik Institucional i KU Bedër 2018-2023</p>
<p><b>Kriteri 2.</b> Statuti dhe rregullorja e institucionit duhet të përcaktojnë qartë drejtimit prioritar akademike të tij dhe të demonstrojnë se programet e studimit hartohen dhe ofrohen në përputhje dhe në zbatim të këtyre të fundit.</p>	
<p><b>Kriteri 3.</b> Programet e studimeve ofrohen në përputhje me fushat e drejtimit akademike të institucionit, si</p>	<p>Bazuar në dokumentacionin e përcjellë nga institucioni, GVJ vlerëson se fusha e përgjithshme dhe specifike e programit të studimit me karakter profesional “Multimedia dhe Dizajn</p>



<p>dhe fushën akademike të njësisë kryesore/ kolegjit profesional dhe atë të njësisë bazë përgjegjëse për programin e studimit.</p>	<p>Grafik” është në përputhje me fushën akademike e kërkimore të njësisë kryesore, fakultetit, si edhe atë të njësisë bazë, Departamentit të Shkencave të Komunikimit.</p> <p>Departamenti ofron edhe programe të tjera studimi si në nivel Bachelor edhe në nivelin Master, të gjitha të lidhura me shkencat e komunikimit të tilla si: Bsc në Shkenca Komunikimi; Msc Shkenca Komunikimi – profilet: Gazetari; Marrëdhënie me Publikun; Master Profesional në Komunikim Marketingu.</p> <p><u>Referenca</u></p> <p>Evidenca 2- Statuti i Kolegjit Universitar “Bedër”</p> <p>Evidenca 3- Rregullorja themelore e Kolegjit Universitar “Bedër”</p> <p>Evidenca 4- Rregullorja mbi Organizimin Administrativ</p> <p>Evidenca 5- Rregullorja e “Programit Profesional në Multimedia dhe Dizajn Grafik”</p> <p>Evidenca i 34- Plani strategjik Institucional i KU Bedër 2018-2023</p>
<p><b>Kriteri 4.</b> Propozimi, hartimi dhe realizimi i programit të studimit me karakter profesional mbështetet në studime të mirëfillta mbi tregun lokal e kombëtar të punësimit për këto programe.</p>	<p>KU Bedër ka kryer një studim në tregun vendas të punës duke identifikuar se cilat janë potencialet që ka tregu për studentet e diplomuar në programin e studimit me karakter profesional “Multimedia dhe Dizajn Grafik”. Studimi është gjithëpërfshirës dhe jep informacione statistikore si edhe vlerësime cilësore për tregun lidhur me mjetet, format dhe mënyrat e komunikimit.</p>
<p><b>Kriteri 5.</b> Gjatë realizimit të programit të studimit, nga pranimi në diplomim dhe pas daljes së studentëve në punë, zhvillohen studime periodike mbi tregun e punës, ndryshimet përkatëse dhe punësimin e studentëve.</p>	<p>Studimi paraprak, përpara fillimit të programit të studimit, është kryer në fund të vitit 2019. Ai përmban informacione si për grupet e synuara, tregun e punës (duke ju referuar burimeve zyrtare si INSTAT) nevojat e tregut të punës si kombëtar ashtu dhe rajonal, tendencat e zhvillimit të komunikimit, diferencën që ka sjellë komunikimi dhe marketimi dixhital, etj. Në studim jepet karakteristikat dhe informacione për agjencitë e reklamës dhe marketingut, kompanitë e mëdha që kanë zyra shtypi dhe janë aktive me mesazhet që përcjellin drejtuar publikut, marketingut dixhital si edhe strukturat ndërlidhëse me tregun e punës. Studimi ka edhe një listë të zgjeruar të transmetuesve dhe prodhuesve audiovizivë. Në përfundim, studimi ka dhënë edhe konkluzione dhe sugjerimi për mundësitë që ky treg ofron për zhvillim dhe punësim. KU Bedër e ka ndërtuar në mënyrë ciklike studimin mbi tregun e punës. Departamenti i Shkencave të Komunikimit, ka pasur një studim mbi tregun e punës që në fillimet e tij, por grupet e punës e kanë përditësuar në mënyrë të vazhdueshme studimin e tregut, me elementë të rinj. Në strukturën organizative, si pjesë e Zyrës së Dekanit të studentëve është edhe Zyra e Karrierës dhe e Marrëdhënieve me Studentët e cila mban një dokumentacion mbi mundësinë e punësimit të studentëve pas mbarimit të programit të studimit</p>
<p><b>Kriteri 6.</b> Studimet paraprake dhe periodike të tregut të punës për programet me karakter profesional duhet të përfshijnë të dhëna nga komunikimi zyrtar me punëdhënësit e fushës, kërkesat dhe nevojat e tyre, mundësitë e punësimit të studentëve, të dhëna mbi punësimin real të studentëve të diplomuar dhe zhvillimet e pritshme në sektorin përkatës.</p>	



	dhe drejtimet që merr karriera e tyre profesionale.			
	<u>Referenca</u> Evidenca 5- Rregullorja e "Programit Profesional në Multimedia dhe Dizajn Grafik" Evidenca 45- Studim tregu i zhvilluar nga Departamenti i Shkencave të Komunikimit mbi "Peizazhin e fushës së medias dhe komunikimit në Shqipëri" Evidenca 46- Studim Tregu përpara hapjes së programit profesional Multimedia dhe Dizajn Grafik			
Shkalla e përmbushjes së standardit	Nuk përmbushet	Përmbushet pjesërisht	Përmbushet kryesisht	Përmbushet plotësisht
				X

<b>Standardi I.2</b>	
<b>Institucioni i arsimit të lartë siguron marrëdhënie bashkëpunimi brenda institucionit dhe me institucione, kompani, palë të treta, aktorë të biznesit vendas dhe/ose të huaj në funksion të realizimit të programit të studimit, dhe në përputhje me fushën dhe specifikën e këtyre të fundit.</b>	
<b>Kriteret</b>	<b>Vlerësimi</b>
<b>Kriteri 1.</b> Për hartimin, mbikëqyrjen dhe mbarëvajtjen e programit, siguron marrëdhënie të frytshme bashkëpunimi brenda institucionit nëpërmjet ndarjes së detyrave mes njërive e personelit, marrjes së përgjegjësive respektive dhe analizës së vazhdueshme të punës së tyre.	Nga vlerësimi i dokumentacionit dhe informacioni i mbledhur gjatë vizitës në institucion, rezulton se Departamenti i Shkencave të Komunikimit i KU Bedër si njësi bazë e programit të studimit me karakter profesional "Multimedia dhe Dizajn Grafik" siguron marrëdhënie të frytshme bashkëpunimi brenda institucionit si edhe jashtë tij. Ky departament bashkëpunon me njësitë e tjera brenda institucionit KU Bedër, si ato akademike ashtu edhe ato administrative për të siguruar mbarëvajtjen e realizimit me sukses të programeve të studimit. Departamenti bën ndarjen e detyrave dhe koordinimin mes personelit akademik të departamentit duke përcaktuar qartë përgjegjësitë si në nivel akademik ashtu edhe nga pikëpamja administrative. Kjo ndarje e detyrave është e përcaktuar si në rregulloren e programit ashtu edhe në rregulloren e njësisë kryesore, si edhe rregulloren mbi organizimin administrativ. Edhe gjatë vizitës se GVJ u vu re një bashkëpunim dhe koordinim efikas me strukturat e institucionit si Sekretaria mësimore, Arkiva dhe protokolli, Zyra e Burimeve Njerëzore, etj. Departamenti i Shkencave të Komunikimit është njësi bazë e cila bën edhe koordinimin dhe mbikëqyrjen e aktiviteteve si me lektorët e ndryshëm të ftuar në programin mësimor, ashtu edhe me aktivitetet ekstrakurrikulare që lidhen me tregun e punës dhe <i>workshop</i> -e, të cilat janë pjesë e një lënde apo e disa grup lëndësh që zhvillohen në departament.
<b>Kriteri 2.</b> Për realizimin e objektivave të procesit mësimor, formimin teorik e praktik të studentëve, institucioni vendos marrëdhënie afatgjata e të qëndrueshme bashkëpunimi me institucionet homologe brenda dhe/ ose jashtë vendit, me punëdhënës vendës, aktorë të biznesit vendas dhe/ ose të huaj.	Nga dokumentacioni i përcjellë dhe takimet u evidentua lista e universiteteve me të cilat bashkëpunon të tilla si: Benedictine University, Lisle, IL, USA; Universiteti Nënë Tereza Shkup; West University of Timiosara; International University of



	<p>Struga; Eastern Mediterranean University; North Cyprus; Moscoë City University; Aurel Vlaicu University of Arad, Romania.</p> <p><u>Referenca</u></p> <p><i>Evidenca 4- Rregullorja mbi Organizimin Administrativ</i></p> <p><i>Evidenca 9- Vendimi i këshillit të departamentit për përcaktimin e përfaqësuesit të karrierës</i></p> <p><i>Evidenca 28- Lista IAL-ve me të cilat ka marrëveshje bashkëpunimi</i></p> <p><i>Evidenca 32- Marrëveshjet e bashkëpunimit (aktive) dhe mobiliteti për staf dhe studentë me institucionet homologe brenda dhe, ose jashtë vendit.</i></p> <p><i>Evidenca 33- Marrëveshjet e bashkëpunimit (aktive) me organizata, institucione dhe aktorët e biznesit vendas dhe, ose të huaj dhe për praktikën profesionale</i></p>
<p><b>Kriteri 3.</b> Në mënyrë periodike, njësia përgjegjëse për programin e studimit harton raporte analitike të përfitimeve nga marrëveshjet e bashkëpunimit në funksion të realizimit të programeve të studimeve.</p>	<p>Në mënyrë periodike, Departamenti i Shkencave të Komunikimit si njësia bazë, bën analizën e ecurisë së procesit mësimdhënës dhe realizmin e bashkëpunimit në funksion të procesit mësimor. Gjatë vizitës në KU Bedër dhe takimi me drejtues të njësisë bazë dhe kryesore, GVJ u informua rreth mbledhjeve mujore që bën Departamenti si për ecurinë e programit dhe progresin e studentëve. Në disa nga këto mbledhje marrin pjesë edhe studentët e programeve të studimit nën njësinë bazë. Departamenti i Shkencave të Komunikimit harton raporte vjetore për të gjithë veprimtarinë e tij dhe ecurinë e programeve nën mbikëqytje përgjatë një viti. Raportet vjetore janë të ndarë në kapituj dhe trajtojnë të gjitha programet e studimit si edhe aktivitetet e tjera. “Raporti vjetor i Departamentit të Shkencave të Komunikimit, viti akademik 2020-2021” trajton në kapitull më vete edhe gjithë ecurinë e programit të studimit me karakter profesional “Multimedia dhe Dizajn Grafik”. Ky raport përshkruan edhe veprimtaritë akademike, leksionet e hapura, seminarët “Studenti dhe Profesion” (19 Shkurt 2021- Seminar me temë “E ardhmja e organizimit të eventeve në realitetin e ri”) e tjera Mars – Qershor 2021 “Multimedia Lab 2021”; Seminar në kuadër të lëndës “Mediat e Reja” si edhe aktivitetet ekstrakurrikulare.</p> <p><u>Referenca</u></p> <p><i>Evidenca 41- Raporti vjetor i Departamentit të Shkencave të Komunikimit, viti akademik 2018-2019.</i></p> <p><i>Evidenca 42- Raporti vjetor i Departamentit të Shkencave të Komunikimit, viti akademik 2019-2020.</i></p> <p><i>Evidenca 43- Raporti vjetor i Departamentit të Shkencave të Komunikimit, viti akademik 2020-2021.</i></p>
<p><b>Kriteri 4.</b> Institucioni vendos marrëdhënie zyrtare e bashkëpunon me punëdhënësit për kryerjen dhe mbikëqyrjen e praktikës, në varësi të</p>	<p>KU Bedër e konsideron të rëndësishme kryerjen e praktikës profesionale me studentët. Materiali i paraqitur nga GVB jep edhe listën e institucioneve me të cilat kanë marrëveshje për praktikat.</p>



natyrës specifike të programeve të studimeve që ofrojnë.	Për studentët e programit të studimit me karakter profesional “Multimedia dhe Dizajn Grafik” praktika është parashikuar të zhvillohet në semestrin e dytë të vitit të dytë mësimor. Gjatë vizitës në institucion, nga biseda me pedagogët, GVB dhe stafin drejtues u theksua se edhe për këtë program studimi tani po bëhej përzgjedhja e vendeve për praktike. Ndërkohë që edhe gjatë vitit të kaluar mësimor, studentëve të ndryshëm u është dhënë mundësia të shkojnë pranë bizneseve për të ndjekur ecurinë e një dite pune dhe të punojnë pranë tyre, megjithëse kjo nuk është pjesa formale e praktikës. Zyra e Karrierës dhe e Marrëdhënieve me studentët mban kontakte të vazhdueshme me studentët për t’i vendosur ata në mundësi si për të njohur tregun e punës dhe për të marrë eksperiencë të drejtpërdrejta me ta. Nga vizitat me studentët, disa prej tyre ishin të punësuar në biznese personale dhe synonin të vijonin më tej karrierën e tyre.			
<b>Kriteri 5.</b> Institucioni ndërmerr iniciativa specifike në mbështetje të sipërmarrjes dhe punësimit të studentëve.	<p><i>Referenca</i></p> <p>Evidenca 33- Marrëveshjet e bashkëpunimit (aktive) me organizata, institucione dhe aktorët e biznesit vendas dhe, ose të huaj dhe për praktikën profesionale</p> <p>Evidenca 43- Raporti vjetor i Departamentit të Shkencave të Komunikimit, viti akademik 2020-2021.</p>			
<b>Shkalla e përmbushjes së standardit</b>	<b>Nuk përmbushet</b>	<b>Përmbushet pjesërisht</b>	<b>Përmbushet kryesisht</b>	<b>Përmbushet plotësisht</b>
				X

<b>Standardi I.3</b>	
<b>Programet e studimeve organizohen në përputhje me parashikimet ligjore e përcaktimet nënligjore kombëtare në fuqi dhe Kuadrin Evropian e Shqiptar të Kualifikimeve për këto programe studimi.</b>	
<b>Kriteret</b>	<b>Vlerësimi</b>
<b>Kriteri 1.</b> Programet e studimeve janë të organizuara në lëndë/module dhe të vlerësuara në kredite, në përputhje me legjislacionin vendës në fuqi dhe sipas Sistemit Evropian të Transferimit dhe Grumbullimit të Krediteve (ECTS).	<p>Programi i studimit me karakter profesional “Multimedia dhe Dizajn Grafik” është ndërtuar me dy vite akademike, ku realizohen 4 semestra, me një total secili me 16 javë. Lëndët janë të ndara në kredite sipas sistemit ECTS dhe me 120 kredite gjithsej. Modulet janë ndarë si më poshtë:</p> <p>Planet mësimore të ndara sipas veprimtarive formuese (A-E)</p> <p>A- LËNDË BAZË, përgatitje metodologjike dhe kulturë e përgjithshme - 18 ECTS ose 15%</p> <p>B- LËNDË KARAKTERIZUESE, përgatitje për disiplinën shkencore - 66 ECTS ose 55%</p> <p>C- LËNDË NDËRDISIPLINORE / INTEGRUESE, nën disiplina, profile dhe gruplëndë me zgjedhje - 15 ECTS ose 12.5%</p> <p>D- LËNDË PLOTËSUESE, gjuhë e huaj, njohuri informatike, praktika profesionale - 16 ECTS ose 13.3%</p> <p>E- DETYRIME PËRMBYLLËSE - 5 ECTS ose 4.16%</p> <p>Kjo ndarje e lëndëve është në përputhje me Ligjin Nr. 80/2015 datë 22.07.2015 “Për arsimin e lartë dhe kërkimin shkencor në institucionet e</p>



	<p>arsimit të lartë në Republikën e Shqipërisë”, Udhëzimin nr. 15 dt. 04.04.2008 “Për Organizimin e Studimeve në Institucionet e Arsimit të Lartë”, si dhe Vendimin e KM nr. 41, datë 24.01.2018 “Për elementet e programeve të studimit të ofruara nga institucionet e arsimit të lartë”. Gjithashtu lëndët dhe modulet janë të organizuara me kredite, sipas Sistemit Evropian të Transferimit dhe Grumbullimit të Krediteve, ECTS.</p> <p>Zhvillimi i leksioneve dhe seminareve janë formatet kryesore të kryerjes së temave për lëndët. Por në kushtet e mësimin në distancë nga pandemia Covid-19 janë dhënë detyra, projekte për studentët pjesëmarrës në këtë program.</p> <p>Studentët në programet e profesionale 2-vjeçare të studimeve diplomohen me provim të përgjithshëm përfundimtar ose punim diplome/ projekt përfundimtar.</p> <p><u>Referenca</u>  Evidenca 5- Rregullorja e “Programit Profesional në Multimedia dhe Dizajn Grafik”  Evidenca 47- Syllabuset e lëndëve</p>
<p><b>Kriteri 2.</b> Programet e studimeve me karakter profesional synojnë përfundimin e njohurive gjithë përfshirëse të specializuara teorike dhe praktike brenda një fushe punësimi në një llojshmëri të gjerë profesionale e specialitetesh.</p>	<p>Bazuar në informacionin e përcjellë nga institucioni dhe nga vizita KU Bedër jepet një përshkrim i plotë i njohurive që marrin studentët gjatë këtij programi studimi. Kjo evidentohet mjaft mirë në syllabuset e lëndëve që janë si të natyrës karakterizuese në përshtatje me disipinën që ata studiojnë, ashtu edhe lëndët bazë, ndërdisiplinore dhe plotësuese. Edhe nga syllabuset shihet synimi për të marrë si njohuritë praktike ashtu edhe ato teorike. Duke shkëputur disa nga synimet për lëndët karakterizuese (B) janë:</p> <ul style="list-style-type: none"> <li>▪ Të kuptuarit e përgjithshëm të konceptimit të Dizajnit/ Grafik. Kuptimi dhe zbatimi i qartë i "5 C-ve të dizajnit grafik", Përmbajtja, Koncepti, Elementët, Përbërja dhe Ndërgjegjësimi Krijues.</li> <li>▪ Udhëzime për përdorimin dhe aplikimin e duhur të software në Adobe Creative Suite; kur dhe si të përdoret çdo aplikacion në mënyrën më efektive për të kontribuar në plotësimin e suksesshëm të produktit final të botimit të printuar.</li> <li>▪ Aplikimi i parimeve themelore të dizajnit dhe aftësive të fituara; krijimi i projekteve specifike që, në botën profesionale, do të kërkoheshin nga një dizajner grafik.</li> <li>▪ Theks i fortë i jepet zhvillimit të vazhdueshëm të aftësive të komunikimit; përgatitja, hulumtimi, ideimi dhe ekzekutimi për të arritur shpejt dhe në mënyrë efektive në nivelin profesional zgjidhjeve vizuale që flasin qartë dhe në mënyrë krijuese me objektivat e caktuar të komunikimit.</li> </ul>
<p><b>Kriteri 3.</b> Programet e studimit me karakter profesional synojnë pajisjen e studentëve me një sërë aftësish njohëse dhe praktike gjithëpërfshirëse që nevojiten për të zgjidhur në mënyrë krijuese probleme të karakterit profesional praktik.</p>	<ul style="list-style-type: none"> <li>▪ Theks i fortë i jepet zhvillimit të vazhdueshëm të aftësive të komunikimit; përgatitja, hulumtimi, ideimi dhe ekzekutimi për të arritur shpejt dhe në mënyrë efektive në nivelin profesional zgjidhjeve vizuale që flasin qartë dhe në mënyrë krijuese me objektivat e caktuar të komunikimit.</li> </ul>
<p><b>Kriteri 4.</b> Programet e studimit me karakter profesional synojnë zhvillimin e kompetencave për menaxhimin dhe mbikëqyrje në kuadrin e veprimtarive profesionale dhe orientimin e duhur në</p>	<p>Projektet që studentët do të ndërtojnë do të përparojnë nga të qenit me natyrë teorike në praktike, duke filluar nga modelet abstrakte, duke përdorur tipografinë krijuese dhe duke përfunduar me kompozimin dixhital.</p> <p>Po kështu nën lëndët e kategorisë A synohet që studentët do të:</p> <ul style="list-style-type: none"> <li>▪ Kuptojnë vlerën që komunikimi vizual ka në ndërtimin e një mesazhi.</li> <li>▪ Pajisen me njohuri mbi evoluimin e mediave dhe se si ata mund të jenë konsumatorë dhe prodhues të informacionit, reklamës, marrëdhënieve me publikun dhe argëtimit.</li> </ul>



situata të ndryshme e të ndryshueshme.

- Mësojnë mënyrat mbi identifikimin dhe përdorimin e burimeve efektive në arritjen e qëllimeve nëpërmjet komunikimit vizual.
- Zhvillojnë vlerat e estetikës, qëndrimet profesionale dhe aftësitë personale të nevojshme për përgatitjen si specialistë të multimedias dhe dizajnit grafik
- Kuptojnë vlerën që komunikimi vizual ka në ndërtimin e një mesazhi.

Referuar të gjithë syllabuseve të lëndëve, ato japin si kompetenca teorike ashtu edhe praktike dhe të zbatueshme në vendet e punës.

Referenca

Evidenca 5- Rregullorja e "Programit Profesional në Multimedia dhe Dizajn Grafik"

Evidenca 47- Syllabuset e lëndëve

**Kriteri 5.** Institucioni/njësia kryesore/ kolegji profesional dhe njësia bazë përgjegjëse për programin e studimit përmbush kërkesat ligjore dhe standardet e cilësisë të organizimit, strukturës akademike dhe numrit e shkallës së kualifikimit të stafit akademik.

Fakulteti i Shkencave Humane dhe Drejtësisë është njësia kryesore dhe Departamenti i Shkencave të Komunikimit është njësia bazë përgjegjëse për këtë program studimi.

Fakulteti i Shkencave Humane dhe Drejtësisë si njësia kryesore ka katër departamente kryesore:

- (i) Departamenti i Drejtësisë;
- (ii) Departamenti i Shkencave të Komunikimit;
- (iii) Departamenti i Edukimit dhe Gjuhës Angleze;
- (iv) Departamenti i Shkencave Islame.

KU Bedër është hapur me vendimin e Këshillit të Ministrave të Republikës së Shqipërisë nr. 286 datë 06.04.2011. Ndërsa është akredituar institucionalisht me Vendimin e Bordit të Akreditimit nr. 101 datë 10.11.2017 dhe akredituar periodikisht me vendim të Bordit të Akreditimit nr. 57 datë 16.12.2021 institucioni ka marrë akreditim 5-vjeçar deri në 15.12.2026.

Programi i studimit me karakter profesional "Multimedia dhe Dizajn Grafik" është hapur me urdhër nr. 211 datë 3.7.2020 nga Ministria e Arsimit, Sportit dhe Rinisë (MAS).

**Për vitin akademik 2021-2022, Departamenti i Shkencave të Komunikimit, ku zhvillohet programi i studimit me karakter profesional "Multimedia dhe Dizajn Grafik" ka gjithsej 15 staf akademik nga të cilët:**

**11 personel akademik efektiv PAE (4 Dr dhe 7 Msc) dhe 4 staf akademik me kontratë PAK (1 Prof As, 1 Dr, 2 Msc)**

Fakulteti i Shkencave Humane dhe Drejtësisë si njësia kryesore ka në përbërje të tij të katër departamentet me grada si me poshtë:

Kualifikimi i stafit	Departamenti i Drejtësisë		Departamenti i Shkencave të Komunikimit		Departamenti i Edukimit dhe Gjuhës Angleze		Departamenti i Shkencave Islame	
	PAE	PAK	PAE	PAK	PAE	PAK	PAE	PAK
Prof. Dr	1	1	-	-	-	-	-	-



Prof.Assoc	-	-	-	1	-	-	1	-
Dr/PhD	5	6	3	1	4	1	2	2
Msc*)	4	6	8	2	4	1	7	2
<b>Gjithsej</b>	<b>10</b>	<b>13</b>	<b>11**</b>	<b>4</b>	<b>8</b>	<b>2</b>	<b>10</b>	<b>4</b>

\*) Në përlogaritjet e vlerave të mësipërme, doktorantë në proces janë bashkuar me nr. e personelit me Msc.

Për sa më sipër GVJ konstaton se Njësia kryesore dhe Njësia Bazë përgjegjëse për programin, përmbushin detyrimet ligjore dhe nënligjore për numrin dhe shkallën e kualifikimit të personelit akademik.

Referenca

Evidenca - Raporti i vlerësimit të Brendshëm – Aneks Tabela përmbledhëse – tab 1 (fq 48)

**Kriteri 6.** Programet e studimeve kanë objektiva të përcaktuar qartë për formimin profesional të studentëve, ku përfshihen dijet, aftësitë dhe kompetencat profesionale që duhet të fitojnë studentët në përfundim të programit të studimit dhe që e karakterizojnë profilin profesional të programit.

GVJ konstaton se programi i studimit me karakter profesional “Multimedia dhe Dizajn Grafik” nëpërmjet moduleve dhe lëndëve të ofruara krijon mundësinë formimin profesional të studentëve, ku përfshihen dijet, aftësitë dhe kompetencat profesionale. Objektivat e formimit profesional janë të përcaktuar si në rregulloret ashtu edhe në syllabuset e çdo lënde.

Studimi i tregut dhe rekomandimet e nxjerra nga ky studimi kanë sjellë përfshirjen në program të lëndëve mjaft të rëndësishme siç janë: Design Grafik 1 dhe 2, Fotografi kreative, Teknologji dhe multimedia interaktive, Vizatim Kreativ, etj., japin njohuritë e nevojshme dhe kompetencën profesionale për profilin e studimit.

Referenca

Evidenca - Raporti i vlerësimit të Brendshëm

Evidenca 47 – Syllabuset e lendeve

Evidenca 5- Rregullorja e “Programit Profesional në Multimedia dhe Dizajn Grafik”

Shkalla e përmbushjes së standardit	Nuk përmbushet	Përmbushet pjesërisht	Përmbushet kryesisht	Përmbushet plotësisht
				X

Shkalla e përmbushjes së standardeve të fushës I	Nuk përmbushet	Përmbushet pjesërisht	Përmbushet kryesisht	Përmbushet plotësisht
				X



## II. STRUKTURA DHE PËRMBAJTJA E PROGRAMEVE TË STUDIMIT ME KARAKTER PROFESIONAL

<b>Standardi II.1</b>	
<b>Programet e studimeve me karakter profesional janë të detajuara, informuese, të strukturuar dhe organizuara në përputhje me parashikimet dhe objektivat formuese të programeve të këtij niveli dhe mundësitë e punësimit</b>	
<b>Kriteret</b>	<b>Vlerësimi</b>
<p><b>Kriteri 1.</b> Programet e studimit të ciklit të parë, përmbajnë dhe japin informacionet e nevojshme për objektivat formuese, rezultatet e pritshme të të nxënit, organizimin, strukturën, përmbajtjen, fushat e mundshme të punësimit apo të dhëna reale të punësimit të studentëve të diplomuar në këto programe.</p>	<p>Programi i studimit të ciklit të parë “Multimedia dhe Dizajn Grafik” paraqet qartë objektivat formuese të programit, organizimin dhe strukturën e tij si dhe fushat e punësimit përfutur dhe nga studimi i tregut kryer nga Departamenti i Shkencave të Komunikimit (Evidenca 46), e cila paraqet fushat e mundshme të punësimit.</p> <p>Tipologjia e programit të ofruar në Kolegjin Universitar Bedër, është e një fushe unike dhe të gjerë si ajo e Multimedias dhe Dizajnit Grafik. Mënyra se si ky program është i hartuar në strukturën e tij nëpërmjet dhe lëndëve që ofrohen në këtë program anojnë më se shumti nga fusha e marketingut dhe komunikimit.</p> <p>Programi profesional në "Multimedia dhe Dizajn Grafik" është i strukturuar në 2 vite shkollore dhe 4 semestra të rregullt. Për t'u ofruar studentëve mundësi shtese, ofrohen edhe semestra vere të zhvilluara me kohe të përshpejtuar. Zhvillohen gjithsej 27 lëndë të ndara sipas 2 viteve shkollore (14 lëndë në vitin e parë; 13 lëndë në vitin e dytë. Lende të detyrueshme janë 24. Lende me zgjedhje janë 3. Programi i studimit profesional në "Multimedia dhe Dizajn Grafik" është organizuar në lëndë bazë të detyrueshme , lëndë karakterizuese, lëndë ndërdisiplinore dhe detyrime përmbyllëse, duke respektuar legjislacionin vendas në fuqi dhe Sistemin Evropian të Transferimit dhe Grumbullimit të Krediteve (ETCS).</p> <p>Programi profesional në "Multimedia dhe Dizajn Grafik" ka këto kategori lëndësh:</p> <p>A - Lëndë Bazë - 18 ECTS - 15%;            B - Lëndë Karakterizuese - 66 ECTS - 55%;            C- Lëndë Ndërdisiplinore -15 ECTS - 12.5%;            D - Lëndë Plotësuese -16 ECTS - 13.3%;            E - Detyrime Përmbyllëse - 5 ECTS - 4.16%.</p> <p>Në fushën e Dizajnit, fushe e cila është shumë e gjerë, por dhe e mirëpërcaktuar, “Multimedia” dhe Dizajn Grafik” ofrohen si dy spektre të ndryshme. Multimedia e cila është një fushë që merret me post-produksionin e aspektit Audio/ Video dhe Vizual; dhe Dizajni Grafik e cila fokusohet në rezultatin shprehur nëpërmjet</p>



	<p>komunikimit vizual (print, apo dixhital) të produktit përfundimtare.</p> <p>Në kuadër të vizitës se kryer në institucion dhe takimit të kryer me studentët si dhe pyetjeve drejtuar tyre në lidhje me opinionin rreth programit u vu re se studentët i meshonin me shumë faktit që zhvillimit të lëndëve me praktike.</p> <p>Në lidhje me punësimin e studentëve të diplomuar në këtë program nuk ka akoma të dhëna, pasi cikli i parë i të diplomuarve do të jetë me 2022.</p> <p><u>Reference</u></p> <p><i>Evidenca 21 Lista e aktiviteteve dhe vizitave studimore të studentëve</i></p>
<p><b>Kriteri 2.</b> Programet e studimit janë të organizuara në module/ lëndë e aktivitete formuese, të vlerësuara me kredite, të ndara në vite e semestra e që janë në përputhje me përcaktimet vendëse e evropianë në fuqi.</p>	<p>Programi i studimit profesional në “Multimedia dhe Dizajn Grafik” është një program i zhvilluar në 2 vite akademike dhe 4 semestra.</p> <p>Përgjatë 2 viteve të studimit:</p> <p>Viti I i studimit / semestri I, studenti kryen 7 Lende 30 Kredite</p> <p>Viti I i studimit / semestri II, studenti kryen 7 Lende, 30 Kredite</p> <p>Viti II i studimit / semestri I, studenti kryen 6 Lende, 30 Kredite</p> <p>Viti II i studimit /semestri II, studenti kryen 7 Lende, 30 Kredite</p> <p>Përgjatë takimit në Kolegjin Universitar “Bedër” dhe shqyrtimit të dokumentacionit përkatës, figuronte se në tabelën 10. Plani Mësimore, programi rezultonte se kishte 10 Lëndë me përzgjedhje. Pas komunikimit me grupin e ekspertëve të jashtëm për këtë program, institucioni korrigjoi dhe dërgoi tabelën e saktë me lëndët me përzgjedhje të cilat zhvillohen përgjatë 2 viteve të studimit, 3 lëndë me zgjedhje 1. Historia e Videos dhe Kinemasë; 2. Marketingu dhe Marrëdhëniet Publike Online; 3. Teknikë Filmi dhe Regjie.</p> <p><u>Reference</u></p> <p><i>Dokumenta të kërkuara gjatë vizitës</i></p>
<p><b>Kriteri 3.</b> Programet e studimit përmbajnë planin mësimor, ku përfshihen informacionët e nevojshme për ngarkesën mësimore, orët në auditor, frekuentimin/ ndjekjen e programit, vlerësimin e dijeve, aktivitete specifike etj.</p>	<p>Plani mësimore i programit të studimit profesional në “Multimedia dhe Dizajn Grafik” përmban informacion të saktë në lidhje me ngarkesën mësimore, orët në auditor apo jashtë auditorit, frekuentimin apo ndjekjen e programit. Ky informacion gjendet në <i>Evidencen nr.5 “Rregullorja Programit Profesional”</i> në Multimedia dhe Dizajn Grafik; Neni 16; Tabela “Struktura Programit sipas ndarjeve në Module” ku konstatohen orët e Lëndëve/ Seminare/ Laboratorë si dhe orët e Punës Individuale të studentit për Lëndë.</p> <p>Gjithashtu përtej Rregullores së Programit, cdo sylabus i</p>



	<p>dorezuar nga KU "Bedër" specifikojnë ndarjen e orëve mësimore në Auditor dhe Punës se pavarur, kriteret për frekuentimin dhe metodat e vlerësimit për Lënde; si dhe specifikat e caktuara mbi kërkesat e cdo lënde.</p> <p><u>Reference</u></p> <p><i>Evidenca 5: "Rregullorja Programit Profesional" në Multimedia dhe Dizajn Grafik; Neni 16; Tabela "Struktura Programit sipas ndarjeve në Module"</i></p> <p><i>Evidenca 47 : Sylabuset e Lëndëve</i></p> <p>Informacioni në lidhje me metodat e vlerësimit në këtë program mësimore paraqiten dhe në sylabuset e lëndëve</p>
<p><b>Kriteri 4.</b> Programet e studimit përmbajnë sylabuset e detajuara për secilën lëndë, për praktikat, ushtrimet apo orët e laboratorit, si dhe të gjithë komponentët e aktivitetet formuese të programit të studimit.</p>	<p>Programi i studimit profesional "Multimedia dhe Dizajn Grafik" përmban sylabuset e detajuara për secilën lëndë, te cilat përmbushin kriteret në lidhje vendimin Nr. 41, datë 24.1.2018.</p> <p>Tekstet e mirëfillta në lëndët me karakter teknologjik, janë përgjithësisht në gjuhë të huaj dhe kjo është ndeshur edhe në universitete të tjera. GVJ vlerëson evidencat shtesë të sjella nga institucioni për lëndët e veçanta, ku janë hartuar tutoriale dhe përkthime të tjera. GVJ mori në konsideratë komentet shtesë të sjella nga institucioni. Sygjerohet të vijohet kjo punë duke vijuar me plotësimin/ përkthimin e teksteve /broshurave/ manualeve në gjuhën shqipe, apo video tutoriale për t'ju vënë në dispozicion studentëve.</p>
<p><b>Kriteri 5.</b> Struktura dhe organizimi i programit të studimit është mjaftueshmërisht fleksibël për të mundësuar formimin e studentëve përgjatë programit dhe në përshtatje me punësimin.</p>	<p>Struktura dhe organizimi i programit të studimit është mjaftueshmërisht fleksibël për student të cilët duan të përfshihen menjëherë në tregu e punës, ne lidhje me specifikën e fushes se Multimedias dhe Dizajnit Grafik. Lëndët e ofruara në këtë program studimi i japin mundësinë studentit të përftojë tre aspekte teknike shumë të kërkuara në tregun e punës.</p> <ol style="list-style-type: none"> <li>1.Aspektin multimedial; i cili kërkohet tashmë nga cdo studio televezive, apo kompani të caktuara të cilat përfshijnë këtë fushë (Studio Grafike Brandimi; Studio Reklama; Studio Arkitekture);</li> <li>2. Marketingut;</li> <li>3. Grafik Dizajn, aspekt i cili qëndron lidhur fortë më pjesën e krijimit të kontentit nëpërmjet metodave të ndryshme të Marketingut të cilët studentet përftojnë në këtë program Studimi.</li> </ol> <p><u>Reference</u></p> <p><i>Evidenca 5: "Rregullorja Programit Profesional" në Multimedia dhe Dizajn Grafik; Neni 16; Tabela "Struktura Programit sipas ndarjeve në Module"</i></p>



	<i>Evidenca 47 : Sylabuset e Lëndëve</i>			
<b>Kriteri 6.</b> Mësimi praktik dhe i elementeve të punës konkrete u është dhënë vendi dhe pesha e duhur në strukturë, vlerësim dhe rivlerësim.	<p>Raportet midis lëndëve janë në përputhje me kriteret e përcaktuara nga udhëzimi i MASH.</p> <p>Lëndët me karakter teknologjik kanë një vend të caktuar që mundëson studentët të marrin informacionin e duhur për programet dhe aspektet praktike të profesionit. GVJ mori në konsideratë komentet e përcjella nga institucioni. GVJ sygjeron të vijohet puna për të pasqyruar nëpërmjet leksioneve dhe moduleve të veçanta nevojave e tregut dhe risitë teknologjike në drejtim të “Multimedia dhe Dizajn grafik” të cilat në ditët e sotme kanë një tendencë të shpejtë ndryshimi.</p> <p>Në lidhje me elementët praktikë të të mësuarit të punës, të pasqyruar në program siç janë Dizajni Grafik I, Dizajn Grafik II, Dizajni Multimedial, Dizajni i Reklamave, (Kreativiteti, Produksion), Editim Audio Video, Animacion, të shikohet mundësia për ti kushtuar më shumë vemëndje pasurimit dhe përshtatjes me teknologjitë e reja dhe evoluese.</p> <p>Lëndët e sipërpërmendura janë lëndë të cilat i japin mundësinë studentit për të mësuar dhe kryer praktikën mësimore në sinkron dhe me profilin e programit studimore, por dhe nivelit të ofruar.</p> <p><i>Evidenca 5: “Rregullorja Programit Profesional” në Multimedia dhe Dizajn Grafik; Neni 16; Tabela “Struktura Programit sipas ndarjeve në Module</i></p>			
<b>Shkalla e përmbushjes së standardit</b>	<b>Nuk përmbushet</b>	<b>Përmbushet pjesërisht</b>	<b>Përmbushet kryesisht</b>	<b>Përmbushet plotësisht</b>
				X

<b>Standardi II.2</b>	
<b>Struktura, plani mësimor dhe shpërndarja lëndore e programeve të studimit me karakter profesional, është në përputhje me objektivat formuese, rezultateve të të nxënit sipas Kuadrit Kombëtar dhe Evropian të Kualifikimeve dhe kërkesave të tregut të punës për këto programe.</b>	
<b>Kriteret</b>	<b>Vlerësimi</b>
<b>Kriteri 1.</b> Emërtimi, struktura dhe shpërndarja e në vite e semestra, vlerësimi në kredite e orë mësimore është në përputhje me parashikimet ligjore e nënligjore në fuqi.	<p>Parashikuar dhe në rregulloren themelore të KU “Bedër” për programin profesional në “Multimedia dhe Dizajn Grafik” zbaton dhe funksionon në përputhje të plotë me “Procesin e Bolonjës” dhe kërkesat e ligjit “Për arsimin e Lartë” në Republikën e Shqipërisë.</p> <p>Në këtë program paraqiten qarte objektivat dhe kompetencat profesionale, si dhe proceset mësimore akademike, mundësitë e punësimit, emërtimi i diplomës.</p>



	<p><u>Reference</u></p> <p>Evidenca 5: "Rregullorja Programit Profesional" në Multimedia dhe Dizajn Grafik</p>
<p><b>Kriteri 2.</b> Emërtimi, struktura dhe shpërndarja në vite e semestra, vlerësimi në kredite e orë mësimore mundëson arritjen e objektivave formues të programit të studimit, rezultateve të pritshme të të nxënit dhe punësimin e studentëve.</p>	<p>Në raportin dorëzuar GVJ si dhe përgjatë vizitës në institucion, programi i studimit profesional në "Multimedia dhe Dizajn Grafik" paraqet strukturë të qartë në kuadër të objektivave formuese, njohurive, rezultateve të të nxënit aftësive të cilat studentët përfitojnë në përfundim të këtij programi. Struktura dhe përmbajtja e programit është konceptuar duke mbajtur parasysh formimin bazë të studentëve nga disiplina të ndryshme dhe formimin specifik që garantohet nga lëndë të caktuara me objektiva të parashikuara në aftësimin praktik. Studentët e diplomuar nga ky program përfitojnë një formim të plotë në fushën e medias dhe dizajnit grafik, duke përfshirë disiplina, si krijimi i produkteve multimediale, komunikimin multimodal, komunikimin digital, të cilat përputhen me kërkesat e tregut të punës, përfshi tregun e biznesit privat.</p> <p><u>Reference</u></p> <p>Evidenca 5: "Rregullorja Programit Profesional" në Multimedia dhe Dizajn Grafik</p>
<p><b>Kriteri 3.</b> Plani mësimor, natyra dhe emërtimi i moduleve/ lëndëve; syllabuset e moduleve e të aktiviteteve formuese janë informuese dhe i përmbajnë të gjitha elementet e kërkuara.</p>	<p>Programi profesional në "Multimedia dhe Dizajn Grafik" në rregulloren e haruar nga KU "Beder" si dhe në Syllabuset e dorëzuara për këtë program, zbatohen kërkesat e vendimit të Këshillit të Ministrave nr. 41, datë 24.01.2018 "Për elementët e programeve të studimit të ofruara nga institucionet e arsimit të lartë".</p> <p>Cdo Modul/ Lëndë, përmban syllabuset përkatëse të cilat specifikojnë:</p> <ul style="list-style-type: none"> <li>● Titullin dhe shpjegimin e tipologjisë së Lëndës</li> <li>● Kreditet për lëndë;</li> <li>● Orët Mësimore në Auditor/ Seminare/Leksione si dhe orët e pavarura;</li> <li>● Mënyrat e specifikuar nga Pedagogët e lëndëve në lidhje me kontrollet e dijeve për cdo lëndë;</li> <li>● Specifika shtesë për cdo lëndë në kuadër dhe të tipologjisë së lëndëve të cilat zhvillohen në këtë program mësimorë;</li> </ul> <p><u>Reference</u></p> <p>Evidenca 5: "Rregullorja Programit Profesional" në Multimedia dhe Dizajn Grafik;</p> <ul style="list-style-type: none"> <li>● Neni 16; Tabela "Struktura Programit sipas ndarjeve në Module"</li> </ul>



	<p>• <i>Neni 14: Elementët e programit të studimit</i></p> <p><i>Evidenca 47 : Sylabusët e Lëndëve</i></p>			
<p><b>Kriteri 4.</b> Ka një raport të balancuar midis moduleve/ aktiviteteve të formimit teorik përkundrejt atyre praktike (50:50). Rreth 25% e programit i dedikohet aftësimin në praktikë/punë konkrete në profesion.</p>	<p>Modulet praktike dhe teorike janë të balancuara në raport 55% praktike - 44.96% teorik të ndarjes së lëndë/ modul të cilat plotësojnë raportin module të formimit teorik kundrejt atyre praktik për këtë program studimi. Njohuritë teorike vendosen në zbatim përmes lëndëve me karakter praktik si fotografia, vizatimi kreativ, media sociale, dizajn grafik 1 dhe 2; editim audio dhe video; multimedia, dizajn multimedial; animacion. <b><i>Duke konsideruar se programi është profesional zhvilluar në një hark kohor 2-vjeçar, sugjerohet që të rishikohen dhënia e më shumë krediteve lëndëve të sipërpërmendura, pra lëndëve karakterizuese kundrejt lëndëve ndërdisiplinore.</i></b></p> <p><u>Reference</u></p> <p><i>Evidenca 5: "Rregullorja Programit Profesional" në Multimedia dhe Dizajn Grafik.</i></p> <p><i>Shtojca 1: Plani mësimorë i ndare sipas Veprimtarisë Formuese (tabela 9)</i></p>			
<p><b>Kriteri 5.</b> Klasifikimi sipas aktiviteteve formuese dhe raportet midis formimit teorik dhe praktik mundësojnë arritjen e objektivave formues dhe orientimin e studentit drejt studimeve të mëtejshme dhe/ ose në përshtatje me pritshmëritë e kërkesat e tregut e punës.</p>	<p>Raportet e ndarjes së veprimtarisë formuese të planit mësimor të programit të studimit profesional në "Multimedia dhe Dizajn Grafik" është sipas përqindjeve përkatëse, bazuar edhe në legjislacionin në fuqi. Ndarja është në përputhje me kërkesat ligjore, duke lehtësuar transferimin dhe lëvizshmërinë e studentëve. Lëndët specifike, të këtij programi paraqesin një shpërndarje të qartë të ngarkesës teorike dhe praktike për t'i mundësuar studentit procesin e mësimnxënies praktike. Programi i studimit në "Multimedia dhe Dizajn Grafik" ka përfshirë në kurikulën e tij mundësi praktike në terren në kuadrin e lëndës praktika profesionale.</p> <p><u>Reference</u></p> <p><i>Evidenca 5: "Rregullorja Programit Profesional" në Multimedia dhe Dizajn Grafik.</i></p>			
<p><b>Shkalla e përmbushjes së standardit</b></p>	<p><b>Nuk përmbushet</b></p>	<p><b>Përmbushet pjesërisht</b></p>	<p><b>Përmbushet kryesisht</b></p>	<p><b>Përmbushet plotësisht</b></p>
				X

**Standardi II.3**

**Përmbajtja e lëndëve, moduleve dhe formave të tjera formuese të programeve të studimit me karakter profesional është në përputhje me objektivat formuese, rezultatet e të nxënësve dhe kërkesat e tregut të punës për këto programe**

<b>Kriteret</b>	<b>Vlerësimi</b>
-----------------	------------------



**Kriteri 1.** Programi i studimit përmban të dhëna të plota mbi përmbajtjen e moduleve/ lëndëve të formimit teorik e praktik dhe aktiviteteve të tjera të formimit sipas strukturës e planit të studimit.

Në programin profesional në “Multimedia dhe Dizajn Grafik” plani mësimorë i ofruar Evidenca 5 / Neni 16 tregohet qartë lista e disiplinave dhe veprimtarive formuese të këtij programi, i cili ndahet në 4 semestra me 30 kredite ECTS ose 750 orë mësimore. Vihet re se përgjatë ndarjes së lëndëve në semestrat përkatës ekziston një shpërndarje graduale midis lëndëve bazë me ato karakterizuese të cilat mbajnë peshën më kryesore të krediteve 66 Kredite ECTS 55% lëndëve.

Tabela e planit mësimor për programin e studimit profesional në "Multimedia dhe Dizajn Grafik" "Evidenca 5/ Neni 16 " pasqyron ndarjen e lëndëve/ module sipas semestrave përkatës duke pasqyruar të dhëna në lidhje me mësimin në auditor dhe terren Në tabelën përkatëse shihen qartë ndarja e orëve në total për kete program studimi:

**Orë në Auditor për Leksione:**

Semestri I: 192 orë në auditor

Semestri II – 192-orë në auditor.

Semestri III - 176-orë në auditor.

Semestri IV - 144-orë në auditor.

**Total - 704 orë në auditor për Leksione**

**Orë në Auditor për Seminare:**

Semestri I: 80 orë në auditor

Semestri II - 64-orë në auditor.

Semestri III - 48-orë në auditor.

Semestri IV - 16-orë në auditor.

**Total - 208 orë në auditor për Seminnare**

**Orë në Auditor për Laboratorë:**

Semestri I: 48 orë në auditor

Semestri II - 48-orë në auditor.

Semestri III - 80-orë në auditor.

Semestri IV - 144-orë në auditor.

**Total - 320 orë në auditor për Seminnare**

**Orë në Auditor për Punë Praktike:**

**Total - 16 orë në auditor për Pune Praktike**

**Ndërkohë që shuma vjetore përgjate studimeve 2 vjecare e orëve në auditor është 1264 orë dhe ajo e punës së pavarur të studentit 1466**

Plani mësimor i kushton vëmendje shpërndarjes së lëndëve si dhe orëve në auditor dhe punës së pavarur duke i kushtuar me shumë orë në auditor përgjatë semestrit të parë të vitit të parë; ku shihet shihet qartë se në përfundim të studimeve të këtij programi orët e Seminareve dhe Laboratorëve janë në rritje,



	<p>duke i kushtuar më shumë vëmëndje pjesës praktike të këtij programi.</p> <p><u>Reference</u></p> <p><i>Evidenca 5: "Rregullorja Programit Profesional" në Multimedia dhe Dizajn Grafik.</i></p> <ul style="list-style-type: none"> <li>• <i>Neni 16; Tabela "Struktura Programit sipas ndarjeve në Module"</i></li> </ul>
<p><b>Kriteri 2.</b> Përmbajtja e programit të studimit është aktuale, i plotëson kërkesat e veçanta të profesionit dhe kërkesat për aftësitë shprehite e kërkuara/ të pritshme nga punëdhënësit.</p>	<p>Rregullorja e programit shtjellon se në përfundim të programit profesional në "Multimedia dhe Dizajn Grafik", studentët e diplomuar zhvillojnë dhe aftësojnë aftësi të mirëfillta në fushën e multimedias dhe aspektit të dizajnit grafik.</p> <p>Këto aftësi zhvillohen përgjatë viteve të studimit nëpërmjet aktiviteteve të ndryshme zhvilluar nga departamenti përkatës për këtë program studimi; lista e kompanive ku studentet jo vetëm vizitojnë por dhe kryejnë praktikat profesionale, gjithmonë në koherencë me profilin e zgjedhur.</p> <p>Aspekt pozitiv në pritshmëritë nga punëdhënësit në të ardhmen vlen dhe studimi i tregut zhvilluar nga departamenti përkatës përpara hapjes së programit profesional në Multimedia dhe Dizajn Grafik.</p> <p>Përgjatë vizitës në KU "Bedër" në takimin me student të këtij programi studimor, u vu re dhe përfshirja e tyre në disa kompani, apo përfshirjen e tyre në vetë institucionin përkatës, ku dalloheshe qartë vlera e shtuar e këtij programi studimorë.</p> <p><u>Reference</u></p> <p><i>Evidenca 5: "Rregullorja Programit Profesional" në Multimedia dhe Dizajn Grafik.</i></p> <p><i>Evidenca 21: Lista aktiviteteve dhe vizitave studimore të studentëve</i></p> <p><i>Evidenca 22: Lista kompanive që janë vizituar nga studentët</i></p> <p><i>Evidenca 23: Lista e praktikave profesionale të studentëve</i></p> <p><i>Evidenca 46: Studimi i tregut përpara hapjes së programit profesional Multimedia dhe Dizajn Grafik.</i></p>
<p><b>Kriteri 3.</b> Përmbajtja parashikon zhvillimin e aftësive të transferueshme, e shtrirë edhe në modulet e përmbajtjes e tyre, gjatë zhvillimit të kurrikulës dhe në metodat e mësimdhënies dhe vlerësimit.</p>	<p>Në programin profesional mësimorë në KU "Bedër" në Multimedia dhe Dizajn Grafik, shihet qartë një shtrirje shumë graduale e moduleve dhe përmbajtjes së tyre. Duke marrë parasysh këtë profil studimi, i cili është një zhanër e re në territorin Shqiptar, studentet e këtij programi aftësohen si në fushën e Multimedias dhe Dizajnit Grafik.</p> <p>Duhet theksuar së jashtë vendit këto dy fusha shihen të ndara nga njëra tjetra, por në rastin në fjalë ky program profesional 2 vjecar i aftëson më së miri studentët për të hartuar një bazë të qëndrueshme, të cilën mund ta vazhdojnë akoma më tej me studimet e Bachelorit në programe të ngjashme. Gjatë vizitës në KU "Bedër" por dhe gjatë shqyrtimit të dokumentacionit të vënë</p>



	në dizpozicion, mënyrat alternative të mësimdhënies mirëpritur nga studentet duke venë në dispozicion jo vetëm laboratorët kompjuterikë për këtë program, por dhe punën në grup midis studentëve, vizitat në kompani të ndryshme të këtij profili, etj.			
<b>Kriteri 4.</b> Modulet dhe aktivitetet e formimit teorik e praktik/ punë konkrete mundësojnë përfundimin e njohurive, aftësive dhe shkathtësive ndërkurrikulare, të menduarit kritik, zgjidhjen e problemeve në kontekste konkrete, komunikimin dhe marrëdhëniet me të tjerë, si dhe orientimin cilësor në përvojën e punës.	Programi profesional në "Multimedia dhe Dizajn Grafik" përgatit e individë të kualifikuar në fushën e multimedias, dizajnit grafik, në fushën e mediave të reja, marketingut të integruar dhe në fusha të ngjashme me to, nëpërmjet një filozofie arsimimi që ka në thelb vlerat universale, si edhe mbështetjen e kërkimit shkencor, me qëllim vënien në jetë të ideve dhe projekteve që ndikojnë në përmirësimin e jetës së njeriut dhe të mbarë shoqërisë, në përputhje edhe me zhvillimet e teknologjisë bashkëkohore. Lëndët kategorizohen në grupe të ndryshme me karakter praktik dhe teorik.  <i>Reference</i> <i>Evidenca 25 Dosja e plotë e aplikimit për programin profesional në "Multimedia dhe Dizajn Grafik"</i>			
<b>Kriteri 5.</b> Bashkëpunimi me punëdhënësit, internship-i/ përvoja praktike, tutorazhi, e vlerësimi i tyre në profesion është e mjaftueshme, e përshtatshme dhe garanton formimin praktik në përputhje me kërkesat e profesionit.	KU Bedër, dhe Departamenti i Shkencave të Komunikimit gjatë vizitës së grupit të GVJ, shihet qartë se u kushton rëndësi të veçantë praktikave profesionale sipas programeve përkatëse. Prandaj, gjatë verës dhe gjatë vitit akademik, studentët u ofrohet mundësia të ndjekin praktika profesionale pranë institucioneve, organizatave dhe bizneseve të ndryshme, me të cilat departamenti dhe institucioni ka marrëveshje të ndryshme bashkëpunimi.  <i>Reference</i> <i>Evidenca 23: Lista e praktikave profesionale të studentëve</i> <i>Evidenca 26 Lista e trajnimeve të stafit</i>			
<b>Shkalla e përmbushjes së standardit</b>	<b>Nuk përmbushet</b>	<b>Përmbushet pjesërisht</b>	<b>Përmbushet kryesisht</b>	<b>Përmbushet plotësisht</b>
				X

<b>Shkalla e përmbushjes së standardeve të fushës II</b>	<b>Nuk përmbushet</b>	<b>Përmbushet pjesërisht</b>	<b>Përmbushet kryesisht</b>	<b>Përmbushet plotësisht</b>
				X



### III. MËSIMDHËNIA, MËSIMNXËNIA, VLERËSIMI DHE KOMPETENCAT

Standardi III.1	
Institucioni garanton zhvillimin e mësimdhënies, mësimnxënies dhe aftësimin profesional përmes politikave e udhëzimeve të posaçme dhe mbështetet në metodat dhe praktikat më të mira të fushës	
Kriteret	Vlerësimi
<p><b>Kriteri 1.</b> Institucioni harton udhëzues të posaçëm, ngre struktura të posaçme dhe zhvillon mekanizma të vlerësimit e të monitorimit të cilësisë së mësimdhënies dhe metodave të përdorura dhe aftësive të stafit të angazhuar, duke përfshirë aktivisht studentët në këtë proces. Rezultatet e këtyre vlerësimeve bëhen publike.</p>	<p>Institucioni merr masa për sigurimin e mbarëvajtjes së planit mësimor për çdo program. Rregullorja e programit përkatës udhëzon drejtpërdrejtë në lidhje me hartimin e plane për secilin program dhe nxitjen e përdorimit të metodave të ndryshme bashkëkohore dhe inovative të mësimdhënies.</p> <p>Institucioni harton politika dhe ka në funksion mekanizma të kontrollit të cilësisë. NJSBC-ja si strukturë ka në përbërje edhe përfaqësues të studentëve.</p> <p>Përgjatë vitit akademik 2019-2020 dhe 2020-2021, institucioni hartoi material udhëzues mbi metodat dhe platformat e mësimdhënies në distancë dhe ku dhe realizuan trajnime online për përdorimin e platformës G-Suite për realizimin e procesit mësimor në kushtet e situatës së jashtëzakonshme të shkaktuar nga pandemia Covid-19. Këto udhëzues dhe aktivitete janë të publikuara në faqen zyrtare të internetit.</p> <p><i>Reference</i></p> <p><i>Evidenca 53 Anketa vlerësuese për lëndën dhe pedagogun nga studentët</i></p> <p><i>Evidenca 54: Anketë vlerësimi e mendimit të studentëve ndaj institucionit</i></p> <p><i>Evidenca 59 Udhëzim mbi mësimdhënien në distancë</i></p>
<p><b>Kriteri 2.</b> Format e mësimdhënies, mësimnxënies dhe transmetimit të dijeve e njohurive janë leksionet, seminarët, laboratorët, detyra e kursit/ eseja, praktikat profesionale e klinike, orët e hapura dhe çdo formë tjetër e miratuar nga institucioni e që është e përshtatshme për realizimin e programit të studimit.</p>	<p>Elementët e studimeve, të parashikuara në rregulloren e institucionit në përputhje me specifikën e programit të studimit, përfshijnë leksionet, seminarët, ushtrimet, praktikat mësimore e profesionale, provimet e ndërmjetme dhe përfundimtare, detyrat e kursit, projektet etj. Ky informacion paraqitet dhe në sylabuset e lëndëve.</p> <p>Departamenti i Shkencave të Komunikimit organizon udhëtime, vizita, leksione të hapura, konferenca ose workshop-e në mënyrë që të mbështesë procesin e mësimdhënies. Në lidhje me tipologjinë e vacante të programit profesional në "Multimedia dhe Dizajn Grafik", Kolegji Universitar "Bedër" disponon dy laboratorë kompjuterikë me pajisje të kohës, në mënyrë që leksionet të jenë sa më të praktikueshme me detyra dhe ushtrime të posaçme sipas leksionit.</p> <p>Pjesë e këtij programi profesional në "Multimedia dhe Dizajn Grafik" janë dhe vizitat në studiot e dizajnit dhe mediave dixhitale, leksione të hapura me pjesëmarrjen të fushës ku studentët e programit profesional në "Multimedia dhe Dizajn Grafik" njihen më nga afër me ekspert të fushave që i përkasin fushës së multimedias dhe dizajnit.</p>



	<p><u>Reference</u></p> <p>Evidenca 22: Lista e kompanive që janë vizituar nga studentët</p> <p>Evidenca 27: Lista e të ftuarve në leksionet e hapura</p> <p>Evidenca 47: Sylabuset e lëndëve</p> <p>Evidenca 49: Sylabuset e lëndëve "Vizatim Kreativ" dhe "Fotografi"</p>
<p><b>Kriteri 3.</b> Personeli akademik përdor forma, mënyra, metoda e mundësi alternative të mësimdhënies e mësimnxënies, në përputhje me natyrën e programit të studimit në përgjithësi dhe moduleve e aktiviteteve formuese në veçanti, në përgjigje dhe të diversitetit dhe nevojave të studentëve.</p>	<p>Duke marrë parasysh tipologjinë e programit profesional në "Multimedia dhe Dizajn Grafik"; kohëzgjatjen e tij si dhe diversitetin e studentëve që ky program mirëpret, format e mësimdhënies i cili personeli akademik përdor përshatet me tipologjinë e programit.</p> <p>Duke marrë parasysh dhe përfshirjen vizitave studimore apo kompanive ku studentët jo vetëm i vizitojnë si pjesë e procesit mësimorë por dhe në kuadër të zhvillimit të praktikës mësimore, programi i tipologjisë profesional dhe metodat e ndjekura e mundëson studentin të njihet menjëherë me tregun e punës.</p> <p>Procesi i zhvillimit të mësimdhënies në përputhje me natyrën e programit apo moduleve të ofruara, kontrollohet në mënyre periodike nga strukturat e brendshme të institucionit NJSBC.</p> <p><u>Reference</u></p> <p>Evidenca 22: Lista e kompanive që janë vizituar nga studentët</p> <p>Evidenca 23: Lista e praktikave profesionale të studentëve</p>
<p><b>Kriteri 4.</b> Personeli akademik i angazhuar në mësimdhënie është kompetent në shpjegimin e njohurive e koncepteve dhe përdor metoda të ndryshme të mësimdhënies, përfshirë ato interaktive e gjithëpërfshirëse, sipas tematikave dhe profilit.</p>	<p>Personeli akademik i angazhuar në programin profesional në "Multimedia dhe Dizajn Grafik" në KU "Bedër" janë të profilit artistik me fokus në disiplinat e Multimedias dhe Artit Grafik si dhe Shkenca Komunikimi, faktorë të cilët i bënë kompetent në fushën e tyre dhe në kalimin e njohurive tek studentet.</p> <p>Stafi akademik i angazhuar në këtë program studimi sipas viteve është:</p> <p>Viti akademik 2020- 2021: 6 PAE (3 Dr; 3 Msc) dhe 4 PAK (1 Prof As; 3 Msc)</p> <p>Sipas tabelës 4 të RVB, në kolonën 3 sipas saj janë gjithësej 73 orë mësimore të ndara 64 nga PAE dhe 9 nga PAK. Në këtë tabelë ka edhe një shënim që nëse grupet e mësimimit bëjnë të njëjtën lëndë në programe të ndryshme studimi dhe klasat bashkohen, atëherë ngarkesa mësimore llogaritet vetëm një herë.</p> <p>Ndërkohë sipas tabelës 12.1 në RVB janë gjithësej 37 orë nga këto 13 ore nga PAK (35%) dhe 24 ore nga PAE (65%). Nuk plotësohet kriteri mbi 70% mbulohet nga staf efektiv.</p>



Për vitin akademik 2021- 2022: 12 PAE (6 Dr; 6 Msc) dhe 4 PAK (1 Prof As; 1 Dr; 2 Msc).

Përsa i takon ngarkesës mësimore të stafit ne programin 2-vjecar të KU Bedër "Multimedia dhe dizajn grafik" gjatë vizitës në institucion GVJ kërkoi materiale plotësuese tabelën 12.2 (të përditësuar. Sipas përlogaritjeve në këtë tabelë për vitin akademik 2021-2022 ngarkesa totale në orë është 89 orë, të ndara në 74 orë nga PAE (pra rreth 83.1%) dhe 15 orë nga PAK (pra 16.9%) pra plotësohet kriteri mbi 70% e orëve nga PAE.

Vetë programi i studimit ka nevojë për mënyra të ndryshme interaktive në mësimdhënie, që nga studio kompjuterike, njohurive të aparaturave dixhitale si dhe programeve kompjuterike të përdorur në këtë fushë. Gjithashtu ndërthurja e lëndëve me profil komunikim apo marketim ndihmon studentët për të zhvilluar jo vetëm aftësitë vizuale të këtij profesioni por dhe ato komunikuese.

Përgjatë vizitës në KU "Bedër" GVJ u njoh dhe me mënyrat se si studentët vlerësojnë punën e kryer nga pedagogët e lëndëve në këtë program, kjo nëpërmjet "Anketes Vlerësuese e studentit për stafin akademik" Evidenca 51; anketë e cila synon të mbledhë informacion periodik në lidhje me cilesinë dhe metodat e mësimdhënies së stafit akademikë në këtë program studimi.

Përtej mësimdhënies fizike, duhet theksuar dhe vështitë e hasura gjatë Pandemisë Covid -19, ku ka ndikuar në kërkesën e krijimit të mënyrave alternative për mësimdhënien në kushte jo të zakonshme.

Fakti që për vitin akademik 2021-2022 ngarkesa totale në orë mësimore është rreth 83% e mbuluar nga PAE dhe rreth 17% e mbuluar nga PAK është mjaft pozitiv në reflektim të zbatimit të kriterëve të vendosura. Ky është viti i dytë mësimor për këtë program studimi, dhe në një farë mënyre është viti i cili reflekton treguesit mësimor, pasi viti akademik 2020-2021 ishte viti i mbulura tërësisht nga Pandemia COVID -19, dhe vështirësitë ishin për të gjitha universitetet edhe për programet ekzistuese. GVJ mori në konsideratë argumentimin e institucionit.

#### Reference

*Evidenca 53: Anketa vlerësuese për lëndën dhe pedagogun nga studentet*

*Evidenca 51 Anketë e posacme realizuar në kushtet e pandemisë Covid-19*

*RVB, Tab 6.1 dhe 6.2*



	RVB, Tab 10 RVB, Tab 12.1 dhe Tab 12.2			
<b>Kriteri 5.</b> Institucioni duhet të mbështesë stafin përmes njohjes me shembujt e praktikave të mira, të nxisë dhe të inkurajojë personelin akademik për përmirësimin e mëtejshëm të cilësisë së mësimdhënies.	<p>Duke synuar qëndrueshmërinë dhe garantimin e cilësisë në mësimdhënie, si edhe kualifikimet e personelit në fushën profesionale dhe atë të kërkimit shkencor, KU "Bedër" organizon trajnime, të cilat janë mbështetur nga zyra e NJSBC dhe zyra e burimeve njerëzore. NJSBC në këtë rast është iniciatorja për të propozuar trajnime për stafin të burimet njerëzore. Institucioni promovon shembujt e praktikave të ndryshme dhe motivon stafin akademik.</p> <p>Gjithashtu gjatë takimit në KU "Bedër" me personelin përgjegjës së NJSBC; përfaqësues se Departementit dhe grupit të stafit akademikë; institucioni inkurajon përfshirjen e stafit akademikë në programe mobiliteti në Erasmus +, duke nxitur dhe promovuar mënyra të reja në mësimdhënie.</p> <p><i>Reference</i></p> <p><i>Evidenca 15: Certifikata pjessëmarrje të personelit akademik në aktivitete ndërkombëtare</i></p> <p><i>Evidenca 16 Dokument i pjessëmarrjes në Bologna Hub Peer Support</i></p>			
<b>Shkalla e përmbushjes së standardit</b>	<b>Nuk përmbushet</b>	<b>Përmbushet pjesërisht</b>	<b>Përmbushet kryesisht</b>	<b>Përmbushet plotësisht</b>
				X

<b>Standardi III.2</b>	
<b>Njësitë përgjegjëse garantojnë zhvillimin e mësimdhënies, mësimnxënies dhe aftësimin profesional, duke vënë në dispozicion të gjithë infrastrukturën fizike, didaktike e logjistike të nevojshme për realizimin me sukses të aktivitetit mësimor e shkencor</b>	
<b>Kriteret</b>	<b>Vlerësimi</b>
<b>Kriteri 1.</b> Procesi mësimor teorik e praktik, realizohet në hapësira të mjaftueshme dhe cilësore, funksionale dhe të pajisura me logjistikën e nevojshme për realizimin me cilësi të procesit mësimor.	Infrastuktura e ngritur për zhvillimin e procesit mësimor të programit të studimit profesional në "Multimedia dhe Dizajn Grafik" është e bollshme dhe e kompletuar. Duhet nënvizuar se IAL në këtë drejtim ka kryer investime serioze dhe me perspektive. Hapësirat për realizimin e procesit mësimor, auditorët, laboratorët, salla e bibliotekës, etj janë të e duhura për zhvillimin e mësimin dhe përballojnë një kontingjent disa here me të madh të studentëve nga ai qe është aktualisht në përgatitje. Mjediset mësimore dhe hapësirat ndihmese janë të pajisura me mjetë elektronike dhe të teknologjisë se informacionit, të cilat garantojnë realizimin e procesit mësimor.
<b>Kriteri 2.</b> Personeli akademik dhe studentët shfrytëzojnë sisteme të ndryshme informatike, infrastrukturë të konsoliduar IT	Personeli akademik dhe studentët shfrytëzojnë sisteme kompjuterike hardëare dhe softëare në kuadër të plotësisht të kërkesave të procesit mësimor. Laboratorët përkatës janë



<p>të nevojshme për realizimin e procesin mësimor, si dhe sistemet e komunikimit të brendshëm për akses në dokumentacionin elektronik dhe hapësirë vetjake të dedikuar.</p>	<p>të pajisur me kompjuter ëindoës dhe përmbajnë softëare të MS Office; Adobe, SAP2000, ETABS, Net Visual Studio, GNS3, Vray, 3DMAX, programe të cilat janë esenciale për këtë program studimi.</p>
<p><b>Kriteri 3.</b> Literatura bazë dhe ndihmëse e vënë në dispozicion të studentëve në gjuhën e programit të studimit (fizike dhe elektronike) garanton marrjen e dijeve dhe njohurive të nevojshme të parashikuara në programin e studimit.</p>	<p>Për realizimin e programit të studimit që ofrohet në këtë institucion, janë bërë përpjekje të mira në drejtim të sigurimit të literaturës bazë dhe ndihmëse që lidhet me këtë program. Po ashtu është siguruar literatura e nevojshme që është e botuar deri sot në gjuhën anglisht për këtë program dhe jo tekste në gjuhën shqip. Ky është një problem ende jo plotësisht i zgjidhur në shkallë vendi pasi botimet e literaturës profesionale në multimedia dhe dizajn grafik mungojnë.</p> <p>Literatura e venë në dispozicion nga pedagogët e lëndëve behet me kërkesë në departament për tituj të rinj, si dhe pedagogu i lëndës përcakton dhe përditëson literaturën në varësi të lëndës.</p>
<p><b>Kriteri 4.</b> Në funksion të mësimdhënies dhe mësimnxënies, personeli akademik dhe studentët aksesojnë libraritë on-line të fushave të ngjashme ose të përafërta me programin e studimit.</p>	<p>Në këtë institucion biblioteka ka akses dhe anëtarësim të plotë në JSTOR. Çdo anëtar i stafit të KU Bedër dhe studentët mund të hyjnë në JSTOR nëpërmjet llogarisë mail të institucionit.</p> <p><i>Referenca</i></p> <p><i>Evidence 47 Syllabuset e lëndëve</i></p>
<p><b>Kriteri 5.</b> Infrastruktura laboratorike e nevojshme për realizimin e laboratorëve, detyrave të kursit, diplomave dhe studimeve specifike shfrytëzohet në mënyrë të vazhdueshme nga studentët.</p>	<p>Infrastruktura e nevojshme laboratorike për këtë program studimi është e plotësuar në sasi të nevojshme dhe sipas kërkesave të tij specifike. Ajo krijon mundësinë e realizimit në kushte optimale të detyrave të programit, detyra kursi apo studime specifike të karakterit profesional. Laboratori i multimedias është i pajisur me çdo gjë të nevojshme dhe simulon situatën konkretë të punës.</p>
<p><b>Kriteri 6.</b> Në funksion të mësimdhënies, personeli akademik përdor platforma on-line (elearning) dhe mbështet e nxit personelin akademik e studentët për përdorimin e tyre.</p>	<p>Në IAL BEDER, në funksion të procesit mësimor dhe të edukimit profesional, personeli akademik dhe studentët e këtij programi përdorin platform on-line (elearning). Në institucion përdoren platforma G-Suite e cila ofron shërbimet si email, hapësirë pa limit të drive; video - konferenca, klasa virtuale, etj. Gjatë periudhës së pandemisë Covid-19, kjo platforme siguroi vazhdimësi të pandërprerë.</p> <p>Për stafin akademike, studentët dhe stafin administrativ përdoret platforma G-Suite.</p> <p><i>Referenca</i></p> <p><i>Evidenca 50 Shembull- Shkresë drejtuar një kompanie për realizimin e praktikave mësimore</i></p>



Shkalla e përmbushjes së standardit	Nuk përmbushet	Përmbushet pjesërisht	Përmbushet kryesisht	Përmbushet plotësisht
				X

### Standardi III.3

Institucioni ngre struktura të posaçme në nivel institucional, të cilat garantojnë cilësinë e mësimdhënies dhe mësimnxënies në programet e studimit dhe rritjen e vetëdijes për përmirësimin e tyre

Kriteret	Vlerësimi
<p><b>Kriteri 1.</b> Institucioni organizon struktura/ njësi në nivel institucional që ndjekin, vlerësojnë dhe monitorojnë procesin e mësimdhënies dhe koordinojnë dhe bashkërendojnë me njësitë kryesore/ bazë aktivitetet në kuadër të përmirësimit të cilësisë së saj.</p>	<p>KU "Beder" ka organizuar në nivel institucional strukturë të posaçme për monitorimin dhe rritjen e cilësisë së programit të studimit Multimedia dhe Dizajn Grafik (NJSBC). Ajo është përbërëse për sigurimin e cilësisë dhe bashkëpunon me njësinë kryesore dhe atë bazë për organizimin e veprimtarive të saj në funksion të përmirësimit të cilësisë, për të dhënat që nxjerr gjatë veprimtarisë së saj dhe problemet që evidenton. NJSBC kryen anketime të programuara jo me pak se dy here në vit ku ka marre në mënyrë anonime mendimet e studentëve apo stafit për mjaft procese që lidhen me mësimdhënien si përmbajtja e kurikulës, mendime lidhur me planin mësimor, vlerësimi i studentëve lidhur me mënyrat e mësimdhënies, aftësitë e pedagogeve në leksione e praktika, objektiviteti i tyre në vlerësime gjatë vitit dhe në provime e mjaft çështje të tjera. GVJ pati mundësi të vëzhgojë pyetësorë të tilla, ku të dhënat që përmbajnë këto anketa pas përgjigjes që kanë dhënë studentët janë grumbulluar e përpunuar dhe prej tyre janë nxjerre detyra të mëtejshme për përmirësimin e cilësisë së mësimdhënies. Këto të dhëna u janë dërguar njësisë kryesore dhe asaj bazë dhe kanë shërbyer si indicie për programe punë dhe rritjen e mëtejshme të cilësisë së realizimit të programit.</p> <p><i>Reference</i>  Evidenca 12 Rregullorja për funksionimin dhe organizimin e NJSBC-së  Evidenca 6 Evidenca 6 Rregullorja e anketave dhe vlerësimeve  Evidenca 53 Anketa vlerësuese për lëndën dhe pedagogun nga studentët  Evidenca 39 Procedura e vlerësimit të performancës së stafit akademik  Evidenca 52 Anketa vlerësuese nga Stafit Akademik ndaj institucionit</p>
<p><b>Kriteri 2.</b> Njësia kryesore/ bazë është përgjegjëse për procesin e mësimdhënies, cilësinë e saj dhe rritjen e vetëdijes të personeli akademik dhe studentët për</p>	<p>Njësia kryesore dhe ajo bazë janë përgjegjëse për cilësinë e mësimdhënies në IAL Bedër. Ato kanë punuar sistematikisht për rritjen e vetëdijes së personelit akademik dhe ndihmës, po ashtu edhe të studentëve, lidhur me rritjen</p>



<p>cilësinë në programet e studimit që ofron.</p>	<p>e cilësisë në programin e studimit që ofrohet. Në statutin e Institucionit dhe rregulloren e programit të studimit janë të përcaktuara qartë detyrat kryesore lidhur me procesin e mësimdhënies dhe sigurimin e cilësisë së tij, aktivizimin e studentëve dhe të gjitha detyrat e tjera që lidhen me mësimdhënien dhe sigurimin e cilësisë së saj. Njësia bazë dhe Përgjegjësi i saj janë autoriteti i ngarkuar me gjithë ecurinë dhe cilësinë e mësimdhënies. Përgjegjësi i Departamentit është autoriteti më i lartë akademik në detyra dhe kompetenca për cilësinë e realizimit të programit të studimit.</p> <ul style="list-style-type: none"> <li>- Drejton punën në lidhje me hartimin e planeve mësimore dhe programeve të lëndëve për programin, kontrollon ato dhe monitoron zbatimin e tyre.</li> <li>- Ndjek dhe kontrollon pjesëmarrjen e studentëve si ndihmës në grumbullimin e të dhënave dhe realizimin e procesit të kërkimit shkencor.</li> <li>- Ngre komisionet e provimeve dhe monitoron procesin e vlerësimit të dijeve.</li> <li>- Organizon analiza të aspekteve të punës mësimore gjatë vitit dhe analiza semestrale e vjetore lidhur me ecurinë e punës për realizimin e suksesshëm të programit të studimit Multimedia dhe Dizajn Grafik.</li> </ul>
<p><b>Kriteri 3.</b> Personeli akademik dhe personeli ndihmësakademik janë përgjegjës për zbatimin e programeve të studimeve dhe angazhohen për përmirësimin e mësimdhënies dhe implementimin e metodave të reja, në përputhje me natyrën dhe specifikën e programeve profesionale.</p>	<p>Personeli akademik dhe ai ndihmës, të drejtuar nga drejtuesi i Departamentit, janë përgjegjës për realizimin e programit të studimit që është implementuar në këtë IAL. Ata janë të angazhuar në veprimtarinë e përditshme të tyre për ecurinë e tij dhe realizimin cilësor të gjithë aktivitetit mësimor e praktikave profesionale. Ka një interesim të veçantë nga ana e stafit mësimdhënies për përmirësimin e aftësive mësimdhënëse dhe për futjen e metodave të reja e inovative të mësimdhënies.</p> <p>Për një program të tillë profesional në Multimedia dhe Dizajn Grafik, botimi i teksteve në gjuhën shqipe apo regjistrimi i tutorialeve për lëndë me karakter profesional do të ishte një vlerë e shtuar për këtë program.</p>
<p><b>Kriteri 4.</b> Strukturat dhe njësitë përgjegjëse mbështesin eksperimentimin dhe zhvillimin e metodave të reja inovative të mësimdhënies përmes trajnimeve të vazhdueshme të personelit akademik për përmirësimin e aftësive të mësimdhënies dhe implementimit të tyre.</p>	<p>Strukturat dhe njësitë e IAL kanë trajnuar vazhdimisht personelin akademik për të përmirësuar aftësitë mësimdhënëse dhe për të implementuar metoda të reja inovative në këtë proces. Përveç kualifikimeve shkencore që zotërojnë pedagogët dhe i gjithë stafi akademik i angazhuar për realizimin e këtij programi, ka qenë pjesëmarrës aktiv në të gjitha format që përdoren për kualifikimin e mëtjeshëm të tij, si brenda apo jashtë institucionit. Aplikimi i metodologjive të reja në</p>



	mësimdhënie janë çështje të cilat lidhen me anën infrastrukturore të institucionit, ashtu si dhe me strategjinë e cilësisë se KU “Bedër”.			
<b>Kriteri 5.</b> Personeli akademik dhe personeli ndihmësakademik testojnë metoda të reja në mësimdhënie, analizojnë efektet e pritshmëritë dhe raportojnë në mënyrë periodike për rezultatet në strukturat dhe njësitë përgjegjëse.	<p>Metodat e mësimdhënies që përdoren në këtë institucion, sidomos ato që lidhen me praktikat profesionale në fushën e multim medias. Pavarësisht bllokimit që çdo institucion IAL pati gjatë Pandemisë 2020; programe të tilla profesionale në multimedia dhe dizajn grafik kërkuar një përshtatje të shpejt për të mposhtur boshllëkun e krijuar. Përmes mënyrave bashkëkohore të zhvillimit të mësimi në auditore, ky program studimi dhe stafi i tij pjesëmarrës në këtë program duhet të hartojnë një metodologji mësimdhënie alternative për këtë fushë studimi dhe cikël studimi. Përtej të dhënave apo shembujve të paraqitur gjatë vizitës së GVJ në KU “Bedër”, studentit duhet ti krijohet mundësia të ketë materiale video tutoriale për lëndët bazë sidomos në gjuhën shqipe.</p> <p>Departamenti përkatës vazhdimisht kontrollon dhe monitoron aktivitetin mësimdhënies e po ashtu pedagogët vazhdimisht raportojnë për rezultatet e pritshme dhe implementimin e metodave të reja. Kjo ka sjelle që nga viti në vit të ketë përmirësime të dukshme çka u konstatua gjatë vizitës në institucion si dhe nga takimi i organizuar me studentët që po vazhdojnë këtë program studimi dhe ata që e janë në përfundim. Këtë proces e ndjek me vëmendje edhe NJSBC e cila përveç kontakteve direkte me studentët, ka hartuar pyetësorë dhe ka realizuar intervista në kushte anonimati, rezultatet e të cilave janë përpunuar e konkluzionet e tyre njihen dhe shërbejnë si program punë për të ardhmen.</p> <p><i>Reference</i></p> <p><i>Evidenca 42 Raporti vjetor i Departamentit të Shkencave të komunikimit 2019-2020</i></p> <p><i>Evidenca43 Raporti vjetor i Departamentit të Shkencave të komunikimit 2020-2021</i></p>			
<b>Shkalla e përbushjes së standardit</b>	<b>Nuk përbushet</b>	<b>Përbushet pjesërisht</b>	<b>Përbushet kryesisht</b>	<b>Përbushet plotësisht</b>
				X

<b>Standardi III.4</b>	
<b>Institucioni harton rregullore dhe procedura të posaçme për vlerësimin e njohurive, dijeve dhe aftësive profesionale dhe garanton vlerësim të drejtë dhe transparent, bazuar në meritën për çdo student.</b>	
<b>Kriteret</b>	<b>Vlerësimi</b>



<p><b>Kriteri 1.</b> Kriteret dhe mënyra e testimit e vlerësimit të njohurive dijeve dhe aftësive profesionale përcaktohen në rregullore të posaçme, të cilat bëhen publike. Institucioni mban dhe ruan dokumentacionin e vlerësimeve, ankimimet dhe rishqyrtimet e vlerësimit, sipas afateve e procedurave në rregulloret përkatëse.</p>	<p>Njësia kryesore dhe ajo bazë të IAL kanë rregulloret e tyre të funksionimit të aktivitetit të tyre si dhe një rregullore të posaçme për këtë program studimi. Në rregulloren e programit të studimit profesional në “Multimedia dhe Dizajn Grafik” janë të përcaktuara të gjitha kërkesat që lidhen me zbatimin e këtij kriteri.</p> <p>Rregullorja e këtij programi parashikon në mënyrë të qartë modalitetet e vlerësimit ku përcaktohen dhe format e ndryshme të vlerësimit aplikuar nga pedagogje të ndryshëm. Pësha specifike e komponentëve të vlerësimit përfundimtare për secilën lëndë varion:</p> <p>5-10 % pjesëmarrja  10-20% plotësimi i detyrimeve (laboratore, detyra kursi)  20-30% testimet gjatë vitit;  40-50% provimi përfundimtare.</p> <p>Studenti gjithashtu në fillim të studimeve të tij/saj pajiset me Guidën e Studentit, e cila përmban dhe informon studentët për të gjitha rregulloret; politikat e kolegjit Universitar Bedër; si dhe çdo proces lidhur me studimet e tyre. Çdo dokument paraqitet dhe në faqen zyrtare të KU “Bedër”</p> <p><i>Evidenca 5 Rregullorja e “Programit profesional në Multimedia dhe Dizajn Grafik</i></p>
<p><b>Kriteri 2.</b> Testimi e vlerësimi i njohurive, dijeve dhe aftësive profesionale e shkencore realizohet në forma dhe mënyra të ndryshme, duke i dhënë mundësi studentit të demonstrojë njohuritë dhe kompetencat e fituara.</p>	<p>Testimi dhe vlerësimi i dijeve, njohurive dhe shprehive profesionale që fitohen çdo ditë, po ashtu testohen në mënyrë të përditshme dhe në çdo ore mësimi e praktike. Këto forma përfshijnë: testimet gjysmën finale, projekte, detyrat e kursit, prezantime, etj. Këto kontrole të njohurive zhvillohen dhe në laboratorët përkatës por dhe në lëndën e praktikave profesionale që ka institucioni, në bashkëpunim dhe me institucionet përkatëse që programi ka lidhur marrëveshje bashkëpunimi. Në të gjitha këto raste studenti e ka mundësinë që të shpalose njohuritë dhe aftësitë profesionale të fituara gjatë procesit të mësimi apo të praktikës. Testimi dhe vlerësimi i njohurive, dijeve dhe shprehive praktike të fituara nga ana e studentëve, konsiderohet një moment kyç në punën e pedagogjeve, të cilët e verifikojnë atë në të gjitha rastet e mundshme, sipas parimeve të njohura didaktike. Ata i kushtojnë rëndësi të posaçme jo vetëm kontrollit të përditshëm të dijeve, por edhe hartimit të testit në provime kontrolli, semestrale apo dhe vjetore që pyetjet të jenë përgjithësuese dhe të shprehin esencën e dijeve për atë problem, fenomen apo procedure praktike. Zakonisht ato hartohen në mënyrë koncize, me alternative përgjigjeje, duke i dhënë mundësi studentit të beje analize e të diferencojë fenomenet dhe të japë përgjigjen e saktë.</p>



	<p><i>Reference</i></p> <p><i>Takimet në IAL</i></p>
<p><b>Kriteri 3.</b> Në fillim të çdo lënde/ moduli, studentët informohen me metodologjinë e testimit e vlerësimit të njohurive, dijeve dhe aftësive profesionale e shkencore të parashikuara në syllabuset e lëndëve/ moduleve nga titullari i lëndës /modulit.</p>	<p>Në përmbajtjen e të gjitha syllabuseve është përcaktuar edhe mënyra e kontrollit të dijeve dhe titullari i lëndës ka përcaktuar se kjo mund të behet me goje, me shkrim, ose i kombinuar për lëndët me karakter profesional dhe që janë pjesë e formimit karakterizues të programit. Në fillim të çdo lëndë studentët janë informuar me detaje lidhur me këto procedura dhe kërkesat specifike për çdo lëndë apo modul, publikuara gjithashtu në sistemin BIS, në hapësirën e dedikuar të lëndëve përkatëse, ku çdo student ka akses. Vlerësimi është konsideruar një proces kompleks ku të gjitha etapat e mësimit nga dita e pare tek e fundit kanë rendësi dhe janë pjesë e këtij procesi.</p> <p><i>Reference</i></p> <p><i>Takimet në IAL</i></p>
<p><b>Kriteri 4.</b> Testimi e vlerësimi i njohurive, dijeve dhe aftësive profesionale realizohet gjatë gjithë vitit akademik, duke venë në zbatim sisteme elektronike të testimit dhe vlerësimit, të cilat garantojnë anonimat, eliminojnë forma të ndryshme abuzimi dhe rrisin transparencën.</p>	<p>Testimi dhe vlerësimi i njohurive dhe aftësive profesionale në IAL është ndërtuar në mënyrë të drejtë dhe transparente. Lidhur me këtë proces nuk u konstatua ndonjë e metë apo vërejtje nga ana e studentëve.</p> <p>Në “Rregulloren themelore të Kolegjit Universitar “Bedër”, neni 78, paraqiten dhe periudha të përcaktuara kohore për provimet përgjatë përfundimit të semestrit (përfundimi i semestrit, java 16 e semestrit); provimet e ndërmjetme (java e 8 e semestrit).</p> <p>Për programin profesional “Multimedia dhe Dizajn Grafik” studentët testohen me anë të mënyrave të ndryshme në varësi të tipologjisë së lëndës, e cila pasqyrohet dhe në çdo syllabus të këtij programi. Komunikimi dhe ruajtja e vlerësimeve të studentëve sipas lëndëve përkatëse kryhet nëpërmjet sistemit të brendshëm BIS dhe platformës G-Suite. E gjithë kjo procedure e vlerësimit dhe kontrollit të njohurive përshkruhet dhe në rregulloren e institucionit për provimet dhe është pjesë e dosjes se paraqitur për vlerësim e akreditim të programit.</p> <p><i>Reference</i></p> <p><i>Shtojca 1 Formate e kontrollit të njohurive (tabela 15</i></p> <p><i>Evidenca 55 Shembull Syllabusi</i></p> <p><i>Evidenca 3 Rregullorja themelore e kolegjit Universitar “Bedër” neni 78</i></p> <p><i>Evidenca 47 Syllabuset e lëndëve</i></p>
<p><b>Kriteri 5.</b> Vlerësimi i njohurive, dijeve dhe aftësive profesionale realizohet nga</p>	<p>Vlerësimi i njohurive dijeve dhe aftësive profesionale të studentëve, shoqërohen me shpjegimet përkatëse nëpërmjet</p>



<p>komisione provimi, shoqërohet me komente e këshilla mbi procesin e të nxënësve për të ndihmuar studentin të përmirësohet në të ardhmen.</p>	<p>përgjigjeve të sakta. Përfundimet e dhënave shoqërohen me sqarime e komente pas të cilave të gjithë kandidatët mbeten të qartë dhe përfitojnë edhe në orën e fundit nga ndonjë gabim i mundshëm, apo ndonjë informacion jo i saktë. Sqarimet në grup i vlejné të gjithë pjesëmarrësve në provim dhe ka funksionuar normalisht. Procesi i kontrollit të njohurive është i përcaktuar me detaje edhe në rregulloren e zhvillimit të provimeve që është gjithashtu pjesë e kësaj dosjeje.</p>			
<p><b>Kriteri 6.</b> Rezultatet e kontrollit të dijeve dhe aftësive profesionale bazohen në meritë dhe jepen në kohë sipas përcaktimeve në rregulloret përkatëse, duke garantuar njëkohësisht të drejtat e studentëve, për t'u njohur me vlerësimin, kërkesën për rishikim të vlerësimit në përputhje me këto rregullore.</p>	<p>KU "Bedër" harton dhe zbaton rezultatet e kontrollit të dijeve dhe të aftësive profesionale, të cilat bazohen në procedura të rregullta, të cilat shpallen në kalendarin e çdo viti akademik, së bashku me afatet e përfundimit të vlerësimeve të dijeve të përcaktuara. KU "Bedër" disponon sistemin e brendshëm BIS, e cila është mënyra zyrtare e afishimit të rezultateve, për një periudhë një ose dy javë pas datës përfundimtare të provimit.</p> <p>Sipas rregullores së programit profesional në "Multimedia dhe Dizajn Grafik" studenti mund të ankimojë rezultatin përfundimtar brenda një javë nga publikimi i rezultatit, duke paraqitur ankesën në Sekretarinë Mësimore, duke venë në dijeni dhe Përgjegjës të Departamentit së bashku me profesorin përkatës të lëndës. Departamenti në raste të tilla ngreh komisionin përkatës i cili shqyrton rastet në fjalë duke rishikuar gabimet materiale apo detaje të tjera. Te gjitha proces verbalët e provimeve që u kontrolluan u gjetën të rregullta dhe ato ruheshin me përgjegjësi në sekretarinë mësimore. Raste të tilla gjatë vitit akademik ka patur, por vetëm janë bërë sqarime, ndërsa rivlerësime të provimit nuk janë kryer.</p> <p><i>Reference</i></p> <p><i>Evidenca 7 Rregullorja e programeve të studimit të ciklit të parë</i></p> <p><i>Evidenca 5 Rregullorja e "Programit profesional në Multimedia dhe Dizajn Grafik"</i></p>			
<p><b>Shkalla e përmbushjes së standardit</b></p>	<p><b>Nuk përmbushet</b></p>	<p><b>Përmbushet pjesërisht</b></p>	<p><b>Përmbushet kryesisht</b></p>	<p><b>Përmbushet plotësisht</b></p>
				<p><b>X</b></p>

**Standardi III.5**

Zhvillimi i programit të studimit, deri në diplomim, garanton rritjen e aftësive krijuese e zbatuese tek studentët duke dhënë njëkohësisht njohuri të aplikuara dhe kompetenca profesionale lehtësisht të përdorshme në tregun e punës, apo për studime të mëtejshme.

<p><b>Kriteret</b></p>	<p><b>Vlerësimi</b></p>
------------------------	-------------------------



<p><b>Kriteri 1.</b> Programi i studimit zhvillohet në mënyrë të tillë që të garantojë përfundimin e njohurive, zhvillimin e aftësive profesionale dhe të veçanta të studentëve, që janë në përputhje me rezultatet e pritura të të nxënësve për programet me karakter profesional.</p>	<p>Programi Profesional i studimit në KU “Bedër” në Multimedia dhe Dizajn Grafik synon të japë dijet bazë dhe specifike të fushës studentëve. Në tërësi programi kombinon njohuritë teorike dhe ato praktike të fushës, nëpërmjet praktikave profesionale të parashikuara dhe laboratorëve të venë në dispozicion për ta.</p> <p>Përgjatë vizitës në institucion grupi i GVJ pati mundësinë të kuptonte me qartë se Departamenti përkatës për këtë program studimi harton dhe organizon dhe aktivitete ekstra kurrikulare, si konferenca studentore, pjesëmarrje në panaire, vizita në terren etj, ku duket qartë se angazhimi i stafit akademik janë mjaft të përfshirë.</p> <p>Ndërkohë, përgjatë vizitës në KU “Bedër” studentët e këtij programi shprehën opinionin e tyre për të pasur me shumë lëndë praktike apo zhvillimin me tej të disa lëndëve nga një semestër në një vit akademike. Ky koment duhet rishikuar dhe nga stafi drejtues i departamentit për të hartuar apo dhënë me shumë orë mësimore lëndëve me karakter profesional i cili ky program përmban, si: (Dizajni Grafik I; Dizajni Grafik II ; Dizajni Multimedial; Dizajni i Reklamave; Editim Audio; Video; Animacion).</p>
<p><b>Kriteri 2.</b> Programi i studimit garanton njohuritë e përshtatshme dhe zhvillimin e aftësive të veçanta në fushën e teknologjisë së informacionit, humane sociale, komunikimit dhe ndërveprimit, duke mbështetur diskutimet dhe punën në grup në interpretimin dhe zgjidhjen e problematikave apo çështjeve të caktuara.</p>	<p>Programi i studimit me karakter profesional “Multimedia dhe Dizajn Grafik” është ndërtuar me dy vite akademike, ku realizohen 4 semestra, me një total secili me 16 javë. Lëndët janë të ndara në kredite sipas sistemit ECTS dhe me 120 kredite gjithsej. Modulet janë ndarë si më poshtë:</p> <p>Planet mësimore të ndara sipas veprimtarive formuese (A-E)</p> <p>A-LËNDË BAZË, përgatitje metodologjike dhe kulturore e përgjithshme - 18 ECTS</p> <p>B-LËNDË KARAKTERIZUESE, përgatitje për disiplinën shkencore - 66 ECTS</p> <p>C-LËNDË NDËRDISIPLINORE / INTEGRUESE, nën disiplina, profile dhe gruplëndë me zgjedhje - 15 ECTS</p> <p>D-LËNDË PLOTËSUESE, gjuhë e huaj, njohuri informatike, praktika profesionale - 16 ECTS</p> <p>E-DETYRIME PËRMBYLLËSE - 5 ECTS</p> <p>Kjo ndarje e lëndëve është në përputhje me Ligjin Nr. 80/2015 datë 22.07.2015 “Për arsimin e lartë dhe kërkimin shkencor në institucionet e arsimit të lartë në Republikën e Shqipërisë”, Udhëzimin nr. 15 dt. 04.04.2008 “Për Organizimin e Studimeve në Institucionet e Arsimit të Lartë”, si dhe Vendimin e KM nr. 41, datë 24.01.2018 “Për elementët e programeve të studimit të ofruara nga institucionet e arsimit të lartë”. Gjithashtu lëndët dhe modulet janë të organizuara me kredite, sipas Sistemit Evropian të Transferimit dhe</p>



	<p>Grumbullimit të Krediteve, ECTS.</p> <p><i>Reference</i></p> <p><i>RVB, Tab 9</i></p>
<p><b>Kriteri 3.</b> Mësimdhënia realizohet mbi bazë kompetencash që t'u japë studentëve mundësi të zhvillojnë njohuritë e marra në laboratorë dhe praktikat profesionale, duke garantuar realizimin në praktikë të marrëveshjeve me punëdhënësit e aktorët e biznesit në përfitim të formimit praktik të studentëve. Personeli akademik ndërthur format e mësimdhënies me institucionet bashkëpunuese për të mundësuar formimin cilësor dhe për të nxitur mobilitetin e studentëve.</p>	<p>Nga takimi i kryer në KU "Bedër" Mësimdhënia realizohet mbi bazë kompetencash që t'u japë studentëve mundësi të zhvillojnë njohuritë e marra në laboratorë dhe praktikat profesionale, duke garantuar realizimin në praktikë të marrëveshjeve me punëdhënësit e aktorët e biznesit në përfitim të formimit praktik të studentëve.</p> <p>Studentit në këtë program i vihet në dispozicion infrastruktura e nevojshme për të zhvilluar njohuritë e marra në laboratorët kompjuterik; Laboratorin e Multimedias, si dhe nëpërmjet marrëveshjeve të bashkëpunimit me institucione të profilin të këtij programi.</p> <p><i>Reference</i></p> <p><i>Evidenca 33 Marrëveshjet e bashkëpunimit me organizata, institucione dhe aktorët e biznesit vendas dhe të huaj dhe për praktikën profesionale</i></p>
<p><b>Kriteri 4.</b> Në përfundim të çdo moduli apo lënde, personeli akademik vlerëson, analizon e shqyrton kompetencat dhe aftësitë e fituara nga studenti, të paraqitura në programin e studimit dhe syllabuset e çdo lënde, duke nxjerrë në pah çështjet më të rëndësishme dhe orientojnë studentët për implementimin e tyre.</p>	<p>Në përfundim të çdo moduli apo lënde, personeli akademik vlerëson, analizon shërbimet e ofruara nga institucioni nëpërmjet plotësimit të anketës të vlerësimit akademike (Evidenca 52).</p> <p>Pedagoget sigurohen me anë të mjeteve të tij vlerësuese që objektivat e shprehura në syllabuset e lëndëve të arrihen apo plotësohen, nëpërmjet dhe diskutimeve të lira me studentët.</p> <p><i>Reference</i></p> <p><i>Evidenca 52 Anketa Vlerësuese nga Stafit Akademik ndaj institucionit</i></p>
<p><b>Kriteri 5.</b> Institucioni harton procedura të posaçme, të njohura e publike për diplomimin e studentëve dhe garanton mbështetjen dhe udhëzimin e studentëve në procesin e diplomimit. Ai mban regjistra zyrtarë të studentëve të diplomuar dhe i përditëson ata në fund të çdo viti akademik.</p>	<p>Procesi i Diplomimit i paraqitet çdo studenti i cili frekuenton programin profesional në "Multimedia dhe Dizajn Grafik" në KU "Bedër", i cili është pjesë e Rregullores Themelore të institucionit. Informacion me i detajuar shikohet dhe në "Rregulloren e programeve të studimit të ciklit të parë"; si dhe në "Rregulloren e Programit Profesional në Multimedia dhe Dizajn Grafik"</p> <p><i>Reference</i></p> <p><i>Evidenca 7 Rregullorja e programeve të studimit të ciklit të parë</i></p> <p><i>Evidenca 5 Rregullorja e "Programit Profesional në Multimedia dhe Dizajn Grafik"</i></p> <p><i>Evidenca 30 Manuali për përgatitjen e tezës së diplomës dhe</i></p>



	<i>kriteret e vlerësimit të tezës për studentët e ciklit të parë</i>			
<b>Kriteri 6.</b> Njësia përgjegjëse, personeli akademik dhe udhëheqësit akademikë orientojnë dhe ndihmojnë studentët për përgatitjen e punimit të diplomës, realizimin e veprimtarisë praktike dhe përpunimit të rezultateve, duke garantuar bashkëpunimin edhe me aktorë të jashtëm për realizimin e saj.	Udhëheqësit akademik të temave të diplomës së caktuar punojnë në mënyrë të pavarur me studentët në varësi të temës së zgjedhur. Tema e zgjedhur nga studenti rishikohet në zhvillimin praktik të saj.  <i>Reference</i> <i>Evidenca 30 Manuali për përgatitjen e tezës së diplomës dhe kriteret e vlerësimit të tezës për studentët e ciklit të parë</i> <i>Evidenca 61 Vendimi i Këshillit të departamentit për ngarkesën mësimore</i>			
<b>Shkalla e përmbushjes së standardit</b>	<b>Nuk përmbushet</b>	<b>Përmbushet pjesërisht</b>	<b>Përmbushet kryesisht</b>	<b>Përmbushet plotësisht</b>
				X

<b>Shkalla e përmbushjes së standardeve të fushës III</b>	<b>Nuk përmbushet</b>	<b>Përmbushet pjesërisht</b>	<b>Përmbushet kryesisht</b>	<b>Përmbushet plotësisht</b>
				X



#### IV. BURIMET PËR REALIZIMIN E PROGRAMIT TË STUDIMIT DHE MBËSHTETJA E STUDENTËVE

Standardi IV.1	
Institucioni i arsimit të lartë ka përgjegjësinë primare për përzgjedhjen dhe cilësinë e personelit që mbulon programin e studimit dhe mbështetjen për kryerjen e detyrave në mënyrë eficiente dhe efektive nga ana e tyre	
Kriteret	Vlerësimi
<p><b>Kriteri 1.</b> Institucioni harton dhe zbaton procedura dhe kriteret të përgjithshme dhe specifike të shpallura, që garantojnë përzgjedhjen e personelit me nivelin e duhur të kualifikimit dhe në përputhje me natyrën, strukturën, modulet dhe përmbajtjen e programit të studimit, në përputhje me bazën ligjore në fuqi dhe aktet e brendshme rregullatore të tij.</p>	<p>Nga dokumentacioni i përcjellë dhe informacioni i mbledhur gjatë vizitës në institucion, GVJ vëren se KU Bedër harton dhe zbaton procedura që garantojnë përzgjedhjen e personelit me kualifikimin e duhur sipas programit të studimit. Statusi i institucionin përcakton në nenin 61.b përzgjedhjen e personelit akademik. E përcaktuar në detaje, “Rregullorja themelore e KU Bedër” neni 26 përcakton përzgjedhjen dhe emërimin e personelit me kohë të plotë/ të pjesshme, duke u bazuar në një procedurë të konkurrimit të hapur duke garantuar një proces transparent, të paanshëm dhe objektiv. Për personelin akademik me kohë të plotë në KU Bedër :</p> <ol style="list-style-type: none"> <li>1. Përgjegjësi i departamenti përkatës propozon kriteret për vendet e lira të punës që duhet të plotësojnë kandidatët për personel akademik me kohë të plotë dhe paraqet kërkesën për personel të ri akademik me kohë të plotë për aprovim pranë Dekanit të Fakultetit përkatës.</li> <li>2. Dekani i Fakultetit vlerëson kërkesat e paraqitura për rekrutim të stafit të ri akademik me kohë të plotë dhe kërkesa e miratuar i dërgohet Rektorit për vlerësim.</li> <li>3. Pas aprovimit nga ana e Rektorit, i përcillet për ndjekjen e mëtejshme të procedurave për shpalljen e vendeve të lira të punës, Zyrës së Burimeve Njerëzore. Kjo e fundit publikon vendet vakante në web-in e Kolegjit Universitar “Bedër” dhe/ ose pranë Zyrës së Punës.</li> <li>4. Përzgjedhja e kandidatëve, nëpërmjet vlerësimit të dosjeve të aplikimit, bëhet nga një komision i përbërë nga Dekani i fakultetit përkatës, Përgjegjësi i Departamentit përkatës (i cili është dhe relatori i komisionit), si dhe një nga personeli akademik i njësisë bazë (i cili është dhe relatori i komisionit). Përgjegjësi i Burimeve Njerëzore ndjek procedurën e përzgjedhjes së kandidatëve pa të drejtë vote dhe në rast konstatimi të parregullsive në procedurë, përpilon relacionin përkatës drejtuar Rektorit.</li> <li>5. Komisioni analizon përshtatshmërinë e aplikimit me vendin e lirë të punës dhe vendimin e miratuar me shumicë të thjeshtë ia paraqet për miratim Rektorit i cili miraton një prej tyre.</li> </ol>



	<p>Për punësimin e personelit të ri akademik me kohë të pjesshme nga KU Bedër ndiqen hapat e parashikuara në Rregulloren e punësimit dhe vlerësimin të performancës së stafit akademik.</p> <p>Multimedia dhe desing grafik kanë marrë zhvillim të madh edhe në Shqipëri, ndonëse ky është ndër zhvillimet e reja të këtij 10-vjeçari. Tendencat e reja të zhvillimit, KU Bedër përpiqet ti përcjellë tek studentët edhe nëpërmjet formateve të seminareve me tematika të caktuara. Kjo vihet re edhe në Raportet Vjetore të Departamentit të Shkencave të Komunikimit. Janë një numër seminaresh MarCom dhe “Studenti dhe profesioni” të cilat i shërbejnë pikërisht njohjes me tendencat e reja.</p> <p><u>Referenca</u></p> <p><i>Evidenca 2- Statuti i Kolegjit Universitar “Bedër”</i></p> <p><i>Evidenca 3- Rregullorja themelore e Kolegjit Universitar “Bedër”</i></p> <p><i>Evidenca 24- Lista e të dhënave të dosjes së stafit</i></p> <p><i>Evidenca 37- Procedura e punësimit të personelit</i></p> <p><i>Evidenca 57- Udhëzimi “Për ngarkesën mësimore”</i></p> <p><i>Evidenca 61- Vendim i këshillit të departamentit për ngarkesën mësimore</i></p>
<p><b>Kriteri 2.</b> Institucioni mbledh, ruan dhe përditëson çdo vit akademik të dhënat e personelit të angazhuar në programin e studimit. Këto të dhëna përfshijnë anëtarët e personelit akademik të përfshirë në program, personin përgjegjës për organizimin e programit të studimit, angazhimin e çdo anëtari në çdo semestër dhe vit akademik, përfshirë tutorët apo vëzhguesit e praktikës në institucionet partnere, si dhe atë të personelit ndihmës mësimor-shkencor dhe administrativ të angazhuar.</p>	<p>GVJ nga informacioni i mbledhur gjatë vizitës konkludon se KU Bedër mban pranë zyrës së Burimeve Njerëzore, dosjet e plota për të gjithë stafin akademik të programeve të studimit. Sipas një përzgjedhje rastësore, gjatë vizitës në institucion GVJ u njoh me dosjet e personelit akademik PAE dhe PAK. I gjithë informacioni përmbledhet dhe ruhet në Zyrën e Burimeve Njerëzore, me dosje individuale për të gjithë stafin. Dosja përmban elementët e domosdoshëm si: (i) Informacionin mbi nivelin e kualifikimeve dhe arsimin; (ii) Informacionin mbi kualifikimet dhe publikimet /botime; (iii) Informacionin shëndetësor; (iv) Dokumentet e identitetit; (v) kontratat e punës. Dosjet janë të plota dhe ruajnë informacionin e domosdoshëm dhe plotësues për personelin akademik.</p> <p><u>Referenca</u></p> <p><i>Evidenca 3- Rregullorja themelore e Kolegjit Universitar “Bedër”</i></p> <p><i>Evidenca 24- Lista e të dhënave të dosjes së stafit</i></p>
<p><b>Kriteri 3.</b> Institucioni dëshmon një angazhim optimal të burimeve njerëzore për përmbushjen e objektivave të programeve të studimit me karakter profesional dhe për krijimin e mjedisit dhe mundësive të përshtatshme dhe të barabarta për kryerjen e detyrave të personelit në mënyrë profesionale.</p>	<p>Bazuar në dokumentacionin dhe informacionin e siguruar gjatë vizitave në institucion, GVJ konstaton se është ndërmarrë angazhimi i duhur dhe është krijuar një mjedis dhe infrastrukturë e përshtatshme për realizimin e detyrave në mënyrë profesionale nga personeli i institucionit.</p> <p>Në përdorim të personelit mësimor janë vënë në dispozicion zyra me hapësira të mjaftueshme dhe të pajisura me infrastrukturën e nevojshme (kondicionim, ndriçim dhe poste pune dhe ambiente të përbashkëta të pajisura me internet dhe Ëi-Fi për ambientet jashtë zyre).</p>



	<p>Personeli akademik efektiv mbulon ngarkesën më të madhe në programin e studimit. Vetëm për njëzën nga lëndët, “Teknikat e shkrimit në komunikimin e integruar (copyright) jepej si titullar lënde nga staf PAK, të gjitha lëndët e tjera kishin si titullar staf PAE.</p> <p><i>Referenca</i>  Evidenca 57- Udhëzimi “Për ngarkesën mësimore”  Evidenca 61- Evidenca 61- Vendim i këshillit të departamentit për ngarkesën mësimore  Evidenca – RVB tabela 16 –mjediset</p>			
<p><b>Kriteri 4.</b> Institucioni angazhohet për kualifikimin e vazhdueshëm dhe zhvillimin e mëtejshëm profesional të personelit që mbulon dhe administron programin e studimit, përmes organizimit të programeve specifike për metodat inovative të mësimdhënies e përdorimit të teknologjive të reja, si dhe mbështetjen për kualifikimin e mëtejshëm profesional të personelit akademik e të personelit mësimor-shkencor.</p>	<p>KU Bedër është i angazhuar në zhvillimin profesional të burimeve të tij njerëzore, sidomos akademike.</p> <p>GVJ, gjatë vizitës në institucion, dhe dokumentet e përcjellë u njoh me platformat që përdor institucioni për të komunikuar në distancë me studentët. Për përdorimin sa më komod të këtyre platformave janë zhvilluar trajnime nga zyra e TI. GVJ u njoh nga Zyra e Burimeve Njerëzore me trajnimet e zhvilluara (i) mbi metodologjinë didaktike; dhe (ii) mbi metodologjinë e kërkimit shkencor.</p> <p>Personeli akademik është përfshirë në trajnime edhe nga akademi dhe institucione të tjera të huaja në kuadër të marrëveshjeve të bashkëpunimit.</p> <p>KU Bedër kujdeset që si stafi akademik ashtu edhe ai mbështetës të jetë tërësisht i angazhuar në realizimin e programit të studimit.</p> <p><i>Referenca</i>  Evidenca 16- Dokument i pjesëmarrjes në Bologna Hub Peer Support  Evidenca 17- Guida e Personelit  Evidenca 26- Lista e trajnimeve të stafit</p>			
<b>Shkalla e përbushjes së standardit</b>	<b>Nuk përbushet</b>	<b>Përbushet pjesërisht</b>	<b>Përbushet kryesisht</b>	<b>Përbushet plotësisht</b>
				X

<p><b>Standardi IV.2</b>  <b>Institucioni i arsimit të lartë vë në dispozicion mjedise mësimore dhe infrastrukturën e përshtatshme për realizimin e procesit mësimdhënës të programeve të studimit dhe për formimin praktik, të përshtatshëm sipas natyrës dhe fushës së programit të studimit me karakter profesional</b></p>	
<b>Kriteret</b>	<b>Vlerësimi</b>
<p><b>Kriteri 1.</b> Institucioni siguron mjediset e mjaftueshme dhe të përshtatshme mësimore për zhvillimin e veprimtarisë mësimdhënëse teorike, në varësi të numrit të studentëve, grupeve mësimore, në përputhje me natyrën specifike të programit të studimit dhe</p>	<p>Nga vëzhgimi i mjediseve të mësimimit në KU Bedër u vërejt se ato janë mjaft mirë të pajisura edhe nga pikëpamja teknologjike për të plotësuar kushtet e studentëve të komunikimit. Ku Bedër ka neësroom, muzeun e medias dhe komunikimit, laboratorin e gjuhëve të huaja dhe kompjuterëve, etj. KU Bedër e filloi vitin akademik 2020-2021 në godina të reja, të sapo ri konstruktura, me laboratore të dedikuara programeve të studimit.</p>



<p>moduleve përkatëse.</p>	<p>Fakulteti përgjegjës për programin e profesional ka një sipërfaqe 2732.5 m<sup>2</sup> dhe që llogaritet me një normë rreth 4.53 m<sup>2</sup> për student. Fakulteti ka 5 salla të mëdha leksionesh dhe 9 salla seminaresh. Gjithashtu ka 2 salla interneti, laborator profesional, laborator për lëndët praktike, salla aktiviteteesh promovuese, etj.</p> <p>Nga vizita e GVJ në mjediset e reja të institucionit u vu re se ambientet mësimore ishin të pajisura me të gjithë mjetet e domosdoshme për zhvillimin e një orë interaktive mësimore. Ambientet ishin me hapësira të mjaftueshme, ndriçim dhe komode për studentët.</p> <p><u>Referenca</u> Evidenca – RVB tabela 16 –mjediset</p>
<p><b>Kriteri 2.</b> Mjediset mësimore, si: klasat, laboratorët, studiot e mjediset e tjera janë të pajisura me pajisje elektronike dhe të teknologjisë së informacionit, që garantojnë realizimin e procesit mësimor teorik e praktik, përmes përdorimit të metodologjive e teknologjive bashkëkohore të mësimdhënies-mësimnxënies.</p>	<p>Nga vëzhgimi i mjedisëve në KU Bedër gjatë vizitës, GVJ vëren se edhe nga ana teknologjike, pajisjet kompjutera, tabelë projektimi, tabela interaktive dhe internet të pandërprerë, ishin të përshtatshme me nevojat për zhvillimin e orëve të mësimi dhe për interaktivitetin.</p> <p>Në ambientet e mësimi dhe kudo brenda institucionit kishte internet dhe mjediset ishin të gjitha të pajisura me kondicionim dhe ndriçim të plotë edhe natyral edhe artificial.</p>
<p><b>Kriteri 3.</b> Laboratorët, studiot, atelietë apo mjediset e tjera, sipas fushës specifike të programit profesional, përmbajnë aparaturat dhe mjetet e nevojshme e të përshtatshme për plotësimin e kërkesave të moduleve, aftësimi teorik e praktik dhe të objektivave formues të programit të studimit në tërësi.</p>	<p>Personeli akademik dhe studentët programet kompjuterike dhe softëare në kuadër të plotësimi të kërkesave të procesit mësimor. Gjithashtu çdo individ (pedagog, student) është i pajisur me llogarinë e tij të postës elektronike @beder.edu.al me memorie të pakufizuar të Google Drive dhe sharing, Google Classroom, etj. Ky email u mundëson studentëve të aksesojnë llogarinë e tyre personale në Sistemin Interaktiv Bedër (BIS) të sistemit të brendshëm nga ku mund të ndjekin notat e tyre</p>
<p><b>Kriteri 4.</b> Institucioni siguron së paku një laborator të teknologjisë së informacionit, të pajisur me programe profesionale sipas natyrës së programit/eve të studimit që ofron.</p>	<p>G-SUITE me shërbimet e saj është platforma online, e përdorur për më tepër për realizimin e procesit mësimor dhe komunikimin me studentët gjatë periudhës së pandemisë COVID-19. Gjithashtu, përmes G-Suite çdo pedagog ndan materialet e leksioneve, studentët dorëzojnë projektin e tyre ose detyrat e ndryshme dhe aktivitete të tjera të ngjashme, të nevojshme për lëndën specifike.</p> <p><u>Referenca</u> Evidenca – RVB tabela 16 –mjediset Vizita në institucion</p>
<p><b>Kriteri 5.</b> Institucioni garanton, me kapacitetet që zotëron dhe/ ose në bashkëpunim me institucione dhe subjekte të tjera, që mjediset janë të mjaftueshme, të përshtatshme dhe të posaçme për zhvillimin e praktikave profesionale, internship-it dhe</p>	<p>Zhvillim i praktikave profesionale është konsideruar nga KU Bedër mjaft i rëndësishëm dhe për këtë ai ka lidhur edhe marrëveshje bashkëpunimi me institucione, mediatike për zhvillimin e praktikave.</p> <p>Një ndihmesë e mirë për praktikat është edhe site mediatik <a href="http://www.objektiv.al">www.objektiv.al</a> si edhe zyra e marrëdhënieve me publikun e vetë KU Bedër .</p>



veprimtarive të tjera praktike thelbësore për programet me karakter profesional.	<i>Referenca</i> <i>Evidenca – RVB tabela 16 –mjediset</i> <i>Vizita në institucion</i> <i>Evidenca 23- Lista e praktikave profesionale të studentëve</i>			
<b>Shkalla e përmbushjes së standardit</b>	<b>Nuk përmbushet</b>	<b>Përmbushet pjesërisht</b>	<b>Përmbushet kryesisht</b>	<b>Përmbushet plotësisht</b>
				X

<b>Standardi IV.3</b>	
<b>Institucioni i arsimit të lartë vë në dispozicion të studentëve mjedise mbështetëse e të posaçme të mësimnxënies, bibliotekën e literaturën dhe mbështetjen financiare të nevojshme për mbarëvajtjen e programit të studimit dhe realizimin cilësor të tij</b>	
<b>Kriteret</b>	<b>Vlerësimi</b>
<b>Kriteri 1.</b> Institucioni vë në dispozicion të studentëve bibliotekën mësimore, duke garantuar mundësinë e shfrytëzimit në mënyrë të barabartë nga studentët e programit të studimit dhe krijon kushte për akses të barabartë e pa pagesë dhe të jetë e pajisur me programe kompjuterike dhe pajisje të tjera teknike që mundësojnë shfrytëzimin pa kufizime nga ana e të gjithë studentëve.	Bazuar në dokumentacionin e përcjellë nga GVB dhe informacionit të siguruar gjatë vizitave, GVJ konstaton se institucioni ka një bibliotekë të pasur dhe mjaft funksionale për studentët e tij. Ajo është e lokalizuar në katin e parë të institucionit me një sallë me sipërfaqe rreth 119 m2. Biblioteka e KU Bedër, e cila është në dispozicion të studentëve çdo ditë të javës nga e hëna në të shtunë, ofron një gamë të gjerë titujsh, në total rreth 26 000 libra dhe revista.  <i>Referencë</i> <i>Evidenca 14- Buxheti i Departamentit të Shkencave të Komunikimit.pdf</i> <i>Evidenca 31- Marrëveshja për akses në JSTOR.pdf</i> <i>Evidenca 42- Raporti vjetor i Departamentit të Shkencave të Komunikimit, viti akademik 2019-2020</i> <i>Evidenca 43- Raporti vjetor i Departamentit të Shkencave të Komunikimit, viti akademik 2020-2021</i>
<b>Kriteri 2.</b> Biblioteka duhet të jetë e pajisur me literaturë mësimore bazë, ndihmëse, e mjaftueshme në gjuhën shqipe dhe të huaja, të mjaftueshme dhe të përshtatshme për mbulimin e të gjitha moduleve e veprimtarive mësimore sipas natyrës e specifikës së programit të studimit.	Bazuar në dokumentacionin e përcjellë nga GVB dhe informacionit të siguruar gjatë vizitave, GVJ konstaton se institucioni ka mjedise të mjaftueshme dhe bibliotekë të përshtatshme mësimore për programin profesional “Multimedia dhe design grafik”. Biblioteka zotëron titujt kryesorë të përfshirë në literaturën e domosdoshme të lëndëve mësimore. Këta tituj janë të përzgjedhur dhe klasifikuar në përputhshmëri me programet e studimit të ofruara nga KU Bedër duke mbuluar nevojat e parashikuara sipas këtyre programeve të studimit
<b>Kriteri 3.</b> Institucioni duhet të krijojë kushte për akses të barabartë e pa pagesë për studentët në bibliotekat online të fushës së programit të studimit dhe duhet të hartojë e zbatojë një plan të detajuar për shtimin e zërave të bibliotekës, përditësimin e fondit ekzistues në mbështetje të programit.	Në pasurimin e bibliotekës së KU Bedër ka ndihmuar edhe dhurimi i 318 librave nga Ambasada Amerikane në Tiranë, tetor 2018, nga të cilët më shumë se 70% e tyre ishin botime specifike për Departamentin e Shkencave të Komunikimit.  KU Bedër ka marrëveshje dhe ka akses të plotë, si për studentët ashtu edhe për stafin në <b>JSTOR</b> , një nga platformat më të mëdha akademike në botë. Studentët mund ta aksesojnë atë thjeshtë duke



	<p>qenë të lidhur me internetin e KU Bedër . Aksesi në fondin e bibliotekës është i njëjtë për të gjithë.</p> <p>Biblioteka e KU Bedër është e pajisur me programe kompjuterike dhe kompjutera për t'u mundësuar studentëve realizimin e detyrave dhe mundësi për akses online në varësi të nevojave të tyre. Po ashtu, databaza e Bibliotekës së KUB gjendet online, duke i ndihmuar studentët në gjetjen e literaturës.</p> <p>Gjatë vizitës së GVJ në institucion u vërejt klasifikimi i titujve sipas metodikës së librarisë së Kongresit Amerikan.</p> <p><i>Referencë</i>  <i>Evidenca 14- Buxheti i Departamentit të Shkencave të Komunikimit</i>  <i>Evidenca 31- Marrëveshja për akses në JSTOR</i></p>
<p><b>Kriteri 4.</b> Institucioni, përmes bashkëpunimit me aktorë të jashtëm, të angazhuar në realizimin e programit mësimor, duhet t'u lehtësojnë dhe garantojë studentëve mbështetjen dhe përdorimin e burimeve e logjistikës së nevojshme të institucioneve partnere, në varësi të natyrës së angazhimit të tyre në procesin formues teorik, praktik dhe profesional të studentëve.</p>	<p>KU Bedër është e angazhuar në realizimin e programit mësimor dhe për këtë lehtëson mundësinë e përdorimit të gjithë infrastrukturës për studentët. Nëpërmjet marrëveshjeve me institucione të ndryshme mundësohet kryerja e formimit praktik të studentëve.</p> <p>Edhe gjatë javëve që nuk janë pjesë e procesit mësimor, midis dy viteve akademike, studentët këshillohen të marrin eksperiencë dhe të shfrytëzojnë kontaktet me kompani private për të marrë eksperiencë.</p> <p><i>Referencë</i>  <i>Evidenca 21- Lista e aktiviteteve dhe vizitave studimore të studentëve</i>  <i>Evidenca 22- Lista e kompanive që janë vizituar nga studentët</i>  <i>Evidenca 23- Lista e praktikave profesionale të studentëve</i>  <i>Evidenca 42- Raporti vjetor i Departamentit të Shkencave të Komunikimit, viti akademik 2019-2020</i>  <i>Evidenca 43- Raporti vjetor i Departamentit të Shkencave të Komunikimit, viti akademik 2020-2021</i></p>
<p><b>Kriteri 5.</b> Institucioni parashikon koston financiare të programit të studimit profesional, mbështetjen financiare të nevojshme për mbarëvajtjen e programit të studimit për të paktën një cikël të plotë studimi dhe raportin financiar të përvitshëm dhe në mbyllje të çdo cikli të plotë studimi.</p>	<p>Bazuar në dokumentacionin e përcjellë nga institucioni dhe informacionit të siguruar gjatë vizitave, GVJ vëren se çdo vit institucioni ka hartuar planin e financimit në nivel institucional. Ky planifikim bëhet duke përfshirë të gjitha të ardhurat dhe financimet e ndryshme, si dhe shpenzimet e kostove të studimit, jo sipas programeve të studimit. Planifikimi dhe raportimi nuk mund të bëhet sipas programeve të studimit pasi personeli akademik në shumicën e rasteve angazhohet në disa programe të ndryshme studimi, po kështu edhe infrastruktura është e përbashkët për të dy fakultetet.</p>
<p><b>Kriteri 6.</b> Financimi i një programi studimi profesional duhet të sigurojë e të garantojë mbulimin e të gjitha burimeve dhe veprimtarive të qëndrueshme dhe operative, të lidhura e që janë në funksion të realizimit të</p>	<p>Sipas "Buxheti i Departamentit të Shkencave të Komunikimit" secili departament ka të përcaktuar disa prej zërave të shpenzimeve të cilët lidhen me aktivitetin mësimor dhe kërkimin shkencor dhe kryesisht promovimin e veprimtarive lidhur</p>



<p>programit të studimit, duke garantuar njëkohësisht qëndrueshmërinë financiare përgjatë kohës së zhvillimit të programit të studimit e në vijim.</p>	<p>meprogramet e zhvilluara në departament.</p> <p>Tabela e të ardhurave dhe shpenzimeve në anekset e RVB (Tab nr. 18) jep edhe bilancin e të ardhurave në tre vitet e fundit akademike. Burimet kryesore të të ardhurave janë: (i) Tarifat e shkollimit; (ii) Donacionet, aktivitetet siguruese, fondacioni; (iii) konsulenca dhe shërbimet.</p> <p>KU Bedër është institucion i arsimit të lartë jofitimprurës. Fondacioni që mbështet Ku Bedër harton një raport financiar nga një Kontabilist i Miratuar, sipas standardeve të miratuar të kontabilitetit. Ky raport ruhet pranë Fondacionit që mbështet KU Bedër . Raporti është vjetor dhe përmban pasqyra të hollësishme të të ardhurave dhe shpenzimeve.</p> <p>Programi i studimit Master Profesional në “Komunikim Marketingu” nuk e ka mbyllur diplomimin e studentëve të tij dhe ky është viti i parë i përfundimit të ciklit të këtij programi.</p> <p>GVJ vëren se mbështetja e donatorëve, krahas edhe tarifave të studimit, kanë garantuar qëndrueshmërinë financiare të programit të studimit.</p> <p><i>Referencë</i>  Evidenca 14- Buxheti i Departamentit të Shkencave të Komunikimit  Evidenca 42- Raporti vjetor i Departamentit të Shkencave të Komunikimit, viti akademik 2019-2020  Evidenca 43- Raporti vjetor i Departamentit të Shkencave të Komunikimit, viti akademik 2020-2021</p>			
<p><b>Shkalla e përmbushjes së standardit</b></p>	<p><b>Nuk përmbushet</b></p>	<p><b>Përmbushet pjesërisht</b></p>	<p><b>Përmbushet kryesisht</b></p>	<p><b>Përmbushet plotësisht</b></p>
				<p><b>X</b></p>

<p><b>Standardi IV.4</b>  <b>Institucioni i arsimit të lartë harton, ndjek, zbaton politika e procedura institucionale dhe i jep formacion të plotë e të hollësishëm studentëve mbi programin e studimit me karakter profesional, pranimin, përzgjedhjen, përparimin akademik, vlerësimin e dijeve dhe diplomimin në programin e studimit</b></p>	
<p><b>Kriteret</b></p>	<p><b>Vlerësimi</b></p>
<p><b>Kriteri 1.</b> Institucioni harton, zbaton dhe bën publike politika, procedura e kriteret të qarta e të kuptueshme për pranimit e studentëve, përparimin e tyre përgjatë kursit të studimit, të vlerësimit të dijeve dhe të diplomimit, të cilat garantojnë barazinë dhe të drejta të njëjta për të gjithë kandidatët për studentë dhe studentët, në përputhje me legjislacionin në fuqi dhe</p>	<p>Mbështetur në dokumentacionin e përcjellë nga GVB dhe informacionit të siguruar gjatë vizitave në KU “Bedër”, GVJ konstaton se institucioni ka hartuar dhe zbaton politika dhe procedura që duhet të ndjekë për programin e studimit me karakter profesional “Multimedia dhe Dizajn Grafik” të cilat janë në përputhje me aktet ligjore në fuqi dhe të përcaktuara në Statut e rregulloret e institucionit, si të njësisë bazë ashtu edhe të njësisë kryesore. Në përputhje dhe aktet rregullatore të tij ka ngritur strukturën specifike e institucionit, Dekanin e Studentëve e cila ka të përfshirë Zyrën e Planifikimit të Karrierës, Zyrën e</p>



<p>aktet e veta rregullatore.</p>	<p>Koordinatorit të Klubeve Studentore; Zyrën e të Diplomuarve dhe Zyrën e Shërbimit psiko-social dhe shëndetësor.</p> <p>Dekani i studentëve dhe sidomos Zyra e Planifikimit të Karrierës e ndjekin ecurinë e studentit hap pas hapi gjatë gjithë kohë së qëndrimit në institucion, duke bërë transparente të gjitha procedurat. Kjo zyrë organizon, menaxhon dhe drejton procesin e rekrutimit të studentëve të rinj, mban marrëdhënie të vazhdueshme me këshillat studentorë, drejton procesin e këshillimit të studentëve, mban komunikim me tregun e punës, si dhe ofron asistencë në orientimin dhe zhvillimin e karrierave profesionale të studentëve.</p> <p><i>Referencë</i>  Evidenca 5- Rregullorja e "Programit Profesional në Multimedia dhe Dizajn Grafik"  Evidenca 18- Guida e Studentit  Evidenca 35- Praktika e ndjekur për miratim të kritereve të pranimit të studentëve  Evidenca 62- Vendimi i këshillit të departamentit për caktimin e këshilltarëve akademik</p>
<p><b>Kriteri 2.</b> Institucioni harton dhe publikon përpara çdo viti akademik kritere të përgjithshme dhe/ ose të veçanta për pranimin dhe përzgjedhjen e kandidatëve në programet e studimit me karakter profesional dhe udhëzon publikun dhe të interesuarit në lidhje me to.</p>	<p>Kriteret dhe procedura e aplikimit janë publikuar përpara fillimit të vitit akademik në faqen zyrtare të institucionit, në fushatat informuese mediatike të zhvilluara në shkolla të mesme të ndryshme jo vetëm të Tiranës, broshurat informuese, si dhe gjatë procesit të informimit dhe këshillimit në zyrat përkatëse në Institucion. Siç GVJ u informua edhe gjatë takimit në institucion (dhe sipas udhëzimit nga MAS), programet profesionale nuk kanë kufizim në notën mesatare për pranim në program studimi.</p> <p>Gjithashtu KU Bedër jep edhe promovime dhe politika mbështetëse për studentët me aftësi të veçanta, me talente duke ofruar edhe tarifa zbritëse, deri në 100% financim të studimit.</p> <p><i>Referencë</i>  Evidenca 5- Rregullorja e "Programit Profesional në Multimedia dhe Dizajn Grafik"  Evidenca 13- Rregullorja mbi zbritjet e tarifave të studimeve  Evidenca 35- Praktika e ndjekur për miratim të kritereve të pranimit të studentëve</p>
<p><b>Kriteri 3.</b> Institucioni vë në dispozicion informacion të plotë dhe të hollësishëm në lidhje me kriteret e procedurat e përparimit akademik të studentëve, zhvillimin e veprimtarive praktike e profesionale të programit dhe institucionet bashkëpunuese në këto veprimtari, vlerësimit të dijeve e aftësive të studentëve dhe diplomimit.</p>	<p>Mbështetur në dokumentacionin e përcjellë nga GVB dhe informacionit të siguruar gjatë vizitave në KU "Bedër", GVJ konstaton se institucioni vë në dispozicion informacion të plotë dhe të hollësishëm në lidhje me kriteret e procedurat e përparimit akademik të studentëve, strukturën, organizmin e programit të studimit.</p> <p>"Ditët e orientimit" janë mjaft të rëndësishme për studentët që kanë kontaktin e parë me KU Bedër. Gjatë kësaj jave të parë studentët njohin stafin administrativ, mësuesor, sekretarinë, bibliotekën dhe të gjitha facilitetet e infrastrukturës. Nga</p>
<p><b>Kriteri 4.</b> Studentët informohen në</p>	<p>bibliotekën dhe të gjitha facilitetet e infrastrukturës. Nga</p>



<p>mënyrë të hollësishme për strukturën, organizimin, kohëzgjatjen e programit të studimeve, mundësitë e punësimit, si dhe mbështetjen institucionale për orientimin drejt dhe në tregun e punës.</p>	<p>pikëpamja kurrikulare, studentët njihen me të gjithë stafin pedagogjik me lëndët dhe përmbajtja e tyre, kohëzgjatjen dhe organizimin e programit, sistemin BIS dhe kuadrin rregullator që menaxhon këtë program studimi.</p> <p>Zyra e dekanit të studentëve është mjaft e përfshirë në këto orientim. Gjithashtu mjaft ndihmuese dhe orientim për studentët është edhe Këshilltari Akademik, me një rol orientues për studentët gjatë gjithë kohëzgjatjes së tyre në studimin akademik dhe për të mbështetur ecurinë e tyre akademike.</p> <p>Zyra e Sekretarisë mësimore është gjithashtu një pikë e rëndësishme kontakti për të gjithë studentët. Ajo bën njoftimet si nëpërmjet sistemit të publikimit ashtu edhe në postën elektronike të çdo studenti.</p> <p>Sistemi BIS që përdor KU Bedër është mjaft utilitar për të gjithë studentët. Po kështu universiteti publikun edhe “Guidën e studentit”</p> <p><i>Referencë</i>  Evidenca 5- Rregullorja e “Programit Profesional në Multimedia dhe Dizajn Grafik”  Evidenca 18- Guida e Studentit.  <a href="https://com.beder.edu.al/sh/content/default/programi-2-vjear-ne-multimedia-dhe-dizajn-grafik-19/354/661">https://com.beder.edu.al/sh/content/default/programi-2-vjear-ne-multimedia-dhe-dizajn-grafik-19/354/661</a>  Evidenca 60- Udhëzues i sistemit informativ (BIS)</p>			
<p><b>Kriteri 5.</b> Institucioni vë në dispozicion të studentëve informacion dhe udhëzues të posaçëm për modulet, lëndët, përmbajtjen, veprimtaritë formuese dhe informacion të gjerë e të përditësuar mbi zhvillimin dhe organizimin e procesit mësimor, logjistikën, infrastrukturën dhe shërbimet në funksion të realizimit të tij.</p>	<p>Zyra e dekanit të studentëve është mjaft e përfshirë në këto orientim. Gjithashtu mjaft ndihmuese dhe orientim për studentët është edhe Këshilltari Akademik, me një rol orientues për studentët gjatë gjithë kohëzgjatjes së tyre në studimin akademik dhe për të mbështetur ecurinë e tyre akademike.</p> <p>Zyra e Sekretarisë mësimore është gjithashtu një pikë e rëndësishme kontakti për të gjithë studentët. Ajo bën njoftimet si nëpërmjet sistemit të publikimit ashtu edhe në postën elektronike të çdo studenti.</p> <p>Sistemi BIS që përdor KU Bedër është mjaft utilitar për të gjithë studentët. Po kështu universiteti publikun edhe “Guidën e studentit”</p> <p><i>Referencë</i>  Evidenca 5- Rregullorja e “Programit Profesional në Multimedia dhe Dizajn Grafik”  Evidenca 18- Guida e Studentit.  <a href="https://com.beder.edu.al/sh/content/default/programi-2-vjear-ne-multimedia-dhe-dizajn-grafik-19/354/661">https://com.beder.edu.al/sh/content/default/programi-2-vjear-ne-multimedia-dhe-dizajn-grafik-19/354/661</a>  Evidenca 60- Udhëzues i sistemit informativ (BIS)</p>			
<p><b>Kriteri 6.</b> Informacioni në lidhje me programin e studimit mundësohet përmes sistemit të menaxhimit të brendshëm të informacionit dhe duhet të jetë lehtësisht i arritshëm nga studentët edhe në distancë.</p>	<p>Në momentin e regjistrimit në KU Bedër dhe institucionalizimit të marrëdhënieve dhe detyrimeve kontraktuale reciproke midis institucionit dhe studentit, të gjithë ata marrin nga zyra TI një adrese institucionale email me kredencialet e tyre.</p> <p>Sistemi “Bedër Information System”, BIS, është i lidhur me Gmail dhe me domain e @beder.edu.al. Me këtë sistem studentët mund të lidhen edhe nga distanca dhe i jep të gjithë informacionin studentëve. Ai shërben për të marrë të gjitha komunikimit dhe për të ndjekur ecurinë e procesit të tyre akademik.</p> <p><i>Referencë</i>  Evidenca 18- Guida e Studentit.  <a href="https://com.beder.edu.al/sh/content/default/programi-2-vjear-ne-multimedia-dhe-dizajn-grafik-19/354/661">https://com.beder.edu.al/sh/content/default/programi-2-vjear-ne-multimedia-dhe-dizajn-grafik-19/354/661</a>  Evidenca 60- Udhëzues i sistemit informativ (BIS)</p>			
<p><b>Shkalla e përmbushjes së standardit</b></p>	<p><b>Nuk përmbushet</b></p>	<p><b>Përmbushet pjesërisht</b></p>	<p><b>Përmbushet kryesisht</b></p>	<p><b>Përmbushet plotësisht</b></p>
				<p>X</p>

**Standardi IV.5**

**Institucioni i arsimit të lartë disponon një sistem të brendshëm të menaxhimit institucional dhe e vë atë në dispozicion të administrimit, informimit dhe monitorimit të aktivitetit akademik, financiar e**



administrativ për programin e studimit me karakter profesional	
Kriteret	Vlerësimi
<p><b>Kriteri 1.</b> Institucioni disponon sistem të menaxhimit nëpërmjet të cilit administrojnë të gjithë informacionin që lidhet me studentët dhe aktivitetin e tyre nga regjistrimi deri në diplomimin e daljen në tregun e punës.</p>	<p>Mbështetur në dokumentacionin e përcjellë nga GVB dhe informacionit e siguruar gjatë vizitave në KU Bedër, GVJ vëren se institucioni ka në përdorim sistemin e menaxhimit për të gjithë informacionin që lidhet me ecurinë e studentëve në programin profesional të studimit “Multimedia dhe design grafik”, nga regjistrimi deri në diplomimin e tyre.</p> <p>Sistemi “Bedër Information System”, BIS, ka informacionin për të gjithë studentët dhe bën ndërthurjen e regjistrimit të tyre me statusin aktual të detyrimeve financiare si edhe të transkriptove të notave. Sistemi mundëson edhe sekretarinë mësimore edhe vizualisht duke e klasifikuar me ngjyra (e kuqe, e verdhe, jeshile) se në cilën fazë të procesit dhe detyrimeve është studenti. Procedimi për studentët e rinj bëhet fillimisht nga sekretaria me regjistrim e tyre.</p> <p>Studentët evidentuan përdorimin e sistemit për procesin mësimor.</p> <p><i>Referencë</i>  <i>Evidenca 18- Guida e Studentit.</i>  <a href="https://com.beder.edu.al/sh/content/default/programi-2-vjear-ne-multimedia-dhe-dizajn-grafik-19/354/661">https://com.beder.edu.al/sh/content/default/programi-2-vjear-ne-multimedia-dhe-dizajn-grafik-19/354/661</a>  <i>Evidenca 60- Udhëzues i sistemit informativ (BIS)</i></p>
<p><b>Kriteri 2.</b> Sistemi i brendshëm i menaxhimit administrojnë informacionin, dokumentacionin dhe aktivitetin e personelit akademik, personelit ndihmës akademik, personelit administrativ dhe të partnerëve të angazhuar në realizimin e programit.</p>	<p>Mbështetur në dokumentacionin e përcjellë nga GVB dhe informacionit e siguruar gjatë vizitave në KU Bedër, GVJ vëren se institucioni ka në përdorim sistemin “Bedër Information System”, BIS nëpërmjet së cilës mundësohet administrimi i informacionit sipas hierarkisë dhe roleve të autorizuara të përshtatur për përdorimin si aplikime desktop dhe mobile, për stafin administrativ, akademik dhe ndihmësakademik. Sistemi ka akses të dedikuar për secilin nga stafi akademik dhe studentët (nëpërmjet passëord individual të krijuar që me regjistrimin e studentit) dhe ka të regjistruar dhe të përditësuar informacionin e nevojshëm për lëndët e programit të studimit, për çdo semestër, kreditet, ecurinë e lëndëve, si dhe pedagogët përgjegjës për lëndët.</p>
<p><b>Kriteri 3.</b> Sistemi i menaxhimit siguron akses të dedikuar në informacione e dokumente për të gjithë personelin dhe studentët e programit të studimit.</p>	<p>Sistemi BIS ka llogari të veçantë edhe për secilën nga zyrat administrative në KU Bedër, administrative, biblioteka, burimet njerëzore, dekani i studentëve, financa, sekretaria mësimore.</p> <p><i>Referencë</i>  <a href="https://com.beder.edu.al/sh/content/default/programi-2-vjear-ne-multimedia-dhe-dizajn-grafik-19/354/661">https://com.beder.edu.al/sh/content/default/programi-2-vjear-ne-multimedia-dhe-dizajn-grafik-19/354/661</a>  <i>Evidenca 60- Udhëzues i sistemit informativ (BIS)</i>  <i>Evidenca 17 – Guida e personelit</i></p>
<p><b>Kriteri 4.</b> Sistemi i menaxhimit ka të integruar platforma dhe module që mundësojnë forma të komunikimit interaktiv dhe shkëmbimit të informacionit ndërmjet personelit dhe studentëve.</p>	<p>KU Bedër përdor edhe sistemet e komunikimit online Google classroom për zhvillimin e forumeve të diskutimit online të studentëve me pedagogun në funksion të zhvillimit të procesit të</p>
<p><b>Kriteri 5.</b> Sistemi i menaxhimit garanton monitorim në kohë reale të aktivitetit akademik e administrativ</p>	<p>KU Bedër përdor edhe sistemet e komunikimit online Google classroom për zhvillimin e forumeve të diskutimit online të studentëve me pedagogun në funksion të zhvillimit të procesit të</p>



<p>dhe mundëson raportime individuale dhe të dhëna në kohë reale për organet drejtuese dhe titullarët.</p>	<p>mesimdhënie dhe mësimnxënies. Kjo përvojë u pa shumë e vlefshme edhe gjatë pandemisë Covid-19.</p> <p>KU Bedër përdor edhe G-Suite për të menaxhuar dhe administruar, aksesuar materialet dhe informacionet përmes sistemit në “Cloud”. Edhe detyrimet financiare për studentët shfaqen në sistem. Në momentin që studenti kryen pagesën dhe e paraqet atë në sekretari, atij i hapet në sistem automatikisht mundësia për të bërë zgjedhjen e lëndëve për semestrin e caktuar.</p> <p>KU Bedër përdor edhe sistemin one.beder.edu.al e cila mundëson raportime për drejtuesit e institucionit rreth ecurisë së procesit mësimor.</p> <p><i>Referencë</i>  <a href="https://com.beder.edu.al/sh/content/default/programi-2-vjejar-ne-multimedia-dhe-dizajn-grafik-19/354/661">https://com.beder.edu.al/sh/content/default/programi-2-vjejar-ne-multimedia-dhe-dizajn-grafik-19/354/661</a>  Evidenca 60- Udhëzues i sistemit informativ (BIS)  Evidenca 16 – Guida e studentit  Evidenca 17 – Guida e personelit</p>			
<p><b>Kriteri 6.</b> Informacionet që lidhen me programet e studimit, personelin akademik dhe aktivitetet e ndryshme publikohen në faqen e internetit në të paktën dy gjuhë ku të paktën njëra prej tyre është gjuha shqipe.</p>	<p>Mbështetur në dokumentacionin e përcjellë nga GVB dhe informacionit e siguruar gjatë vizitave në KU Bedër, GVJ vëren se institucioni ka në funksion platformën e faqes zyrtare ëeb, një faqe dinamike në të cilën publikohet informacion mbi programet e studimit, strukturën organizative të institucionit, fakulteteve, personelin akademik si dhe aktivitete të ndryshme në lidhje me jetën akademike, studentore, bashkëpunimet etj. Informacioni i publikuar përditësohet vazhdimisht.</p> <p>KU Bedër ka edhe seksionin në gjuhën angleze i cili përmban informacionet kryesore sikurse edhe në shqip.</p> <p><i>Referencë</i>  <a href="https://com.beder.edu.al/sh/content/default/programi-2-vjejar-ne-multimedia-dhe-dizajn-grafik-19/354/661">https://com.beder.edu.al/sh/content/default/programi-2-vjejar-ne-multimedia-dhe-dizajn-grafik-19/354/661</a>  Evidenca 60- Udhëzues i sistemit informativ (BIS)  Evidenca 16 – Guida e studentit  Evidenca 17 – Guida e personelit</p>			
<p><b>Shkalla e përmbushjes së standardit</b></p>	<p><b>Nuk përmbushet</b></p>	<p><b>Përmbushet pjesërisht</b></p>	<p><b>Përmbushet kryesisht</b></p>	<p><b>Përmbushet plotësisht</b></p>
				<b>X</b>

<p><b>Shkalla e përmbushjes së standardeve të fushës IV</b></p>	<p><b>Nuk përmbushet</b></p>	<p><b>Përmbushet pjesërisht</b></p>	<p><b>Përmbushet kryesisht</b></p>	<p><b>Përmbushet plotësisht</b></p>
				<b>X</b>



## V. STUDENTËT DHE MBËSHTETJA E TYRE

Standardi V.1	
Institucioni i arsimit të lartë harton, ndjek dhe zbaton politika dhe procedura për pranimin, përzgjedhjen, përparimin e studentëve, transferimin, njohjen, vlerësimin e dijeve dhe diplomimin, në programin e studimit dhe i vë në dispozicion të studentëve të programit të studimit	
Kriteret	Vlerësimi
<p><b>Kriteri 1.</b> Institucioni harton dhe zbaton politika, procedura dhe kritere të pranimit, përparimit, të transferimit, njohjes së studimeve të mëparshme ose të pjesshme, të vlerësimit të dijeve dhe të diplomimit të studentëve, në përputhje me legjislacionin në fuqi dhe aktet e veta rregullatore dhe që janë lehtësisht të kuptueshme dhe të aksesueshme nga publiku.</p>	<p>Mbështetur në dokumentacionin e përcjellë nga GVB dhe informacionit të siguruar gjatë vizitave në KU “Bedër”, GVJ vëren se institucioni ka hartuar dhe zbaton politika dhe procedura që duhet të ndjekë për programin e studimit me karakter profesional “Multimedia dhe Dizajn Grafik” të cilat janë në përputhje me aktet ligjore në fuqi dhe të përcaktuara në Statut e rregulloret e institucionit, si të njësisë bazë ashtu edhe të njësisë kryesore. KU “Bedër” i kushton kujdes të gjitha etapave që nga regjistrimi i studentëve dhe pajisja e tyre me numër matrikullimi, krijimi i dosjes së plotë të studentit dhe deri në dalje. Në mënyrë rastësore, GVJ kërkoi dosje studentësh të vitit të parë dhe të vitit të dytë dhe u vërejt se ato ishin në përputhje me kërkesat ligjore.</p> <p>Në Rregulloren e “Programit Profesional në Multimedia dhe Dizajn Grafik” janë të përcaktuara kushtet e pranimit në këtë program studimi. E gjithë tërësia e rregullores përcakton Njohjen e krediteve (neni 12), Transferimi (neni 9), regjistrimi i një lënde, lënia e lëndës (neni 18), kriteret e kalimit në vitin pasardhës (neni 21), etj.</p> <p>Gjithashtu, KU Bedër ka përcaktuar edhe një grup dokumentacioni dhe procedurash për të gjithë ecurinë e studenteve gjatë programit të studimit. Kështu është përcaktuar (i) Vendimi i këshillit të departamentit për përcaktimin e përfaqësuesit të karrierës; (ii) Vendimi i këshillit të departamentit për caktimin e këshilltarëve akademike; (iii) Guida e Studentit; (iv) Procedura e Praktikës Profesionale, etj.</p> <p><i>Referencë:</i>  Evidenca 5- Rregullorja e “Programit Profesional në Multimedia dhe Dizajn Grafik”  Evidenca 7- Rregullorja e programeve të studimit të ciklit të parë  Evidenca 10- Rregullorja e transferimeve  Evidenca 13- Rregullorja mbi zbritjet e tarifave të studimeve  Evidenca 18- Guida e Studentit  Evidenca 35- Praktika e ndjekur për miratim të kritereve të pranimit të studentëve</p>
<p><b>Kriteri 2.</b> Politikat dhe procedurat nga hyrja në dalje dhe orientimin drejt tregut të punës, garantojnë barazinë dhe të drejta të njëjta për të gjithë kandidatët për studentë dhe studentët e programit të studimit.</p>	<p>Politikat e hartuara nga KU “Bedër”, përgjatë ciklit të studimit janë të qarta ashtu sikurse përshkruhet edhe në Rregulloren e “Programit Profesional në Multimedia dhe Dizajn Grafik”. Ky dokument garanton barazinë dhe gjithëpërfshirjen për studentët.</p> <p>Gjithashtu KU “Bedër” ka një rregullore të veçantë ku ndihmon grupe të caktuara për t’u përfshirë në këtë program studimi,</p>



	<p>nëpërmjet zbritjes së tarifave. Kjo krijon një mundësi më shumë gjithëpërfshirje studentore.</p> <p><i>Referencë:</i>  Evidenca 5- Rregullorja e "Programit Profesional në Multimedia dhe Dizajn Grafik"  Evidenca 13- Rregullorja mbi zbritjet e tarifave të studimeve</p>
<p><b>Kriteri 3.</b> Institucioni harton dhe publikon përpara çdo viti akademik kriteret të veçanta për përzgjedhjen e kandidatëve dhe, përpara fillimit të çdo viti akademik, udhëzon publikun dhe të interesuarit në lidhje me kërkesat e kriteret e përgjithshme e të veçanta të programit të studimit.</p>	<p>KU "Bedër" dërgon në Ministrinë e Arsimit procedurat e plota të pranimit të studentëve në çdo vit akademik. Këto procedura publikohen edhe në faqen e internetit të KU "Bedër". Në periudhën mars – maj, KU "Bedër" merr pjesë në panairët e karrierës dhe studimit dhe kontakton me drejtoritë arsimore dhe shkollat e mesme në shumë nga qytetet e vendit për të bërë publike programet e studimit, duke njohur maturantët me çfarë programesh studimi ofrohen.</p> <p><a href="https://www.beder.edu.al/sh/neës/other/lista-e-kandidateve-fitues-raundi-i-dyte-2021-2022-/1675">https://www.beder.edu.al/sh/neës/other/lista-e-kandidateve-fitues-raundi-i-dyte-2021-2022-/1675</a></p> <p><i>Referencë:</i>  Evidenca 18- Guida e Studentit  Evidenca 35- Praktika e ndjekur për miratim të kriterëve të pranimit të studentëve</p>
<p><b>Kriteri 4.</b> Institucioni vë në dispozicion informacion të plotë dhe të hollësishëm në lidhje me kriteret e procedurat e përparimit akademik të studentëve, kalimit nga një vit akademik në tjetrin, procedurat e njohjeve të kualifikimeve të mëparshme ose studimeve të pjesshme.</p>	<p>KU "Bedër" publikon informacionet në faqen eeb informacionet e nevojshme për studentët. Ecuria e studentëve dhe kalimi i tyre nga një vit akademik në tjetrin është e mundur të gjendet në sekretarinë mësimorë. Gjithashtu edhe sipas sistemit online të vetë institucionit, studentët marrin në kohë raportimet për ecurinë e tyre. Ato janë të aksesueshëm me login dhe fjalë-kalim individual të secilit student.</p> <p>Në rregulloren e "Programit Profesional në Multimedia dhe Dizajn Grafik" janë të përcaktuara kriteret e vlerësimit të studentëve.</p>
<p><b>Kriteri 5.</b> Institucioni informon studentët në lidhje me kriteret e procedurat e vlerësimit të dijeve e aftësive të studentëve në programin e studimit dhe diplomimit në programin e studimit.</p>	<p>Po ashtu secili nga syllabuset e lëndëve jep të përcaktuar qartë mënyrat e vlerësimit të studentëve.</p> <p><i>Referencë:</i>  Evidenca 5- Rregullorja e "Programit Profesional në Multimedia dhe Dizajn Grafik"  Evidenca 10- Rregullorja e transferimeve  Evidenca 13- Rregullorja mbi zbritjet e tarifave të studimeve</p>
<p><b>Kriteri 6.</b> Përpara fillimit të çdo viti akademik dhe në mënyrë periodike, institucioni publikon udhëzues të posaçëm dhe organizon takime të hapura për informimin e të interesuarve e studentëve të ardhshëm mbi programin e studimit.</p>	<p>Përpara fillimit të vitit akademik KU "Bedër" prezanton për publikun informacione, fletëpalosje, broshura, udhëzues të posaçëm për programet e studimit dhe mënyrat e pranimit në to. Gjithashtu, thuajse i gjithë stafi akademik i brendshëm merr pjesë në takime të hapura për informimin e studentëve të ardhshëm mbi programet e studimit.</p> <p>Guida e studentit është një dokument i rëndësishëm që shërben shumë për të njohur tërësinë e programeve.</p> <p><i>Referencë:</i>  Evidenca 18- Guida e Studentit</p>



	<i>Evidenca 35- Praktika e ndjekur për miratim të kriterëve të pranimit të studentëve</i>			
Shkalla e përmbushjes së standardit	Nuk përmbushet	Përmbushet pjesërisht	Përmbushet kryesisht	Përmbushet plotësisht
				X

### Standardi V.2

**Institucioni i arsimit të lartë vë në dispozicion të studentëve informacion të plotë e të hollësishëm për objektivat formuese, strukturën, organizimin, përmbajtjen e programit të studimit, rezultatet e pritshme të të nxënit dhe mundësitë e punësimit**

Kriteret	Vlerësimi
<p><b>Kriteri 1.</b> Institucioni informon në mënyrë të hollësishme studentët për strukturën, organizimin dhe kohëzgjatjen e programit të studimeve dhe ve në dispozicion të tyre, informacion dhe dokumentacion/ udhëzues të posaçëm për modulet, lëndët, përmbajtjen dhe veprimtaritë formuese të programit të studimit me karakter profesional.</p>	<p>Mbështetur në dokumentacionin e përcjellë nga GVB dhe informacionit të siguruar gjatë vizitave në KU “Bedër”, GVJ vëren se Programi Profesional “Multimedia dhe Dizajn Grafik” ka vënë në dispozicion të studentëve informacionin e nevojshëm për modulet, lëndët, përmbajtjen dhe veprimtaritë formuese të programit të studimit me karakter profesional. Java e parë është java e orientimit për studentët që organizohet nga fakulteti dhe me pjesëmarrjen e stafit akademik që mbulon programin specifik. Gjatë kësaj jave prezantohen syllabuset e lëndës, nga çdo pedagog. Syllabuset e lëndëve janë të vendosura edhe në sistemin online të brendshëm dhe Microsoft Teams për KU “Bedër”.</p> <p><a href="https://com.beder.edu.al/sh/content/default/programi-2-vjecar-ne-multimedia-dhe-dizajn-grafik-19/354/661">https://com.beder.edu.al/sh/content/default/programi-2-vjecar-ne-multimedia-dhe-dizajn-grafik-19/354/661</a></p> <p><i>Referencë:</i>  <i>Evidenca 18- Guida e Studentit</i>  <i>Evidenca 40- Programi i ditëve të orientimit</i>  <i>Evidenca 47- Syllabuset e lëndëve</i>  <i>Evidenca 42- Raporti vjetor i Departamentit të Shkencave të Komunikimit, viti akademik 2019-2020</i>  <i>Evidenca 43- Raporti vjetor i Departamentit të Shkencave të Komunikimit, viti akademik 2020-2021</i></p>
<p><b>Kriteri 2.</b> Institucioni informon studentët mbi praktikat profesionale në kuadër të realizimit të programit të studimit, partnerët dhe institucionet bashkëpunuese ku parashikohen të realizohen, si dhe mundësitë e punësimit e mbështetjen institucionale për orientimin drejt e në tregun e punës.</p>	<p>Praktika profesionale është pjesë e kurikulës në programin profesional të studimit “Multimedia dhe Dizajn Grafik”, në vitin e dytë. Gjatë kohës së zhvillimit të këtij akreditimi si edhe nga vizita në KU “Bedër” e takimet atje, GVJ u njoh me informacionin që po jepej për praktikat me studentët e vitit të dytë. Ndërkohë, që edhe gjatë vitit të parë, studentët kanë pasur mundësi të zhvillojnë intership të shkurtër në kompani marketing apo media për t’u njohur me karakteristikat e veçanta të tregut të punës.</p> <p>Një rol shumë të rëndësishëm këtu ka Zyra e Planifikimit të Karrierës dhe Këshilltarët e Karrierës. “Vendimi i këshillit të departamentit për përcaktimin e përfaqësuesit të karrierës” institucionalizon këtë rol të rëndësishëm, që krahas elementëve të tjerë ndihmon studentin edhe në njohjen me mundësitë që kanë për tregun e punës. Zyra organizon aktivitete të rëndësishme për</p>



	<p>teknikat e shkrimit të CV dhe përgatitjeve për intervistat e punës etj.</p> <p><i>Referencë:</i>  Evidenca 9- Vendimi i këshillit të departamentit për përcaktimin e përfaqësuesit të karrierës.  Dokument 42- Raporti vjetor i Departamentit të Shkencave të Komunikimit, viti akademik 2019-2020  Evidenca 43- Raporti vjetor i Departamentit të Shkencave të Komunikimit, viti akademik 2020-2021</p>								
<p><b>Kriteri 3.</b> Studentëve u vihet në dispozicion informacion i gjerë dhe i përditësuar mbi zhvillimin dhe organizimin e procesit mësimor, logjistikën, infrastrukturën dhe shërbimet në funksion të realizimit të tij.</p>	<p>GVJ vëren se institucioni informon studentët nëpërmjet burimeve të ndryshme mbi organizimin dhe zhvillimin e procesit mësimor, logjistikën dhe infrastrukturën mbështetëse, si dhe shërbimet e ofruara nga institucioni në funksion të realizimit të programi i studimit. Ky proces nis që javën e parë, nëpërmjet orientimit të studentëve me kalendarin akademik, ambientet dhe shërbimet në funksion të programit të studimit.</p> <p><i>Referencë:</i>  Evidenca 18- Guida e Studentit  Evidenca 40- Programi i ditëve të orientimit  Evidenca 47- Syllabuset e lëndëve</p>								
<p><b>Kriteri 4.</b> Informacioni në lidhje me programin e studimit mundësohet përmes sistemit të menaxhimit të brendshëm të informacionit dhe duhet të jetë lehtësisht i arritshëm nga studentët edhe në distancë.</p>	<p>Mbështetur në informacionin e dhënë nga institucioni dhe nga vizitat në KU "Bedër", GVJ konstaton se institucioni ka në përdorim sistemin/ programin të brendshëm i cili menaxhon informacioni personal për ecurinë e detyrimeve financiare të kontratave të studentëve, progresin e tyre akademik nga regjistrimi deri në diplomimin e tyre. Në të njëjtën kohë nga ana e institucionit për menaxhimin e anës akademike të studentëve është në funksion sistemi i menaxhimit të njohurive BIS (Bedër Information System). Ky sistem menaxhon informacionin e studentit edhe nga distanca, jo thjesht me praninë në institucion. Sistemi ishte shumë i vlefshëm sidomos gjatë viteve të pandemisë Covid -19. Sistemi BIS është i lidhur edhe me Gmail dhe me domain e institucionit.</p> <p><i>Referencë:</i>  Evidenca 18- Guida e Studentit  Info nga faqja web <a href="https://com.beder.edu.al/sh/content/default/programi-2-vjeer-ne-multimedia-dhe-dizajn-grafik-19/354/661">https:// com. beder. edu. al /sh/content/default/programi-2-vjeer-ne-multimedia-dhe-dizajn-grafik-19/354/661</a>  5 prill 2022 – Informacion vëzhgim gjatë vizitës në institucion</p>								
<p><b>Shkalla e përbushjes së standardit</b></p>	<table border="1"> <thead> <tr> <th data-bbox="662 1713 869 1792">Nuk përbushet</th> <th data-bbox="869 1713 1045 1792">Përbushet pjesërisht</th> <th data-bbox="1045 1713 1268 1792">Përbushet kryesisht</th> <th data-bbox="1268 1713 1434 1792">Përbushet plotësisht</th> </tr> </thead> <tbody> <tr> <td></td> <td></td> <td></td> <td>X</td> </tr> </tbody> </table>	Nuk përbushet	Përbushet pjesërisht	Përbushet kryesisht	Përbushet plotësisht				X
Nuk përbushet	Përbushet pjesërisht	Përbushet kryesisht	Përbushet plotësisht						
			X						

**Standardi V.3**

**Institucioni i arsimit të lartë mbledh, administron, përditëson dhe ruan të dhëna të hollësishme në lidhje me numrin e profilit të studentëve që ndjekin programin e studimit me karakter profesional,**



**nga pranimi në diplomim, si dhe të dhëna të punësimit të tyre përmes një sistemi menaxhimi informatik të brendshëm**

Kriteret	Vlerësimi									
<p><b>Kriteri 1.</b> Institucioni disponon dhe mban statistika vjetore për numrin e studentëve e të diplomuarve në vitet paraardhëse në programin e studimit.</p>	<p>Rregjistri themeltar i studentëve ka të gjithë informacionin për studentin, që nga momenti i fillimit të studimit, marrja e numrit të matrikullimit, provimet e kaluara, diplomimin dhe largimet nga programi nëse kjo ndodh. Të dhënat janë si më poshtë:</p>									
<p><b>Kriteri 2.</b> Institucioni disponon dhe ruan statistika vjetore për numrin e studentëve të regjistruar, tërheqjet nga programi, si dhe largimet para përfundimit të programit apo mospërfundimin me sukses të vitit akademik në të cilin zhvillohet programi i studimeve.</p>	<table border="1" data-bbox="699 495 1410 748"> <thead> <tr> <th>Viti akademik</th> <th>Numri i studentëve regjistruar</th> <th>Numri i studentëve të ç' regjistruar</th> </tr> </thead> <tbody> <tr> <td>2020-2021</td> <td>12</td> <td>1</td> </tr> <tr> <td>2021-2022</td> <td>14</td> <td>3</td> </tr> </tbody> </table>	Viti akademik	Numri i studentëve regjistruar	Numri i studentëve të ç' regjistruar	2020-2021	12	1	2021-2022	14	3
Viti akademik	Numri i studentëve regjistruar	Numri i studentëve të ç' regjistruar								
2020-2021	12	1								
2021-2022	14	3								
<p><b>Kriteri 3.</b> Institucioni disponon të dhëna për ecurinë e studentëve gjatë zhvillimit të programit të studimeve që nga pranimi deri në diplomimin e tyre, përfshirë punësimin eventual të tyre.</p>	<p>Gjatë vizitës së GVJ në institucion u bënë me zgjedhje verifikimet e disa studenteve dhe ecuria e tyre në regjistrat e programit të institucionit. Në programin profesional të studimit në Multimedia dhe Dizajn Grafik ka pasur edhe çregjistrime të studentëve në vitin e parë.</p> <p>Në këtë program studimi të gjithë të regjistruarit vijnë nga Shqipëria dhe nuk ka të reregjistruar nga vende të tjera.</p> <p>Përveç regjistrat themeltar dhe të notave, informacioni për studentët gjendej edhe në sistemin BIS të KU Bedër dhe në procesverbalet e notave, të ruajtura fizikisht pranë sekretarisë mësimore.</p> <p>Zyra e sekretarisë mësimore është përgjegjëse për hedhjen administrimin dhe ruajtjen e të gjithë informacionit për studentët në sistemin e brendshëm elektronik të komunikimit.</p> <p><i>Referencë:</i>  <i>Evidenca - Rregullorja mbi Organizimin Administrativ.</i>  <i>Evidenca 5- Rregullorja e "Programit Profesional në Multimedia dhe Dizajn Grafik"</i>  <i>Evidenca - Rregullorja e sekretarisë mësimore</i>  <i>Evidenca 19- Gjurmimi i të Diplomuarve</i></p>									
<p><b>Kriteri 4.</b> Të dhënat statistikore të studentëve menaxhohen përmes sistemit të brendshëm të informacionit dhe duhet të jenë të sigurta dhe lehtësisht të verifikueshme nga personat e autorizuar.</p>	<p>GVJ vëren se KU "Bedër" ka në përdorim sistemin/ programin të brendshëm i cili menaxhon informacioni personal për ecurinë e detyrimeve financiare të kontratave të studentëve, progresin e tyre akademik nga regjistrimi deri në diplomimin e tyre. Në të njëjtën kohë nga ana e institucionit për menaxhimin e anës akademike të studentëve është në funksion sistemi i menaxhimit të njohurive BIS (Bedër Information System). Ky sistem menaxhon informacionin e studentit për të gjitha të dhënat e tij si të ecuria akademike dhe detyrimet kontraktore. Ky sistem mund të aksesohet edhe nga distanca, jo thjesht me prani në institucion. Sistemi BIS është i lidhur edhe me Gmail dhe me domain e institucionit.</p> <p>Sekretaria mësimore dhe Departamenti i Shkencave të Komunikimit mbajnë komunikim të rregullt për ecurinë e</p>									



	<p>studentëve në programet mësimore. Bazuar mbi informacionin e përmbledhur nga sekretaria mësimore dhe nga zyra të tjera si ajo e Dekanit të studentëve apo Zyra e Planifikimit të Karrierës, Departamenti harton një raport vjetor që jep informacion të plotë për të gjithë studentët, sipas programeve të studimit që janë në këtë departament. Të dhënat statistikore përmbledhin edhe informacione për notën mesatare si edhe kufijtë në të cilët ajo luhatet.</p> <p><i>Referencë:</i> Evidenca 60 – Udhezues i sistemin informativ BIS</p>								
<p><b>Kriteri 5.</b> Institucioni duhet të hartojë raporte analitike periodike mbi profilin dhe cilësinë në hyrje dhe dalje të studentëve, si dhe të shkallës së cilësisë së punësimit të tyre, duke e shoqëruar me masat e duhura në drejtim të përmirësimit të këtyre treguesve.</p>	<p>Departamenti i Shkencave të Komunikimit si njësi bazë harton çdo vit raportet vjetore mbi ecurinë/ veprimtarinë e njësisë dhe drejtimet e progresit dhe masat që duhen marrë. Zyra e planifikimit të karrierës, ka një përfaqësues edhe nga Dept. Shkencave të Komunikimit dhe ai shërben si urë lidhëse edhe për të ndihmuar në tregun e punës dhe për të aktivitetet në këtë drejtim. Çdo departament ka të ndërtuar edhe Bordin e Këshillimit të Karrierës me 7 anëtarë profesionistë dhe aktivë në profesionin e tyre. Në drejtim të punësimit të studentëve ndihmojnë edhe leksionet e hapura “Studenti dhe profesioni” me përfaqësues nga biznesi. (Të përshkruara në Raportet Vjetore të departamentit).</p> <p><i>Referencë:</i> Evidenca 42- Raporti vjetor i Departamentit të Shkencave të Komunikimit, viti akademik 2019-2020 Evidenca 43- Raporti vjetor i Departamentit të Shkencave të Komunikimit, viti akademik 2020-2021</p>								
<p><b>Shkalla e përmbushjes së standardit</b></p>	<table border="1"> <thead> <tr> <th>Nuk përmbushet</th> <th>Përmbushet pjesërisht</th> <th>Përmbushet kryesisht</th> <th>Përmbushet plotësisht</th> </tr> </thead> <tbody> <tr> <td></td> <td></td> <td></td> <td>X</td> </tr> </tbody> </table>	Nuk përmbushet	Përmbushet pjesërisht	Përmbushet kryesisht	Përmbushet plotësisht				X
Nuk përmbushet	Përmbushet pjesërisht	Përmbushet kryesisht	Përmbushet plotësisht						
			X						

<b>Standardi V.4</b>	
<b>Institucioni i arsimit të lartë përfshin dhe angazhon studentët në organet vendimmarrëse e këshilluese, në kuadër të hartimit, miratimit, rishikimit e përmirësimit të programit të studimit, metodave të mësimdhënies dhe cilësisë së burimeve e shërbimeve ndaj tyre</b>	
<b>Kriteret</b>	<b>Vlerësimi</b>
<p><b>Kriteri 1.</b> Institucioni parashikon përfshirjen dhe angazhimin e studentëve dhe/ ose përfaqësuesve të tyre në organet vendimmarrëse e këshilluese sipas akteve ligjore dhe atyre rregullatore të vetë IAL-ve.</p>	<p>GVJ, mbështetur në dokumentacionin e përcjellë vëren se institucioni ka parashikuar përfshirjen dhe angazhimin e studentëve/ përfaqësuesve të tyre në organet vendimmarrëse e këshilluese.</p> <p>Përfshirja e studentëve në organet vendimmarrëse në KU Bedër është e sanksionuar në statutin e KU “Bedër”. Në nenin 10, pika 1.e. të tij theksohet përbërja e Senatit Akademik me 11anëtarë që përfshijnë:</p> <p>a) <i>Rektori i Kolegjit Universitar “Bedër”;</i> b) <i>Zv. Rektori;</i></p>
<p><b>Kriteri 2.</b> Institucioni duhet të garantojë se përfshirja e studentëve dhe/ose e përfaqësuesve të tyre në vendimmarrje, këshillim apo</p>	



<p>vlerësimin mbi procesin akademik të jetë reale, konkrete, frutdhënëse dhe me rezultate lehtësisht të verifikueshme e të matshme.</p>	<p>c) <i>Dekanët e fakulteteve të Kolegjit Universitar “Bedër”;</i>  d) <i>Përfaqësuesit e fakulteteve, nga 3 (tre) për çdo fakultet që zgjidhen drejtpërdrejtë nga asambltetë e personelit akademik me kohë të plotë të njëjësive kryesore;</i>  e) <i>Përfaqësuesi i studentëve.</i></p> <p>Gjithashtu pjesëmarrja e studentëve është e garantuar edhe në Njësinë e Sigurimit të Brendshëm të Cilësisë. Neni 28 i Statutit sanksionon pjesëmarrjen e studentëve ...“<i>Njësia e Sigurimit të Brendshëm të Cilësisë përbëhet nga 5 (pesë) anëtarë, nga të cilët 1(një) kryetar, 2 (dy) janë përfaqësues të personelit akademik të njëjësive kryesore një për çdo fakultet, 1 (një) përfaqësues i Këshillit Studentor dhe 1 (një) ekspert i jashtëm. Anëtarët e njëjësive miratohen nga Senati Akademik me propozim të rektorit.</i></p> <p>Studentët janë të organizuar edhe në Këshillat studentorë, Neni 99 të Statutit të KU “Bedër”.</p> <p>Mendimi i studentëve merrej në mënyrë anonime nëpërmjet pyetësorëve online. Rezultatet e pyetësorëve për pedagogët u jepen atyre dhe shërbejnë si një pikë orientuese. Anketimet e studenteve bëhen çdo semestër. Gjithashtu studentët janë pjesëmarrës në mbledhjet e departamentit, për tematika të caktuara. Siç u theksua nga Përgjegjësi i Departamentit në takimin me GVJ, në mbledhjet e departamentit, çdo dy javë, ka studentë të pranishëm nga programet në varësi edhe të tematikave që trajtohen.</p> <p>Një nga studentët e programit profesional të studimit ka qenë pjesë e hartimit të Raportit të Vlerësimit të Brendshëm për këtë program studimi. Në takimin e GVJ me grupin e studentëve në program e studimit profesional 2-vjeçar, ata u shprehën për mundësitë që u ofron departamenti në diskutime dhe kontakte shumë të afërta me ta. Gjithashtu KU “Bedër” ka edhe zyrën e Dekanit të Studentëve e cila e cila bashkëpunon me njësitë administrative dhe akademike për zgjidhjen e çështjeve të studentëve.</p> <p><i>Referencë:</i>  Evidenca 2- <i>Statuti i Kolegjit Universitar “Bedër”</i>  Evidenca 1 5- <i>Rregullorja e “Programit Profesional në Multimedia dhe Dizajn Grafik”</i>  Evidenca 9- <i>Vendimi i këshillit të departamentit për përcaktimin e përfaqësuesit të karrierës</i>  Evidenca 43- <i>Raporti vjetor i Departamentit të Shkencave të Komunikimit, viti akademik 2020-2021</i></p>
<p><b>Kriteri 3.</b> Në hartimin dhe përmirësimin e programeve të studimit, institucioni duhet të mbajë parasysh ngarkesën akademike të studentëve në programin e studimit dhe parashikimin e procedurave</p>	<p>GVJ, nga informacionet e përcjella, konstaton se Ku “Bedër” ka hartuar planin mësimor të përgatitur për programin e studimit me karakter profesional “Multimedia dhe Dizajn Grafik” në zbatim të VKM Nr.41, datë 24.01.2018 duke mbajtur në fokus ngarkesën akademike të studentëve në këtë program studimi sipas përcaktimeve. Analiza e planit mësimor të këtij programi studimi</p>



<p>joburokratike të përparimit të studentëve përgjatë programit, përfshirë njohjen e studimeve të plota apo të pjesshme të mëparshme.</p>	<p>tabela 9 dhe Tabela 10 në anekset e Raportit të Vlerësimit të Brendshëm flet për shpërndarje të drejtë të lëndëve në semestra.</p>
<p><b>Kriteri 4.</b> Institucioni garanton përfshirjen e studentëve në procesin e hartimit, rishikimit dhe përmirësimit të programeve të studimit mbi baza të rregullta dhe të reflektojë sugjerimet e kontributin e tyre në to.</p>	<p>Programet mësimore si edhe tërësia e lëndëve dhe syllabuseve përditësohen dhe përshtaten me nevojat e zhvillimit të programeve mësimore, duke u bazuar në legjislacionin aktual. Në ndërtimin dhe shpërndarjen e ngarkesës mësimore, programi është shpërndarë në ngarkesë të njëtrajtshme midis katër semestrave.</p> <p>Departamenti sigurohet që ngarkesa akademike e studentëve të jetë kriter, kur bëhen rishikime të programeve të studimit, në mënyrë që ngarkesa të mos bjerë mbi studentët.</p> <p>Institucioni organizon fokus grupe, pyetësorëve online dhe mbledhje të hapura në departament për të marrë <i>feedback</i> dhe për të shikuar mundësitë e përmirësimit të programit të studimit.</p> <p>Studentët janë pjesëmarrës edhe në këshillin e departamentit që organizohen gjatë semestrit.</p> <p><i>Referencë:</i>  <i>Evidenca 5- Rregullorja e "Programit Profesional në Multimedia dhe Dizajn Grafik"</i>  <i>Evidenca – Tabelat përmbledhëse në RVB nr. 9 dhe nr. 10</i>  <i>Evidenca 43- Raporti vjetor i Departamentit të Shkencave të Komunikimit, viti akademik 2020-2021</i></p>
<p><b>Kriteri 5.</b> Studentëve u mundësohet të japin mendim mbi barazinë dhe ndershmërinë e kryerjes së procesit të vlerësimit e kontrollit të dijeve, përfshirë mundësinë e ankimimit të rezultatit, rishikimit dhe reflektimit nga ana e institucionit/ njësisë/ pedagogut përgjegjës.</p>	<p>GVJ vëren se KU "Bedër" mundëson studentëve:</p> <p>1. Vënie në dispozicion dhe informimin mbi kriteret dhe procesin e vlerësimit të dijeve në programin e studimit me karakter profesional "Multimedia dhe Dizajn Grafik". Kjo realizohet që në javën e informimit dhe gjatë javës së parë të mësimit për çdo lëndë; (Specifikisht kjo është detajuar edhe në syllabuset e secilës lëndë. Provimet janë të sekretuara dhe pas nxjerrjes së rezultateve, studentët kanë mundësinë të marrin sqarime nga pedagogët lidhur me procesin e vlerësimit.)</p> <p>2. Studentëve u mundësohet nëpërmjet procedurave të rregulluara e drejta e barazisë dhe transparencës në vlerësimin dhe kontrollin e dijeve, si dhe mundësisë së ankimimit të rezultatit, kërkesës për rishikim të tij. (KU "Bedër" ka hartuar edhe një procedurë për animimin e notës e cila lehtëson mundësinë për të rikontrolluar dhe vlerësuar njohuritë në rast se studentët kanë çështje lidhur me vlerësimin në provime. Anketimet e studentëve plotësohen përpara hyrjes në sezonin e provimeve. Plotësimi i anketimeve bëhet online ne sistemin BIS dhe është individual dhe anonim.)</p> <p>Gjatë vizitës në institucion të GVJ dhe takimit me studentët, ata pohuan që janë të informuar me procedura dhe rregullat që mund të ndjekin nëse dëshirojnë të ankimojnë një vlerësim.</p> <p><i>Referencë:</i>  <i>Evidenca 5- Rregullorja e "Programit Profesional në Multimedia</i></p>



	<p><i>dhe Dizajn Grafik”</i>  <i>Evidenca 36- Praktikë ankimim note</i>  <i>Evidenca – Tabelat përmbledhëse në RVB nr. 9 dhe nr. 10</i>  <i>Evidenca 43- Raporti vjetor i Departamentit të Shkencave të Komunikimit, viti akademik 2020-2021</i>  <i>5 prill 2022 – takim me studentët e programit profesional “Multimedia dhe Dizajn Grafik”</i></p>			
<b>Shkalla e përmbushjes së standardit</b>	<b>Niveli i përmbushjes</b>	<b>Përmbushet pjesërisht</b>	<b>Përmbushet kryesisht</b>	<b>Përmbushet plotësisht</b>
				X

<b>Standardi V.5</b>	
<b>Institucioni ka procedura e njësi të posaçme për pritjen, orientimin, këshillimin e studentëve, menaxhimin e ankimeve e problematikave, të cilat operojnë në mënyrë permanente e janë lehtësisht të arritshme e të përdorshme nga studentët</b>	
<b>Kriteret</b>	<b>Vlerësimi</b>
<b>Kriteri 1.</b> Institucioni ka procedura e njësi të posaçme në shërbim të informimit e shërbimit të studentëve, në përputhje me parashikimet ligjore dhe aktet rregullatore të IAL-ve.	Mbështetur në dokumentacionin e përcjellë, GVJ vëren se KU “Bedër” ka ngritur struktura specifike për t’i shërbyer transparencës dhe informimit sa më të mirë të studentëve. KU “Bedër” përdor Sekretaria Mësimore, Dekani i Studentëve që ka në përbërje Zyrën e Planifikimit të Karrierës, Zyrën e të diplomuarve/Alumni, etj. (Dekanati i Studentëve ka në varësinë e tij zyrat si më poshtë: (i) Zyra e planifikimit të karrierës; (ii) Zyra e koordinimit të klubeve studentore; (iii) Zyra e të diplomuarve; (iv) Zyra e shërbimit psiko-social dhe shëndetësor.)
<b>Kriteri 2.</b> Në institucion është ngritur dhe funksionon një sistem i posaçëm për mirëpritjen, informimin, këshillimin, ndjekjen e përparimit të studentëve dhe ndihmesën e tyre për çështje që kanë të bëjnë me procesin mësimor dhe programin e studimit.	Këshilltari Akademik dhe i Karrierës është gjithashtu një funksion mjaft i rëndësishëm që është i ngritur pranë çdo departamenti. Lidhja e studentëve me të, i lehtëson ata për t’u orientuar si në procesin mësimor ashtu edhe në programet e tjera dhe pjesëmarrjet në konferenca apo <i>ëorkshop-e</i> . Burimi fillestar i informacionit për studentët janë pikërisht këto zyra (Sekretaria Mësimore, Dekani i Studentëve që ka në përbërje Zyrën e Planifikimit të Karrierës, Zyrën e të diplomuarve/Alumni). Informacion i vazhdueshëm jepet për studentët edhe në sistemin e brendshëm online të komunikimit, rrjetet sociale (sidomos për aktivitetet extrakurrikulare) <i>Referencë:</i> <i>Evidenca 4- Rregullorja mbi Organizimin Administrativ</i> <i>Evidenca 5- Rregullorja e “Programit Profesional në Multimedia dhe Dizajn Grafik”</i> <i>Evidenca 8- Rregullorja e sekretarisë mësimore</i> <i>Evidenca 9- Vendimi i këshillit të departamentit për përcaktimin e përfaqësuesit të karrierës</i> <i>Evidenca 43- Raporti vjetor i Departamentit të Shkencave të Komunikimit, viti akademik 2020-2021</i>



	<i>Evidenca 62- Vendimi i këshillit të departamentit për caktimin e këshilltarëve akademik</i>			
<b>Kriteri 3.</b> Përmes zyrës/ njësisë për këshillimin e karrierës, institucioni mirëpret studentët në mënyrë të vazhduar dhe periodike, duke ofruar informacion dhe orientim të posaçëm lidhur me plotësimin e detyrimeve të procesit mësimor, zgjedhjen dhe orientimin për praktikën profesionale në institucione të tjera dhe orientimin në tregun e punës.	Mbështetur në dokumentacionin e përcjellë, GVJ vëren se KU “Bedër” ka ngritur Zyra e Planifikimit të Karrierës, në strukturë organizative si pjesë e Zyrës së Dekanit të Studentëve iu siguron atyre mundësinë dhe koordinimin për praktikat profesionale, trajnime të lidhura me tregun e punës dhe më gjerë, pjesëmarrja në ëorkshope që lidhen me përgatitjen për intervistat e punës dhe ballafaqimin me tregun.  Zyra ka kontakt me studentët edhe nëpërmjet e-maileve që dërgonte më informacione, si edhe me takime të drejtpërdrejta.  <i>Referencë:</i> <i>Evidenca 4- Rregullorja mbi Organizimin Administrativ</i>			
<b>Kriteri 4.</b> Zyra/njësia e karrierës ndjek studentët pas diplomimit, mbledh, përpunon e mban të dhëna mbi shkallën dhe cilësinë e punësimit të studentëve të programit të studimit, ua vë ato në dispozicion studentëve dhe organeve e autoriteteve drejtuese përkatëse dhe merr masa për përmirësimin e shkallës dhe cilësisë së punësimit të tyre.	Mbështetur në dokumentacionin e përcjellë, GVJ vëren se KU “Bedër” ka ngritur Dekanatin e Studenteve i cili ka në varësi edhe Zyrën e Planifikimit të Karrierës dhe Zyrën e të Diplomuarve. Këto zyra në mënyrë periodike përgatisin raporte mbi mundësitë e punësimit të studenteve. Programit Profesional i studimit në Multimedia dhe Dizajn Grafik nuk ka diplomuar ende student të tij, por ndërkohë disa prej këtyre studentëve janë të punësuar në biznese private. Ndërkohë që KU “Bedër” është edhe pjesëmarrës në programe/ panairë punësimi për të lehtësuar lidhjen e institucionit me tregun e punës.  <i>Referencë:</i> <i>Evidenca 4- Rregullorja mbi Organizimin Administrativ</i> <i>Evidenca 19- Gjurmimi i të Diplomuarve</i>			
<b>Shkalla e përmbushjes së standardit</b>	<b>Nuk përmbushet</b>	<b>Përmbushet pjesërisht</b>	<b>Përmbushet kryesisht</b>	<b>Përmbushet plotësisht</b>
				X

<b>Shkalla e përmbushjes së standardeve të fushës V</b>	<b>Nuk përmbushet</b>	<b>Përmbushet pjesërisht</b>	<b>Përmbushet kryesisht</b>	<b>Përmbushet plotësisht</b>
				X



**Përfundime të vlerësimit të programit të studimit me karakter profesional “Multimedia dhe Dizajn Grafik” të Institucionit të Arsimit të Lartë Kolegji Universitar “Bedër”**

**Pikat e forta dhe afirmime:**

1. Infrastruktura në dispozicion të programit është e plotë dhe bashkëkohore. Studentet e programit profesional në multimedia dhe dizajn grafik kanë në dispozicion laboratorë dhe atelie, të pajisur me teknologjinë me bashkëkohore.
2. Grupe të vogla studentesh për vit akademik. Politika e kuotave jo masive ka sjellë një ndikim pozitiv në cilësinë e studentëve të pranuar.
3. Profili i studimit është unik në përbërjen e tij. Ky program ka ndikim pozitiv në tregun profesional të punës që pret studentët.
4. Departamenti është i konsoliduar në fushën e komunikimit dhe me një staff me eksperiencë të gjatë në fushën e mësimdhënies dhe profilit të studimit.
5. Përfshirja e këshilltarëve akademikë gjatë procesit mësimor i ndihmon studentët të gjejnë më lehtë dhe mirë veten dhe ballafaqohen me tregun e punës
6. Qendra “Media Lab” dhe portali “Objektiv” si mundësi konkrete dhe pozitive për studentët për të konkretizuar njohuritë me eksperiencë praktike. Kjo mundësi konkretizimi dhe vendosje e njohurive në praktikë është e lidhur edhe me një larmi programesh ekstrakurrikulare që zhvilloheshin në KU “Beder”.

**Pika të dobëta:**

1. Literaturë e kufizuar në gjuhën shqipe, e shprehur në lëndët e teknologjisë. Megjithatë, vërehen përpjekje të vazhdueshme të institucionit për hartimin e tutorialëve dhe përkthimin e fashikujve për tema specifike.  
(Standardi III.2, kriteri 3)

**Rekomandime:**

1. Për një program të tillë profesional në Multimedia dhe Dizajn Grafik, botimi i teksteve në gjuhën shqipe apo regjistrimi i tutorialeve për lëndë me karakter profesional do të ishte një vlerë e shtuar për këtë program. Rekomandohet vijimësia e punës së deritanishme nga institucioni në këtë drejtimin.



2. Përfshirja e temave brenda lëndëve ekzistuese që lidhen me përditësimin duke reflektuar zhvillimet teknologjike, të cilat evoluojnë shumë shpejt. Duke konsideruar se ky është një program profesional zhvilluar në një hark kohor 2-vjeçar, rekomandohet të rishikohen struktura e krediteve për disa lëndë karakterizuese kundrejt lëndëve ndërdisiplinore.
  
3. Zhvillimi më i gjerë i fushatave njohëse, reklamuese për programet e studimit dhe institucionin në tërësi, për të thithur studentë edhe për programet profesionale të cilat po zënë vend krahas diplomave universitare. Puna e deritanishme e institucionit në këtë drejtim duhet të thellohet me tej, edhe nëpërmjet fuqizimit të zyrave të Marrëdhënieve me Publikun dhe Median dhe Zyrës së Alumni/Dekanit të Studentëve.



**Conclusions of the evaluation of the professional study program "Multimedia and Graphic Design" of the Higher Education Institution University College "Bedër"**

**Strengths and Affirmations:**

1. There is an updated and fully equipped infrastructure so the students can make use and have availability. Students of the professional program in multimedia and graphic design have at their reach laboratories, equipped with modern technology.
2. There are small groups of students per academic year. The non-massive quota policy has had a positive impact on the quality of admitted students.
3. The study profile is unique in its composition. This program has a positive impact on the professional job market that awaits students.
4. The Communication Department at this institution is well consolidated in the field of communication and with a lengthy experience staff in the field of teaching and study profile.
5. The involvement of academic advisors during the learning process and the school years helps students to find themselves and face the labour market more easily.
6. The "Media Lab" center and the "Objective" portal are a concrete and positive opportunities for students to materialize their knowledge into a practical experience. This opportunity to put knowledge into practice is also related with the involvement of students to a variety of extracurricular activities that were held at KU "Beder".

**Weak Points:**

1. Limited literature in the Albanian language, especially in technology subjects. However, continuous efforts of the institution to design tutorials and translate booklets on specific topics are observed. **(standard III.2, criterion 3)**



### **Recommendations:**

1. There will be an added value for such a professional program in Multimedia and Graphic Design to further continue publishing texts in the Albanian language or recording tutorials for subjects with a professional character. It is recommended to continue the work done so far by the institution in this direction.
2. Continuing work in including themes and topics that present the updates in the quickly evolving of the technological developments. Considering that this is a professional program developed over a 2-year time frame, it is recommended to review the structure of credits for some characteristic courses compare to interdisciplinary courses.
3. Developing wider publicity and advertising campaigns for this study programs as well as the KU "Beder", to attract and enrol more students. This is important for the professional programs which are taking place alongside the university degrees. The work of the institution so far in this direction should be further increase, also through the strengthening of the offices of Public and Media Relations and the Office of Alumni/Dean of Students.



Shkalla e përmbushjes së standardeve të cilësisë së programit

FUSHAT E VLERËSIMIT	SHKALLA E PËRMBUSHJES SË STANDARDEVE TË FUSHËS			
	Nuk përmbushen	Përmbushen pjesërisht	Përmbushen kryesisht	Përmbushen plotësisht
I. OFRIMI, ORGANIZIMI DHE DREJTIMI I PROGRAMEVE TË STUDIMIT ME KARAKTER PROFESIONAL				X
II. STRUKTURA DHE PËRMBAJTJA E PROGRAMEVE TË STUDIMIT ME KARAKTER PROFESIONAL				X
III. MËSIMDHËNIA, MËSIMNXËNIA, VLERËSIMI DHE KOMPETENCAT				X
IV. BURIMET PËR REALIZIMIN E PROGRAMIT TË STUDIMIT DHE MBËSHTETJA E STUDENTËVE				X
V. STUDENTËT DHE MBËSHTETJA E TYRE				X
VLERËSIMI TËRËSOR				X



